Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 2 (94). SHKURT 2014. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.



Market KEN
Laprakë, Tiranë
Tel: +355 4 22 50 480
Cel. 068 20 36 394

PROPOZIMI

Bliret e Peshkopisë duhet të shpallen monument kulture

Nga **ABDURAHIM ASHIKU** - FAQE 9

SIMPOZIUMI

Reka dhe shqiptarët e Rekës së Epërme

Nga **EDIBE SELIMI-OSMANI** - FAQE 19

BOTIME

Bibliografi e punimeve shqiptare të fushës së Psikologjisë

Nga **PROF. DR. NURI ABDIU** - FAQE 13


ÇËSHTJA RADIKA MBETET, NDRYSHOJNË VETËM TAKTIKAT.NDËRKOMBËTARIZOHEN PROTESTAT, PAS NEW YORK DHE ITALI, SË SHPEJTI EDHE NË BRUKSEL.

ELEM: Sasia e ujit të Radikës, sekret shtetëror!!!

Protesta në Itali, Shkup dhe Peshkopi kundër devijimit të lumenjve. Problemet ekologjike po zëvendësohen me retorikat nacionaliste. Lumit Radika deri më sot i janë marrë 80 % e ujit që ka pasur në vitet 1945-1950. Pra, jo vetëm që nuk duhet të diskutojmë për grabitje e mëtejme të ujit të Radikës, por duhet të kthehet edhe sasia tjetër që i është grabitur deri më tani. Këshilli Komunal i Dibrës së Madhe refuzon një kërkesë për ngritjen e një komisioni për verifikimin e të dhënave në terren. Arsyet nuk bëhen të ditura. Në qoftë se Maqedonia arrin ta devijojë Radikën, atëherë për dibranët në Dibrën e Madhe nuk ka rëndësi se kush i fiton zgjedhjet, pasi ata do të jenë të humburit!

- Radika, projekti është i pamundur!
- Zona aktualisht është militarizuar dhe po punohet"
- Parku kombëtar i Mavrovës është i kërcënuar
- Kapja ujërave është forma më e rëndë e krimit mjedisor

Intervistë dhe opinione nga
Molnar Kolaneci, Metodija Velevski, Bashkim Mashkulli dhe Bardhyl Marku
SPECIALE NË FAQET 4,5,6,7,8



Interviste me Dr. Gezim Alpion: Cfare po ndodh me peticionin?



Pa Rrugën e Arbërit, Dibra është e vdekur

Dibra, apo më saktë Dibrat, po e vuajnë sakatimin e kombit më shumë se çdo krahinë tjetër e truallit shqiptar edhe 100 vjet pas kasaphanës së 1913-tës. Si rezultat i këtij akti makabër, Dibra, që gjeografikisht është në qendër të hapësirës shqiptare, i ngjan një viktime që vandalët i vodhën veshkën pa u merakosur të paktën t'i qepnin plagën.

Në kohën tonë kufijtë po bëhen gjithmonë e më simbolikë, dhe shpresoj që kjo të aplikohet edhe në Ballkan. Megjithatë, Dibrat nuk do të përfitojnë nga klima e tanishme e bashkëpunimit Europian që do të përfshijë gjithmonë e më shumë edhe Ballkanin tonë të trazuar, për aq kohë sa infrastruktura të mbetet ajo që është në të dy anët e kufirit.

Për Dibrën e Madhe bashkatdhetarët tanë atje, jam i sigurt se janë në gjendje të bëjnë një argumentim shumë më të informuar se unë se si janë trajtuar nga shteti maqedonas dhe se çfarë përpjekjesh po bëjnë politikanët shqiptarë atje për të ndihmuar konkretisht atë zone. Kohët e fundit kam ndjekur me shqetësim lajmin në lidhje me devijimin e Radikës, që përbën jo vetëm një hap tjetër mbrapa për Dibrën por edhe një akt vandalizmi ekologjik. Në një vend që nuk ka rrugë dhe ujë nuk mund të flitet për zhvillim.

Për Dibrën në Shqipëri, siç i thonë një fjale, fshati që duket nuk do kallauz. Dibra po jep shpirt. Ndërsa rruga aktuale Peshkopi-Tiranë, po t'i hidhni një sy hartës, është një ofendim për intelektin dhe çmenduri të cilët dibranët nuk duhet ta durojnë as edhe një legjislaturë më shumë.

Të mendosh se zona që nxorri heronj të përmasave kombëtare dhe ndërkombëtare në luftë për mbrojtjen e kombit si Skënderbeu, Elez Isufi, Dom Nikollë Kaçorri, Haxhi Vehbi Dibra, etj., për të ardhur tek heronjtë e Luftës së Dytë Botërore, vazhdon të injorohet deri në përbuzje, është një dështim flagrant i shtetit ndaj përgjegjësisë që ka për 200,000 dibranë, të cilët kanë kohë që presin më kot që Tirana zyrtare të kujtohet për ta.

Dibra është një muzeum i gjallë dhe një perlë e pa shoqe e natyrës si nga bukuritë e mahnitshme dhe relievin epik, ashtu edhe për pasuritë e shumta minerale, burimet ujore, pemtarinë dhe pyjet. Është mirë që sheikët e politikës shqiptare që po dhjamosen gjatë dy dekadave të fundit me kromin e Bulqizës t'i vënë gishtin kokës sa më shpejt dhe të bëjnë diçka konkrete për t'i shërbyer Dibrës dhe zonave të tjera të harruara, të cilat për më se një shekull janë viktimë e shfytëzimit nga 'kolonializmi nacional'.

LEXONI NË FAQEN 2-3

cyan magenta yellow black 1

Siç e kemi bërë të qartë që më 18 mars 2013, kjo nismë do të përfundojë vetëm kur të përfundojë metri i fundit i rrugës Tiranë-Peshkopi brenda standardeve ndërkombëtare. Ne jemi të gatshëm të lobojmë me vite, pasi kjo është një 'betejë' që ne nuk jemi të përgatitur ta humbin, sepse pa këtë rrugë, Dibra është e vdekur.

Pa Rrugën e Arbërit, Dibra është e vdekur

Dr. Gëzim Alpion, nismëtari i peticionit për Rrugën e Arbërit, nisur gati një vit më parë, më 18 mars 2013, i cili po vazhdon të firmoset online, i ka dhënë një intervistë të posaçme gazetarit nga Kosova, Valmir Gashi. Intervista, e cila përqendrohet në probleme të ndryshme, që kanë të bëjnë me trajtimin që i kanë bërë dhe po i bëjnë çështjes së Rrugës së Arbërit qeveritarët shqiptarë, si dhe rolin që po luan shoqëria civile në këtë proces, u botua me shkurtime në gazetën Panorama më 11 shkurt 2013. Për lexuesin e gazetës "Rruga e Arbërit" po e ribotojmë të plotë.

Nga **VALMIR GASHI**

- Ju i dërguat një letër të hapur në fillim të muajit Maj 2013 Presidentit të Republikës së Shqipërisë z. Bujar Nishani, ish-kryeministrit z. Sali Berisha, kryeministrit aktual z. Edi Rama, drejtuesve të tjerë të lartë të shtetit si dhe kryetarëve të partive të përfaqësuara në Parlamentin shqiptar. Pas asaj kohe, a ka patur ndonjë reagim prej tyre?

- Përveç personave që përmendni ju, kur isha në Tiranë më 3 Maj 2013, u dërgova të njëjtën letër në lidhje me Rrugën e Arbërit edhe znj. Jozefina Topalli, z. Bamir Topi, z. Ilir Meta, z. Fatmir Mediu dhe z. Shpëtim Idrizi.

Sipas konfirmimeve që kemi marrë nga shërbimi postar shqiptar, të gjithë personat në fjalë i kanë marrë letrat. Kjo është konfirmuar edhe nga individë të punësuar pranë këtyre politikanëve.

Deri tani asnjë nga letër marrësit nuk na ka kthyer përgjigje.

- Dr Alpion, përse duhet të merret Qeveria e Shqipërisë me peticionin tuaj, kur ka aq shumë halle për të zgjidhur?

- Nëpërmjet peticionit, ne premtuam më 18 mars 2013 se pas zgjedhjeve të qershorit do t'i kërkojmë qeverisë së re të përfundojë Rrugën e Arbërit. Për ne nuk kishte rëndësi nëse në pushtet do të qëndronte e djathta apo do të vinte e majta.

Të dyja krahët e politikës shqiptare janë fajtorë para Dibrës, pasi çdo premtim elektoral për këtë vepër është harruar menjëherë pas zgjedhjeve. Megjithatë, ne e bëmë të qartë që në fillim se qëllimi ynë nuk është të merremi me të kaluarën, por të shikojmë me shpresë nga e ardhmja. Pra, me peticionin, ne nuk po i kërkojmë qeverisë të premtojë diçka të re për Dibrën.

Me peticionin ne po i bëjmë një shërbim jo vetëm Dibrës por edhe shtetit shqiptar. Mënyra se si shteti e ka keqtrajtuar çështjen e Rrugës së Arbërit na kujton edhe një herë fenomenin shqetësues që e karakterizon shtetin shqiptar për më se një shekull: mungesën e vazhdimësisë në drejtimin e vendit. Është për të ardhur keq që ky fragmentizëm dhe amatorizëm shtetëror është bërë edhe më i ndjeshëm në çerek shekullin e fundit.

Po kështu, mos mbajtja e premtimeve për Rrugën e Arbërit nxjerr edhe një herë në pah se sa 'pragmatiste' për qëllime të ngushta personale dhe partiake dhe, për pasojë, sa pak serioze janë programet elektorale të enteve dhe koalicioneve politike në Shqipëri.

- Si shumë zona të tjera të Shqipërisë, edhe Dibra ka kohë që është lënë në harresë. Përse ju zuri meraku për Dibrën kaq papritur? Apo ndoshta keni ndonjë motivacion personal?

- Në planin personal, Dibra ka qenë gjithmonë pjesë e jetës time dhe vazhdon të jetë e tillë, megjithëse nga Peshkopia u largova kur isha 14 vjeç. Dibra ka luajtur një rol të rëndësishëm në formimin tim si njeri dhe intelektual dhe, një vendlindje magjepse 'harrohet' vetëm kur ndërron jetë.

Dibra është tema e parë e botimeve të mia. Për Dibrën kam filluar të botoj për herë të parë në gazetën e Peshkopisë '*Ushtima e Maleve*' në vitin 1980, kur beja stazhin pas përfundimit të shkollës së mesme. Në rreth 20 reportazhe dhe shkrime të ndryshme trajtova një numër çështjesh që mendova se ishin me interes. Mbaj mend se reportazhet, artikujt dhe portretet evidentonin arritjet e individëve të veçantë dhe të disa ndërmarrjeve si dhe nxirrnin në pah disa të meta.

Referenca për Dibrën figurojnë që në fillim edhe në botimet e mia në anglisht, fillimisht në gazetën '*Middle East Times*' në Kajro në vitin 1993, si dhe në intervista që kam zhvilluar në mediat perëndimore. Influenca e Dibrës në formimin tim është trajtuar edhe nga studiuesi britanik Dr Adrian Stokes në parathënien e librit '*Foreigner Complex*' ('*Kompleksi ndaj të Huajve*') që u botua në Angli në 2002.

Në Angli, gazeta e parë shqiptare në Londër '*Albanian Mail*' në vitin 2003 me ftoi që të kontribuoja si 'columnist' çdo javë një shkrim sipas tematikës që preferoja. Në rubrikën 'Ditari nga Birminghami' unë zgjodha të trajtoj aspekte të veçanta të kulturës dhe traditave të Dibrës.

Shqipërinë e vizitoj çdo vit që kur u largova në vitin 1985 dhe kthimi bëhet 'i plotë' kur shkoj edhe në Peshkopi. Në Tiranë takohem rregullisht me një numër intelektualësh dibranë, me të cilët diskutojmë për problemet e Dibrës.

Duke parë se sa e fragmentuar është shoqëria shqiptare dhe sa i rëndësishëm është kohezioni kombëtar për përparimin e një vendi, gjatë dy dekadave të fundit nuk kam dashur të prononcohem publikisht për shqetësimet në lidhje me injorimin e Dibrës dhe diskriminimin tradicional që u bëhet disa zonave në Shqipëri, si në veri ashtu edhe në jug.

Për herë të parë kam folur publikisht për injorimin e Dibrës dhe zvarritjen e pa justifikueshme të punimeve në Rrugën e Arbërit në Korrik 2012 gjatë një interviste televizive në studio me z. Roland Qafoku.

Më 18 mars 2013, kur pashë që politikanët akoma kishin kurajo të kërkonin votat dibrane duke ri-premtuar premtimin e pambajtur, vendosa të mos hesht më.

Motivi im i parë dhe i fundit për peticionin është të kontribuoj sado pak për t'i rikthyer Dibrës dinjitetin e nëpërkëmbur. Shpresoj që shembulli i intelektualëve dibranë në këtë drejtim të frymëzojë edhe kolegë nga zona të tjera të harruara të Shqipërisë që të ngrenë zërin. Në këtë drejtim, peticioni për Rrugën e Arbërit është thirrje për një orientim të ri në politikën shqiptare, pra të mos merremi vetëm me Tiranën dhe disa zona e qytete të 'preferuara' apo kryesisht me çështjen e pranimit në Europë, por të kthejmë sytë edhe nga disa zona të Shqipërisë, që janë zhytur në skamje dhe mjerim sikur t'i përkisnin vendeve të botës së tretë, sepse janë braktisur nga shteti.

- Disa media informacioni në Prishtinë kanë raportuar se gjatë muajit shtator 2013 është kontaktuar Zyra e Kryeministrit të Shqipërisë për të kërkuar takim me z. Edi Rama për t'i paraqitur peticionin. A do të ndodhë ky takim dhe kur mendoni se mund të ndodhë?

- Siç premtuam me 18 mars 2013, një muaj pas krijimit të qeverisë së re, më 26 shtator ne i dërguam kërkesën e parë z. Edi Rama për takim. Kërkesa është paraqitur 5 herë deri më tani dhe për çdo rast kemi konfirmim se ajo është marrë.

Nuk duam të nxjerrim konkluzione të gabuara, por heshtja e pajustifikueshme zyrtare, që dikush edhe mund ta konsiderojë jo vetëm si mungesë kortezie nga ana e institucionit të Kryeministrisë, por edhe tregues se si punon, në këtë rast, se si nuk funksionin, administrata shtetërore. Kur kërkesa jonë për takim, e cila nuk ka të bëjë fare me interesa personale, me sa duket injorohet kaq hapur, imagjino se ç'ndodh me qytetarë hallexhinj që u shkruajnë zyrtarëve për të qarë hallet.

E megjithatë, që intelektualët dibrane, që po lobojnë për Rrugën e Arbrit, do të takojnë Kryeministrin e Shqipërisë, kjo nuk duhet vënë aspak në dyshim.

- Cila është rruga që duhet të ndjekë Dr Gëzim Alpion, si një anëtar i shoqërisë civile dhe jo vetëm, për të kërkuar takim me Kryeministrin e Shqipërisë?

- Unë asnjëherë nuk kam kërkuar të takohem me Kryeministrin e Shqipërisë. Kur më është sugjeruar një takim i tillë, nuk kam hezituar të jem i gatshëm, por nuk kam rënë dakord kur më janë vënë kushte se çfarë është e pranueshme të diskutohet apo të mos preket.

Në rastin aktual, nuk është e rëndësishme nëse unë e takoj kryeministrin; intelektualët dibranë janë në gjendje ta ngrenë zërin për Dibrën edhe pa mua. Rëndësi ka që drejtuesi i qeverisë të dëgjojë zërin e dibranëve.

Peticioni për Rrugën e Arbërit nuk ka dhe nuk mund të ketë efektin e zemërimit mbarëkombëtar që pamë në rastin e çështjes së shkatërrimit të armëve kimike, pasi po bëhet fjalë për një rrugë prej 70 kilometrash. E megjithatë, peticioni për rrugën ka ngjallur interes, pasi kjo vepër është me vlera të pallogaritshme nga ana ekonomike dhe strategjike në planin rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar.

Si gjithmonë, si intelektual, unë jam i gatshëm të bashkëpunoj më çdo qeveri të zgjedhur në mënyrë demokratike, por nuk do të jem asnjëherë i angazhuar politikisht. Kjo nuk do të thotë se përçmoj sistemin politik, por si intelektual e ndjej se i shërbej më mirë vendit duke qëndruar jashtë influencave politike.

Intelektualët me integritet janë gjithmonë në 'opozitë', dhe opozita e intelektualëve, edhe pse nuk u vjen shumë për shtat pushtetmbajtësve, është opozita më e efektshme dhe më besnike së çdo opozitë politike sepse ajo ka prioritet gjithmonë, jo interesat e një klani të caktuar politik opo të klasës politike, por interesat e atdheut dhe kombit.

- Përse duhet një akademik shqiptaro-britanik të bëhet zëdhënës i Dibrës, kur kjo zonë ka 6 deputetë që janë zgjedhur për këtë punë? Nuk është politike kjo iniciative apo si?

- Ajo që thoni ju është me vend vetëm kur shteti dhe, ne rastin konkret, Parlamenti si dhe deputetët të përmbushin detyrimet ndaj elektoratit. Përderisa në Shqipëri nuk ka normalitet në këtë drejtim, është detyra e intelektualëve të mos heshtin.

Përsa i përket deputetëve të Dibrës, deri tani, pavarësisht përkatësive të tyre politike, ata thjesht kanë vegjetuar. Nëse deputetët e zgjedhur në këtë legjislaturë do të përfaqësojnë Dibrën denjësisht, ata kanë edhe tre vjet e gjysmë për të dëshmuar që janë ndryshe nga paraardhësit e tyre.

- Tanimë peticioni ka regjistruar mbi 4700 nënshkrime online pa llogaritur nënshkrimet në formularët e përgatitur enkas në përputhje me legjislacionin shqiptar. Ky numër i deritanishëm, ju bën të ndiheni të kënaqur nga përkrahja që ka gjetur peticioni?

- Kur filloi peticioni ne menduam se do të ishte një arritje shumë e mirë po qe se do të siguronim 1000 nënshkrime. Tani, duke përfshirë edhe

Posta e Rrugës Arbërit

Gazetë e pavarur.
Nr. 2 (94). 2 - 28 Shkurt 2014

Redaksia e gazetës falënderon lexuesit dhe bashkëpunëtoret e saj për mesazhet dhe shkrimet e sjella për botim.
Njoftojmë zotërinjtë: S.Mëziu, Z. Lleshi, D.Rama, R. Lata, H.Përnezha, J.Selmani, D.Tërshalla, se shkrimet e tyre janë në redaksi dhe do të shqyrtohen për botim në numrat e ardhshëm.
Kujtojmë bashkëpunëtorët, të cilët duan që shkrimet e tyre të botohen patjetër në numrin e radhës, të konfirmojnë më parë sjelljen e materialit në numrat e telefonit të redaksisë ose emailin e gazetës.
Shkrimet priten në redaksi deri më **datë 20** të muajit.
Gjithashtu, ju **kujtojmë bashkëpunëtorëve se shkrimet deri në dy faqe daktilografike kanë përparësi botimi.**

JU LUTEMI, SHKRIMET QË VIJNË PËRMES EMAIL-it, TË KENË PATJETËR ZANOREN "ë".

Pajtimet në gazetë mund t'i bëni në çdo kohë duke komunikuar në adresat e redaksisë.

Arkivi i gazetës është pa pagesë në faqen e internetit **www.rrugaearberit.com.**

Ju falënderojmë që jeni pjesë e gazetës!

KËSHILLI BOTUES:

Musa Riçku
Mentor Hoxha
Shaqir Skarra
Bujar Karoshi

Kontribuan për këtë numër:

Valmir GASHI
Ben ANDONI
Metodija VELEVSKI
Abdurahim ASHIKU
Bardhyl MARKU
Gafur ZOTA
Xhafer MARTINI
Lutfi HANKU
Hajri SHEHU
Edibe SELIMI-OSMANI
Beqir SINA
Hasan PASHA
Ilmi DERVISHI
Zabit LLESHI
Mehmet DUME
Hysen UKA
Hysen LIKDISHA

Adresa e gazetës:
Rr. "Zenel Baboçi",
Pall. "Ferar", Tiranë
Tel. +355 4 22 33 283
E-mail: rrugaearberit@gmail.com

Opinionet dhe komentet e botuara nuk shprehin domosdoshmërisht qëndrimin e redaksisë

Çdo shkrim apo foto e botuar i nënshtrohet ligjit për respektimin e të drejtave të autorit. Ndalohet riprodhimi, fotokopjimi, shpërndarja apo ribotimi pa lejen e autorit të shkrimit apo redaksisë.

e muajit



Në foto:
Dr. Gëzim Alpion

Dibra, apo më saktë Dibrat, po e vuajnë sakatimin e kombit më shumë se çdo krahinë tjetër e truallit shqiptar edhe 100 vjet pas kasaphanës së 1913-tës. Si rezultat i këtij akti makabër, Dibra, që gjeografikisht është në qendër të hapësirës shqiptare, i ngjan një viktime që vandalët i vodhën veshkën pa u merakosur të paktën t'i qepnin plagën.

Në kohën tonë kufijtë po bëhen gjithmonë e më simbolikë, dhe shpresoj që kjo të aplikohet edhe në Ballkan. Megjithatë, Dibrat nuk do të përfitojnë nga klima e tanishme e bashkëpunimit Europian që do të përfshijë gjithmonë e më shumë edhe Ballkanin tonë të trazuar, për aq kohë sa infrastruktura të mbetet ajo që është në të dy anët e kufirit.

Për Dibrën e Madhe bashkatdhetarët tanë atje, jam i sigurt se janë në gjendje të bëjnë një argumentim shumë më të informuar se unë se si janë trajtuar nga shteti maqedonas dhe se çfarë përpjekjesh po bëjnë politikanët shqiptarë atje për të ndihmuar konkretisht atë zone. Kohët e fundit kam ndjekur me shqetësim lajmin në lidhje me devijimin e Radikës, që përbën jo vetëm një hap tjetër mbrapa për Dibrën por edhe një akt vandalizmi ekologjik. Në një vend që nuk ka rrugë dhe ujë nuk mund të flitet për zhvillim.

Për Dibrën në Shqipëri, siç i thonë një fjale, fshati që duket nuk do kallauz. Dibra po jep shpirt. Ndërsa rruga aktuale Peshkopi-Tiranë, po t'i hidhni një sy hartës, është një ofendim për intelektin dhe çmenduri të cilët dibranët nuk duhet ta durojnë as edhe një legjislaturë më shumë.

nënshkrimet e formularëve në letër, peticioni ka më shumë se 5000 përkrahës.

Duke parë mobilizimin e rinisë dibrane në Peshkopi dhe në disa fshatra në Dibër, jemi të sigurt se numri i nënshkruesve do të rritet në muajt që vijnë.

- Shqipëria është një vend i politizuar. Ju dhe kolegët tuaj dibranë, që janë prononcuar për peticionin në media, keni theksuar që në fillim se ky peticion është dhe do të mbetet deri në fund jo politik. A janë bërë përpjekje për ta politizuar këtë nismë dhe cili ka qenë reagimi juaj? Apo nuk keni reaguar fare?

- Peticioni ynë 'i dogji' që në fillim, si të majtës ashtu edhe të djathtës së politikës shqiptare pasi, siç përmenda më lart, Rruga e Arbërit ka 'mëkatare' socialistë dhe demokratë. Para zgjedhjeve, demokratët menduan se peticioni ishte kundër tyre, me gjithë insistimin tonë se ky peticion nuk është për të sulmuar të djeshmit, kushdo qofshin ata, por fillimi i një dialogu konstruktiv me qeverinë. Ndërsa socialistët menduan se peticioni po çonte ujë në mullirin e tyre, kështu që simpatizantët e tyre, veçanërisht në Dibër, u treguan më të gatshëm për të nënshkruar. Pas zgjedhjeve, ndodhi e kundërta. Simpatizantët e së majtës u bënë më të 'tërhequr' ndërsa të 'djathtët' filluan të gjallërohen.

Për ne nuk kishte rëndësi se kush fitonte zgjedhjet, pasi as unë dhe as kolegët e mi nuk synojmë karrierë politike në Shqipëri. Asnjëri nga ne nuk aderon në ndonjë parti politike. Qëllimi ynë i parë dhe i fundit nëpërmjet këtij peticioni është t'i shërbejmë Dibrës. Për këtë jemi të vendosur, pavarësisht se sa shumë kohë do të na duhet të lobojmë për ndërtimin e Rrugës së Arbërit.

- Dr. Alpion, në fjalën përshëndetëse "Kur intelektualët tuten, maskarenjtë mbretërojnë" që mbajtët në Maj 2013 në Konferencën Ndërkombëtare për Nacionalizmin të organizuar në Tiranë nga Instituti Kanadez i Teknologjisë, ju theksuat se Shqipërisë i duhen më shumë se kurrë intelektualë të pavarur. Nisma juaj është përkrahur nga një numër i madh intelektualësh me prirje të majta dhe të djathta si dhe të pa angazhuar në politikë. A ju inkurajon ju ky fakt?

- Që në fillim, peticioni u përkrah nga një numër deputetësh dhe ish-deputetësh të së majtës dhe të djathtës, disa jo me origjinë dibrane. Kjo tregon se disa parlamentarë që para zgjedhjeve u bindën se peticioni ynë nuk kishte nota politike. Kjo na inkurajoi ashtu siç na gëzoi fakti që edhe një numër intelektualësh dhe artistësh të njohur nga Shqipëria dhe Kosova si znj. Nexhmije Pagarusha, z. Kujtim Çashku, z. Ndriçim Xhepa, z. Behar Mera, Profesor Artan Fuga etj, na përkrahën pa rezerva pavarësisht qëndrimeve të tyre politike.

Shoqëria civile luan një rol të rëndësishëm edhe në vendet demokratike ku funksionon shteti ligjor. Ndërsa në Shqipëri, ku shteti është i dobët sepse legjitimiteti dhe efikasiteti i tij janë erozuar nga metoda korruptive në drejtim dhe menaxhim, shoqëria civile merr një rol të veçantë.

Problemi është se në Shqipëri, pavarësisht disa shkëndijave premtuese që pamë me protestat kundër shkatërrimit të armëve kimike siriane në nëntor 2013, shoqëria civile është akoma në një faze embrionale, e pa organizuar dhe për pasojë nuk është e ndërgjegjshme për rolin e saj të rëndësishëm që mund të luajë, aq më tepër që në Shqipëri marrëdhëniet midis qeverisë dhe opozitës vazhdojnë të jenë në një gjëndje të mjerueshme.

Zhvillimi i Shqipërisë me hapin e vendeve ish-socialiste po pengohet nga një klasë politike kleptoktarike, që në 20 vitet e fundit po e qeveris vendin sipas modelit të rotacionit të tipit Putin-Medvedev. Pra, në Shqipëri edhe kur ka ndryshim nga e majta në të djathtë apo anasjelltas, pavarësisht premtimeve të fillimit, jo shumë gjëra ndryshojnë, pasi politikanët shqiptarë, pavarësisht disa akteve simbolike, në thelb nuk kanë dëshirë dhe guxim të prekin interesat financiare të 'oponentëve' të tyre politikë. Pra, në vorbullën e korrupsionit që ka kapur për fyti shtetin, drejtuesit e politikës janë 'në të' së bashku.

Në këto kushte, elita intelektuale në diasporë mund dhe duhet të luajë një rol primar. Kjo elitë është e përkushtuar për t'i shërbyer Shqipërisë në mënyrë reale dhe jo vetëm kur qeveritë ndërmarrin nisma sensacionale për të kthyer në Shqipëri trurin e larguar. Fushata të tilla kanë dështuar më parë dhe ka të ngjarë të dështojnë edhe në të ardhmen, sepse bëhen kryesisht për qëllime politike.

Kjo është arsyeja kryesore, mendoj unë, përse, tani për tani, elita intelektuale në diasporë është e 'distancuar' dhe kjo gjendje do të vazhdojë për aq kohe sa qeveria e Tiranës të përpiqet t'i politizojë apo t'i joshë intelektualët e suksseshëm në disaporë me metoda dhe fushata amatoreske.

Shqipëria nuk do të jetë në gjendje të ndërtojë një shtet normal ligjor sipas modeleve të demokracive Europiane pa një angazhim total serioz të intelektualëve në Perëndim. Kur kjo të ndodhe, imazhi i Shqipërisë në botë do të përmirësohet ndjeshëm dhe përfshirja e saj me dinjitet në familjen europiane do të vijë natyrshëm.

- Peticioni tërhoqi që në fillim vëmendjen e mediave në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, diasporë dhe së fundi edhe të mediave ndërkombëtare. Në shkrimin e botuar në Indi më 28 Tetor 2013 gazetari C. M. Paul thekson se "rruga do të shërbejë për të lidhur më mirë vendlindjen e Nënë Terezës Shkupin me Tiranën dhe se do t'i japë akses për herë të parë Bullgarisë në Adriatik dhe Mesdhe". Përse ky interesim kaq i madh i mediave për një rrugë prej 70 km?

- Me sa duket rëndësia e Dibrës për Shqipërinë, kombin shqiptar dhe Maqedoninë njihet në Ballkan dhe gjetkë me mirë se ç'e njeh klasa politike ne Tiranë! Disa politikanë shqiptarë nuk do të gëzonin të 'drejtën' të majmen pa sakrificat e dibranëve, në luftë dhe paqe, për të mirën e kombit.

Interesimi i mediave në Ballkan dhe në botë sapo ka filluar. Së shpejti për Rrugën do të shkruhet në një revistë Britanike; një shkrim tjetër do të hartohet edhe nga një ish punonjëse e BBC-së dhe korrespondente e '*Times of India*' në Londër; po kështu, gazeta Slovake '*Pravda*' së shpejti do të botojë një editorial.

Bota po i ndjek me interes shenjat e gjallërimit të shoqërisë civile në Shqipëri dhe gazetarët e huaj, ashtu si gazetarët tanë në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni dhe diasporë, kur na kontaktojnë theksojnë se janë impresionuar nga këmbëngulja jonë për te vazhduar presionin me mjete demokratike. Sigurisht, edhe pozicioni ynë jo politik i ka bindur njerëzit e mediave se në këtë nismë asnjë person që është përfshirë në lobimin për Rrugën e Arbërit nuk synon ta përdorë këtë nismë për ndonjë qëllim personal politik apo biznesi.

- Kohë më parë ju jeni shprehur se Rruga e Arbërit 'do të rilindë dibranët'. E keni fjalën për dibranët në Shqipëri apo edhe në Maqedoni?

- Dibra, apo më saktë Dibrat, po e vuajnë sakatimin e kombit më shumë se çdo krahinë tjetër e truallit shqiptar edhe 100 vjet pas kasaphanës së 1913-tës. Si rezultat i këtij akti makabër, Dibra, që gjeografikisht është në qendër të hapësirës shqiptare, i ngjan një viktime që vandalët i vodhën veshkën pa u merakosur të paktën t'i qepnin plagën.

Në kohën tonë kufijtë po bëhen gjithmonë e më simbolikë, dhe shpresoj që kjo të aplikohet edhe në Ballkan. Megjithatë, Dibrat nuk do të përfitojnë nga klima e tanishme e bashkëpunimit Europian që do të përfshijë gjithmonë e më shumë edhe Ballkanin tonë të trazuar, për aq kohë sa infrastruktura të mbetet ajo që është në të dy anët e kufirit.

Për Dibrën e Madhe bashkatdhetarët tanë atje, jam i sigurt se janë në gjendje të bëjnë një argumentim shumë më të informuar se unë se si janë trajtuar nga shteti maqedonas dhe se çfarë përpjekjesh po bëjnë politikanët shqiptarë atje për të ndihmuar konkretisht atë zone. Kohët e fundit kam ndjekur me shqetësim lajmin në lidhje me devijimin e Radikës, që përbën jo vetëm një hap tjetër mbrapa për Dibrën por edhe një akt vandalizmi ekologjik. Në një vend që nuk ka rrugë dhe ujë nuk mund të flitet për zhvillim.

Për Dibrën në Shqipëri, siç i thonë një fjale, fshati që duket nuk do kallauz. Dibra po jep shpirt. Ndërsa rruga aktuale Peshkopi-Tiranë, po t'i hidhni një sy hartës, është një ofendim për intelektin dhe çmenduri të cilët dibranët nuk duhet ta durojnë as edhe një legjislaturë më shumë.

Të mendosh se zona që nxorri heronj të përmasave kombëtare dhe ndërkombëtare në luftë për mbrojtjen e kombit si Skënderbeu, Elez Isufi, Dom Nikollë Kaçorri, Haxhi Vehbi Dibra, etj., për të ardhur tek heronjtë e Luftës së Dytë Botërore, vazhdon të injorohet deri në përbuzje, është një dështim flagrant i shtetit ndaj përgjegjësisë që ka për 200,000 dibranë, të cilët kanë kohë që presin më kot që Tirana zyrtare të kujtohet për ta.

Dibra është një muzeum i gjallë dhe një perlë e pa shoqe e natyrës si nga bukuritë e mahnitshme dhe relievin epik, ashtu edhe për pasuritë e shumta minerale, burimet ujore, pemtarinë dhe pyjet. Është mirë që sheikët e politikës shqiptare që po dhjamosen gjatë dy dekadave të fundit me kromin e Bulqizës t'i vënë gishtin kokës sa më shpejt dhe të bëjnë diçka konkrete për t'i shërbyer Dibrës dhe zonave të tjera të harruara, të cilat për më se një shekull janë viktimë e shfytëzimit nga 'kolonializmi nacional'.

- Dr Alpion, cili do të jetë fundi i këtij peticioni dhe çfarë sjell kjo eksperience në sferën tuaj personale e profesionale, apo ndoshta një mesazh shprese do ishte i nevojshëm për dibranët dhe jo vetëm?

- Siç e kemi bërë të qartë që më 18 mars 2013, kjo nismë do të përfundojë vetëm kur të përfundojë metri i fundit i rrugës Tiranë-Peshkopi brenda standardeve ndërkombëtare.

Ne jemi të gatshëm të lobojmë me vite dhe, po qe se na duhet, edhe t'i ngremë fjalët me pashallarët e rinj në Tiranë, pasi kjo është një 'betejë' që ne nuk jemi të përgatitur ta humbin, sepse pa këtë rrugë, Dibra është e vdekur.

Adresa e Adresa e peticionit online për Rrugën e Arbërit:

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtonisa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit

Rruga e Arbërit nr. 94

aktualitet

- Protesta në Itali, Shkup dhe Peshkopi kundër devijimit të lumenjve. Problemet ekologjike po zëvendësohen me retorikat nacionaliste.
- Lumit Radika deri më sot i janë marrë 80 % e ujit që ka pasur në vitet 1945-1950. Pra, jo vetëm qe nuk duhet të diskutohet për grabitje e mëtejme të ujit të Radikës, por duhet të kthehet edhe sasia tjetër që i është grabitur deri më tani.
- Këshilli Komunal i Dibrës së Madhe refuzon një kërkesë për ngritjen e një komisioni për verifikimin e të dhënave në terren. Arsyet nuk bëhen të ditura.



Një vajzë e vogël duke mbajtur një parullë në Mitingun e Shkupit. Foto marrë nga grupimi në FB, *"Të mbrojmë lumin Radika"*

ÇËSHTJA RADIKA MBETET, NDRYSHOJNË VETËM TAKTIKAT.NDËRKOMBËTARIZOHEN PROTESTAT, PAS NEW YORK DHE ITALI, SË SHPEJTI EDHE NË BRUKSEL.

ELEM: Sasia e ujit të Radikës, sekret shtetëror!!!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Çështja e devijimit të ujërave të Radikës vazhdon të mbetet një problem i ditës. Shoqatat joqeveritare kanë mbajtur protesta në Itali, Shkup dhe Peshkopi, por duket se çështja po futet në debate teknike dhe politike.

Kandidati për ambasador në Maqedoni, Petrit Bushati, u shpreh gjatë paraqitjes së platformës së tij të punës në komisionin për Politikë të Jashtme, se Shqipëria do t'i rishikojë të gjitha marrëveshjet që ka me Maqedoninë për çështjen e ujërave dhe theksoi nevojën se duhet të rishkruhen të gjitha marrëveshjet. Për lumin Radika ai theksoi se "ky problem do të duhet të shihet në kontekstin e së drejtës ndërkombëtare, marrëveshjeve ndërkombëtare dhe direktivave të BE".

Por ndërkohë, shoqëria energjetike ELEM ka filluar debatin publike në lidhje me projektin Fusha e Llukovës dhe Ura e Boshkut.

PROTESTAT

Më 8 shkurt 2014, në Mestre në Itali u zhvilluar një protestë para ambasadës maqedonase kundër devijimit të Radikës. Në protestë ishin të pranishëm qindra qytetarë, të cilët mbanin në duar pankarta dhe bënin thirrje për t'i thënë JO hidrocentraleve në Fushë të Llukovës dhe Urë të Boshkut.

Artan Karpuzi, njëri prej organizatorëve, tha për gazetën "Rruga e Arbërit" se protesta ishte shumë qytetare dhe pati një pjesëmarrje të madhe, si të banorëve me origjinë nga Dibra, ashtu edhe nga Reka dhe fshatrat përreth. Organizatorët e protestës u kanë shkruar një letër edhe financuesve të këtyre dy projekteve, Bankës Botërore dhe BERZH, ku shprehin shqetësimin në lidhje me dëmet që do tu vijë nga devijimi i Radikës.

Artani thotë se janë duke u bërë bisedime mes organizatorëve për një protestë të Radhës në Bruksel. "Anëtarët e grupeve të organizimit të protestës banojnë në qytete të ndryshme, deri në 450 km larg njëri-tjetrit, dhe kështu që nuk kemi caktuar akoma një datë se kur do ta mbajmë protestën në Bruksel, por kjo do të vijë shumë shpejt". Ndërkohë, ai shpreh shqetësimin, se po kontaktohen pjesëmarrësit në protestë, për ti bindur ata që të mos organizojnë më tubime të kësaj natyre. "Një delegacion në përbërje nga përfaqësues të ELEM-it, Ministrisë për mbrojtje të ambientit jetësor dhe ekspertë të kësaj fushe, ka shkuar nëpër fshatra të Rekës duke tentuar të bindë njerëzit se nuk do të humbin asgjë me ndërtimin e hidrocentraleve dhe se u kërkojnë banorëve të Rekës që t'i ndalojnë të afërmit e tyre të marrin pjesë në protesta të cilat sipas tyre janë të manipuluara".

Protesta në Shkup, organizuar më 15 shkurt 2014 nga shoqata "Oda Dibrane" iu kushtua e gjitha trajtimit të problemit si mjedisor dhe jo politik. Asaj iu bashkangjitën edhe dy koalicionet mjedisore maqedonase "Ekologjia si prioritet" dhe "Natyra 2000", si dhe organizata të shoqërisë civile nga Dibra, Reka, Trebishta, Rostusha, Gostivari, Tetova, etj.

Në Peshkopi, protesta u mbajë më 1 mars me moton "Stop strategjisë dhe grabitjes të pasurive tona shqiptare nga serbët".

DEBATET PUBLIKE

Shoqëria energjetike ELEM ka mbajtur një debat publike në Rostushë, Velebërdë dhe Trebishtë me 18 shkurt 2014, dhe një ditë më vonë edhe në Zhirovnicë dhe Skudrinjë.

Në këto takime, kanë mbrojtur projektet Drejtori i Përgjithshëm i ELEM Dejan Boshkovski, drejtorit për investime dhe zhvillim Aleksandar Paunovskisi dhe ka qenë e pranishme edhe përfaqësuesja e Ministrisë së Ambientit Jetësor, Sonja Lepitovska. Në këto takimekanë marrë pjesë edhe rreth 60 vetë nga Dibra, qytetarë, aktivistë të shoqatave joqeveritare dhe përkrahës të kauzë kundër devijimit të lumit Radika.

Sipas Dashamir Markut, një qytetari nga Dibra, i pranishëm në takimin e Rostushës, "Boshkovski theksoi se projekti Fusha e Llukovës dhe Ura e Boshkut janë projekte zhvillimore për rajonin. Ai theksoi disa herë, se për këtë problem duhet të dëgjohet shoqëria aksionere, pjesë e shtetit, dhe jo disa njerëz dhe organizata që flasin lartë e poshtë shumë të pavërteta për ketë projekte. Drejtorit për investim dhe zhvillim, Aleksandar Paunovski, prezantoi projektet përmes një projektori. Ai nuk përmendi kapjen e 6 burimeve të Korabit. Ai fliste për akumulimin e liqenit të Fushë Llukovës, por nuk tregonte se nga do të vijë uji në atë liqen. Ai theksoi se banorët do të kenë shumë përfitime, por u kundërshtua nga dëgjuesit, pasi të njëjtat premtime kanë qenë edhe kur u ndërtua hidrocentrali i Spiles, por të punësuarit tanimë në atë hidrocentral vijnë nga Struga dhe Dibra nuk ka asnjë përfitim prej tij. Popovski theksoi se ELEM nuk do të prekë një minimum biologjik të ujit prej 10%, por nuk tregoi sa është ai minimum dhe tha se do tëlejojë 30% gjatë shumimit të troftës që është peshku i Radiks, por përsëri pa informacion sa sa është ajo sasi. "Popovski tha se Radika tani ka mbi 16 metër kub në sekondë, tregon Marku, por kur u pyet se ku janë bërë matjet e ujit, ai tha se matjet janë bërë te Ura e Boshkut". Por, te Ura e Boshkut, thekson Marku për gazetën "Rruga e Arbërit", vijnë edhe prurjet nga lumi i Gajres, duke mashtruar kështu me sasinë e prurjeve nga Radika, pasi dihet që lumi i Gajres nuk vjen nga gryka e Radikës, por nga gryka rrugës për Kërçovë.

Pyetjes se sa kanë qenë prurjet e ujit në vitet 1946, përfaqësuesit e ELEM i janë përgjigjur se kjo e dhënë është një sekret shtetëror, dhe si e tillë nuk mund të bëhet i ditur për publikun. Gjithashtu, ata kanë akuzuar diasporën shqiptare nëpër botë dhe shoqatat mjedisore ne Maqedoni se po spekulojnë me të vërtetën, si dhe marrja e ujërave të Radikës është edhe një kërkesë e qeverisë shqiptare, qysh kur ministër ka qenë Dritan Prifti.

"Projekti i prezantuar nga Aleksandar Paunovski, thotë Arberesha Klenja, një aktiviste pranë grupit të shoqatave joqeveritare në Dibër të Madhe, pjesëmarrëse në takimin e Rostushës, nuk ishte fare dinjitoz, pasi nëçdo prezantim vijnë me shifra jo të njëjta,gjë që ndodhi edhe këtë herë. Gjatë prezantimit, ata u munduar ta arsyetojnë si projekt ekonomik për përfitimin e energjisë elektrike, i cili do të ndikojë në rritjen ekonomike të Maqedonisë, por në fakt përfitimi i energjisë elektrike përfshin më pak se 1% e prodhimit të përgjithshëm të energjisë elektrike të gjithë Maqedonisë. Dhe ky investim milionësh nuk ia vlen për atë pak energji që do të prodhohet nga ky projekt, thotë Arbëresha, duke aluduar se ky është një mega projekt sllav, i cili synon përfitime për interesa të tyre. "Ironia më e madhe do të jetë, thekson ajo, nëse ky projekt do të realizohet, kjo do të ndodhë edhe me ndihmën e përfaqësuesve të shqiptarëve në Maqedoni, në Kosovë dhe Shqipëri.

Sipas pjesëmarrësve në këtë takim, dëgjesa publike në Rustushë u mbaj në një atmosferë të tensionuar. "Popullata e kishte të qartë se ELEM po mashtronte në ditën për diell. Drejtori Boshkovski duke dashur ta qetësojë atmosferën, tha se kjo që prezantuam nuk është një projekt. "Po kjo që na treguat, ishte përrallë", - pati një ndërhyrje nga një banor i zonës. Ndërkohë, edhe drejtori i parkut të Mavrovës, i pranishëm në takim, pati debate me një banor. Në Trebishtë pjesëmarrësit ikën nga salla dhe i lanë përfaqësuesit e ELEM-it të vetëm në sallë", thotë Dashamir Marku.

"Nga të pranishmit u kundërshtua fort dhe qartë ky projekt denigrues, siç e quajtën banorët e Rekës. Ata kërkuan që për këtë projekt të bëjnë referendum të banorëve të të gjithë zonës së prekur, të Dibrës, Rekës dhe Mavrovës, në të kundërt, nëse ky projekt merr miratim nga qeveria, ata kërcënuan se do të ndërmarrin masa radikale për zgjidhje e problemit", tregon për gazetën Arbëresha Klenja. "Nga të pranishmit u thanë qartë shkeljet që janë bërë në këtë projekt, si dhe u bënë pyetje të shumta, të cilat mbeten pa përgjigje, sepse përfaqësuesit qeveritarë nuk dinin si të përgjigjeshin. Dhe në fund pasi situata u acarua shumë, kryetari i komunës e ndërpreu mbledhjen me arsyetimin se mbaroi koha e parashikuar për këtë takim. Rekasit edhe njëherë treguan vendosmërinë për të kundërshtuar këtë projekt shkatërrues për ata dhe tërë zonën dhe dolën në mbrojtje të pasurisë së tyre", thotë Arbëresha.

A KA ZGJIDHJE PËR RADIKËN?

"Qëndrimi i rekasve dhe dibranëve është i prerë: Asnjë pikë uji të mos devijohet nga rrjedha normale e Radikës", - thotë Dritan Lleshi, drejtuesi i organizatave joqeveritare në Dibër. Ndërsa Dritani thekson vendosmërinë për të përdorur çdo metodë demokratike për të ndaluar projektin e ELEM, Jakup Marku, këshilltar i pavarur në këshillin Komunal të Dibrës, i ka propozuar Këshillit Komunal ngritjen e një grupi ekspertësh për të punuar në përgatitjen e një oponence kundër ELEM për ujërat. "Më datë 27 shkurt 2014, gjatë seancës së këshillit komunal të Dibrës, bazuar në një kërkesë të regjistruar që më 18 shkurt, i propozova këshillit marrjen e një vendimi për ngritjen e një grupi ekspertesh të hidrologjisë dhe fushave të përafërta përkatëse me pjesëmarrje edhe të këshilltarëve të Këshillit, me detyre që të vizitojnë, kontrollojnë dhe të bëjnë matjen e sasisë të ujit t ëtë gjitha burimeve të lumit Radika. Kjo bazuar edhe në të dhënat e ELEM-it në tubimin në Rostushë, të cilët "sasinë e ujit që ka pasur Radika në vitet 1945 - 1950 dhe sa është sasia e ujit që ka Radika sot, e konsiderojnë një sekret shtetëror".

"Jam i detyruar të theksoj se nuk gjeta mirëkuptim dhe përkrahje për këtë propozim nga kolegët e mi këshilltarë, duke e arsyetuar qëndrimin e tyre me pretekste, për mua, edhe tani të pakuptueshme", shkruan këshilltari i pavarur Jakup Marku në një postim në Facebook.

Sipas tij, lumit Radika deri më sot i janë marrë 80 % e ujit që ka pasur në vitet 1945-1950. Pra jo vetëm qe nuk duhet të diskutohet për grabitje e mëtejme të ujit të Radikës, por

(Vijon në faqen 5)

kryesore

Shpresojmë se mesazhi për ruajtjen e Parkut Nacional "Mavrovë" do të ndikojë te autoritetet. Me mbështetjen e kësaj proteste dëshirojmë t'u kujtojmë edhe një herë, të gjitha palëve të përfshira, për pasurinë që mund të humbasim!



Nga protestat në Mestre, Itali

Në qoftë se Maqedonia arrin ta devijojë Radikën, atëherë për dibranët në Dibrën e Madhe nuk ka rëndësi se kush i fiton zgjedhjet, pasi ata do të jenë të humburit!

(Vijon nga faqja 4)

duhet të kthehet edhe sasia tjetër që i është grabitur deri më tani".

Një letër me këtë përmbajtje i është dërguar Këshillit Komunal të Dibrës edhe nga Bardhyl Marku, një ndër më aktivët e mbrojtjes së Radikës, i cili jeton në Shkup.

Ndërsa aktivisti Dashamir Marku thekson se zgjidhja e këtij problemi duhet të vijë me heqjen dorë të menjëhershme dhe përgjithmonë nga qeveria e Maqedonisë për këtë projekt. "Për momentin duhet të ketë një ngrirje të çdo veprimtarie rreth punimeve dhe kjo ngrirje të jetë nën vëzhgimin e përfaqësuesve të zgjedhur të Dibrës.Të bëhet matja e tanishme se sa sasi uji është devijuar deri tani.Të rishikohen të gjitha marrëveshjet e ujërave mes dy shteteve, dhe në qoftë se këto marrëveshje janë realizuar në mënyrë të njëanshme, shkelësi i marrëveshjes të përgjigjet për demin e bërë. Sipas tij, faji kryesor përsa i përket këtij problemi është koalicioni qeverisës në Maqedoni, por ky projekt ka një histori të gjatë, kështu që edhe opozita ka përgjegjësinë e vet. "Ky projekt ka strategji gjeopolitike dhe u iniciua nga politika dhe nga politika duhet të zgjidhet", thekson Marku. "Nëse nuk merren masa për eliminimin e këtij projekti, populli duhet të bojkotojë zgjedhjet e përgjithshme si dhe duhet të ngrihet ne greva të përgjithshme, deri në shkrirjen e çdo strukture politike në Dibër". Gjithashtu, Marku thotë se në këtë çështje duhet të ndërhyje edhe shteti shqiptar, pasi sipas Kushtetutës së Shqipërisë, Shqipëria e ka obligim të mbrojë shqiptarët jashtë kufijve aktualë".

* * *

Ndërsa Maqedonia tani është futur në zgjedhjet Presidenciale të radhës dhe parlamentare të parakohshme, duket se çështja e Radikës do të luajë një rol parësor në përcaktimin e fituesve. Por, në qoftë se qeveria e Maqedonisë arrin ta devijojë Radikën, atëherë për dibranët në Dibrën e Madhe nuk ka rëndësi se kush i fiton zgjedhjet, pasi ata do të jenë të humburit!

opinion

Parku kombëtar i Mavrovës është i kërcënuar

Nga METODIJA VELEVSKI (Методија Велевски) *

Parku Kombëtar i Mavrovës është një nga parqet më të vjetra kombëtare në Evropë . Parku është i njohur në nivel ndërkombëtar si një zonë e rëndësishme të bimëve dhe të zogjve, një zonë kyçe nga aspekti i biodiversitetit dhe zonë Emerald.

Parku është zonë mbrojtëse për trembëdhjetë habitate të rrezikuara dhe lloje të shumta endemike si dhe lloje të rrezikuara që janë pjesë e listës së anekseve të Konventës mbi Ruajtjen e Jetës së Egër Evropiane dhe Habitateve Natyrore (Konventa e Bernës), që Republika e Maqedonisë e ka ratifikuar me ligj.

Sot kjo pasuri e jona kombëtare është e kërcënuar nga dy projekte të mëdha, të cilat jo vetëm kërcënojnë habitatet e shumta të llojeve të rrezikuara, por edhe dëmtojnë vetë idenë e parqeve kombëtare.

Në rekomandimet për menaxhimin dhe ruajtjen e zonave nga Unioni Ndërkombëtar për Ruajtjen e Natyrës (IUCN) theksohet se brenda kufijve të parqeve kombëtare nuk është e lejuar kryerjen e veprimtarisë tregtare, nëse supozohet se këto aktivitete do të kenë një ndikim negativ ndaj ekosistemeve natyrore dhe organizmave të gjallë që janë karakteristike për zonën, edhe nëse ky aktivitet konsiderohet si i qëndrueshëm! Veprimtari të lejuara në një park kombëtar konsiderohen aktivitetet tradicionale siç është bujqësia, ekoturizmi, peshkimi tradicional. Ndërtimin e objekteve të mëdha infrastrukturore është i palejueshëm..

Nga pikëpamja e IUCN –it është që menaxhimi i zonave të mbrojtura të synojë drejt ruajtjes, ose idealisht drejt zmadhimit të naturalitetit të ekosistemeve të mbrojtura " - theksojnë koalicionet "Ekologjia si prioritet" dhe "Natyra 2000".

Koalicionet ekologjike "Ekologjia si prioritet" dhe "Natyra 2000" e përshëndesin dhe mbështesin protestën e "Shoqatës Oda Dibrane " dhe të organizatave tjera të Dibrës dhe të Rekës. Të dy koalicionet para një muaj dërguan një deklaratë për ruajtjen e "Mavrovës", e cila është mbështetur nga 119 shkencëtarë të shquar dhe ekspertë nga e gjithë bota.

Shpresojmë se mesazhi për ruajtjen e Parkut Nacional "Mavrovë" do të ndikojë te autoritetet. Me mbështetjen e kësaj proteste dëshirojmë t'u kujtojmë edhe një herë, të gjitha palëve të përfshira, për pasurinë që mund të humbasim!



* Autori është kryetar i shoqatës ekologjike maqedonase, Macedonian Ecological Society. Kjo fjalë u mbajt në protestën e organizuar në Shkup më 15 Shkurt 2014.

Në foto:
Pamje nga protesta në Shkup.
Foto: Eko Stav

Ç'kemi ásaj Dibre!

Nga **BUJAR KAROSHI**

Ministri i punës dhe çështjeve sociale vizitoi Bulqizën. "Do bëjmë një shkollë të re profesionale, në mënyrë që fëmijët tuaj të mësojnë..." se si punohet në galeri. Dikur e kishin shkollën, por në demokraci menduam se për të nxjerrë kromin në sipërfaqe, nuk ka nevojë për t'u shkolluar. Gurin e zi e nxjerrim në shitje edhe pa shkollë. Disa ditë pas kësaj vizite, një kronikë televizive tregonte fëmijët e Bulqizës që mblidhnin kromin në sipërfaqe për 30 lekë/ kilogrami. Dhe kronika na tregoi se fëmijët tashmë nuk punojnë për "bukën e gojës", siç kemi dëgjuar gjithmonë, por për ... një hamburger! A nuk është ky një tregues i rritjes së mirëqënies?

Muaji shkurt ka qenë muaji i furgonëve. Besoj e di për e kam fjalën, për ato që presin pas pallateve në Laprakë gati për tu nisur për Peshkopi, që të turren kush e kush më parë të të kapë për krahu, dhe kur u thua se s'ke ndërmend të ikësh, të lëshojnë gjithë mërzi, si me hedhë një qese plehrash... Dibra ka mbi 140 të tillë, por tashmë vetëm rreth 40 udhëtojnë për Laprakë, Paskuqan, Kamëz dhe Bathore. Në Tiranë hyjnë vetëm për protestë. Pjesa tjetër bëjnë transport pasagjerësh katundeve të Dibrës, duke u ikur policisë rrugë e pa rrugë, përmes fshatrave dhe zabeleve... Andej nga ju u thoni mikrobuzë, por këndej u themi furgonë malli. Sepse njeriu është malli më i çmuar!

Dy vajza, një adoleshente dhe një e mitur, kërkojnë ndihmë për tu shëruar. Vijnë nga familje të varfëra dhe nuk i kanë paratë. Të ishin vajza zyrtarësh a ministrash, gazetat do të shkruanin për lukset e spitaleve ku gjetën shërimin...

Këtë muaj pati edhe lajme "periferike", një plagosje në minierë, një protestë për rrugën e keqe, apo për ndotjen e ujit të pijshëm nga kanalet e zeza. Ndonjë aksident i vogël apo vrasje nga gjaknxehtësia, por Radika vazhdon të mbetet çështje e ditës.

Një protestë e organizuar në Itali ishte shembull se si organizohen veprimtari të tilla, me parulla dhe flamuj. U mbajt edhe një e tillë në Shkup dhe Peshkopi! Që të merrje pjesë në to, pati oferta "Rezervo për në protestë", si me thënë "rezervo pushimet e paharruara". Biletat ishin falas për në Shkupl Por nuk kuptohej se kush e hidhte benzinën. Ne, që banojmë në Tiranë, duket se nuk jemi patriotë që të shkojmë në Shkup dhe Peshkopi. Dhe nuk e kuptojmë se pse, ngaqë nuk pati oferta apo s'na hodhi njeri naftën?

Protestat e patën një të mirë: na mësuan dhe treguan se si mund t'i shajmë organizatorët. Madje ti quajmë edhe të shitur, tradhëtarë! Në Tiranë janë harruar protestat, pasi organizatorët na dolën të shitur, ca te Rama, ca te Gruevski, ca te Basha... Tani parulla e re është: "STOP Devijimit të *Protestave të* Lumit Radika". Atdhetarët e mëdhenj kanë mprehur gishtat dhe gjithë natën rrinë vigjilentë në rrjetet sociale, që të kapin të shiturin e radhës, ndonjë ekologjist të vetmuar, që qan hallin e peshkut të Radikës, por nuk sulmon "troftat" e qeverisë...

Ndërsa po shkruaja këto radhë, pata një ofertë për të blerë një faqe në Facebook, ku dibranët mblidheshin bashkë, mbi 5 mijë, kokërr me kokërr.. E refuzova ofertën fantastike, pasi unë dua të blej faqen "Këtu përçahen dibranët". Si mendon, a bëhemi aksionerë?


Rruga e Arbërit nr. 94

opinion

Por këtu nuk është në pyetje vetëm krimi mjedisor. Për ne këto çështje janë shumë më të rëndësishme se ekologjia. Pa Radikën, rekasit do të humbin identitetin e tyre, ndërsa dibranët do humbin liqenin.

Kapja ujërave të Radikës është forma më e rëndë e krimit mjedisor





Shkup, 23 janar 2014,

Për: PUSHTETIT LOKAL DIBËR
KËSHILLI KOMUNAL DIBËR

23.01.2014

Nga: Bardhyl Marku

Lënda: Kërkesë për formim të grupit të ekspertëve i cili do të koordinojë aktivitetet lidhur me mbrojtje e lumit Radika si pasojë e planit të qeverisë për ndërtim të akumulimit në fushë të Llukovës.

I nderuar Z. Bashkim Mashkulli, Kryesues i Këshillit Komunal

Në letrën e mbi 110 ekspertë të njohur botërisht për mbrojtjen e mjedisit jetësor, thonë se digat e projektuara prishin idenë e parqeve kombëtare në përgjithësi dhe shkelin të drejtën e BE-së, të tilla si direktivat - NATURA 2000, Direktiva Evropiane për ujë dhe mjaft të tjera. Më tej, në letrën e tyre dërguar financuesve të mundshëm të digave në fushë të Llukovës dhe urë të Boshkut, ekspertët thonë se është e një rëndësie të veçantë të mbrohen zonat me vlera të larta ekologjike dhe se mbrojtja e sistemit ekzistues të parkut kombëtar është një domosdoshmëri e paevitueshme. Ne jemi të habitur se si institucionet e Maqedonisë janë të gatshëm për të mbështetur këto projekte të digave.

Por këtu nuk është në pyetje vetëm krimi mjedisor. Për ne këto çështje janë shumë më të rëndësishme se ekologjia. Pa Radikën, rekasit do të humbin identitetin e tyre, ndërsa dibranët do humbin liqenin.

Prandaj, duhet së bashku, kudo që të jemi, të luftojmë për të ruajtur rrjedhën natyrore të Radikës, ashtu siç na e ka dhuruar Zoti, ashtu siç e ka dhuruar nëna natyrë. Ne nuk duhet të dorëzohemi nga presionet dhe shantazhet. Ne nuk mund të heqim dorë, sepse Radika është lumi që na lidh, Radika është lumi i rinisë sonë, lumi pranë të cilit i kemi kaluar vitet më të bukura të jetës sonë. Në Radikë e kemi zënë peshkun parë, kemi pirë ujin e ftohët nën flladin e pemëve të saj. Por të mos harrojmë, në brigjet e tij shtrihen varret e të parëve tanë, atje ruhen sekretet e ekzistencës sonë, atje janë shkruar vuajtjet dhe historia jonë, betejat tona. Ajo është dëshmitare për të gjitha përpjekjeve tona për një të nesërme më të mirë, një jetë më të mirë për brezat e ardhshëm.

Radika është pjesë e historisë sonë, për Radikën janë kënduar këngë të panumërta, nëpër brigjet e Radiëks janë zhvilluar lufta të panumërta, Radika është pjesë e kulturës dhe trashëgimisë tonë. Por Radika jemi ne, një lumë i njerëzve që kanë ardhur sot këtu nga shumë vende. A do të lejojmë që nipërve tanë tu tregojmë historinë "Na ishte njëherë Radika, një lum shumë të bukur!" Jo, këtë nuk duhet ta lejojmë!

Në foto: Majtas, faksimile e letrës dërguar Këshillit Bashkiak të Dibrës së Madhe nga aktivisti Bardhyl Marku. Tekstin e letrës do ta botojmë numrin e ardhshëm. Lart, pamje nga protesta në shkup. Foto marrë nga grupimi në FB, *"Të mbrojmë lumin Radika"*

Nga **BARDHYL MARKU**

Më lejoni në fillim, në emër të shoqatës "ODA Dibrane", e cila është organizatore e kësaj proteste ekologjike, t'ju përshëndes të gjithëve, të cilët me pjesëmarrjen tuaj na jepni edhe më shumë forcë për të qëndruar në qëllimin tonë të përbashkët për të shpëtuar lumin Radika dhe parkun kombëtar të Mavrovës.

Dua me këtë rast, posaçërisht të falënderoj të gjithë dibranët, banorët e Rekës, të Zhupës, të cilët kanë ardhë në mënyrë të organizuar, pastaj qytetarët e Gostivarit e të Tetovës, dhe natyrisht shkupjanët, të cilët janë këtu me ne sot, të gjithë me një qëllim të përbashkët: mbrojtjen e Radikës. Dhe një falënderim i posaçëm shkon për dy koalicionet e shoqatave ekologjike "Ekologjia - Prioritet" dhe koalicioni "NATURA 2000", koalicione të cilat së bashku numërojnë 20 organizata në Republikën e Maqedonisë, të cilat veprojnë në mbrojtjen e mjedisit jetësor.

Qysh kur e filluam këtë nismë, gjithë kohës më është bërë një pyetje: A ka dikush të drejtë për të vjedhur një lum të tërë? A ka dikush të drejtë ta na e marrë ujin, ujë i cili do të thotë jetë për më shumë se 35 000 njerëz, ku një pjesë e tyre njihen pikërisht në bazë të këtij lumi, si banorë të Rekës, pikërisht nga lumi Radika? A ka të drejtë dikush të vendos për të tjerët? A ka dikush të drejtë për të shkatërruar një park të tërë kombëtar, a ka të dikush të drejtë të shkatërrojë fushat dhe brigjet e fundit të natyrës së paprekur. Unë nuk mund të rri pa bërë pyetjen: A ka drejtësi për krahinat tona?

Çdo brez merr një detyrë, çdo brez ka një mision, i cili duhet të realizohet për të mirën e brezave të ardhshëm.

Detyra jonë tani është të shpëtojmë Radikën dhe të shpëtojmë rajonin nga vdekja totale, për shkak se Dibra dhe Reka, pa Radikën kurrë nuk do të jenë ato që janë tani.

Mendoni një çast sikur Radika të mos ekzistojë, ose si rezultat i ndërtimit të digave në fushë të Llukovës, rrjedha e Radikës të zvogëlohet aq shumë sa që të mos arrijë kurrë deri në Dibër. Çfarë katastrofe do të ishte kjo për Dibrën, për Rekën, për Zhupën? Çfarë katastrofe do të ishte kjo për të gjithë ne që jetojmë atje ose jemi rritur atje? Çfarë katastrofe do të ishte për liqenin e Dibrës.

Çfarë do tu themi fëmijëve tanë? Çfarë do tu themi nipërve e mbesave tona? Si do t'ua shpjegojmë atyre se dikur vendi ynë ka qenë një ndër vendet më të bukura në Evropë, por ne nuk ishim të ndërgjegjshëm dhe nuk bëmë asgjë për të ruajtur bukuroshen e saj, Radikën. A do të kemi fytyrë që ndonjëherë të dalim para fëmijëve tanë, para nipërve tanë dhe ty themi: Na falni nuk e ruajtëm Radikën! Erdhën ca të etshëm për pasuri dhe për 60 megavat rrymë na e vodhën Radikën, lumin të cilin na e fali Zoti, lumi i cili kalonte nëpër fshatrat, nëpër livadhe dhe ndër dritaret tona. E morën lumin dhe e çuan diku larg, në disa vende të tjera, atje ku askush nuk e do dhe askujt nuk i duhet ai ujë i pastër si loti.

Çështja e devijimit, ndërtimit të digave dhe kapja ujërave të Radikës në vendin e quajtur Fushë Llukovë dhe devijimin e tyre nga rrjedha e tanishme në Dibër dhe Detin Adriatik, në një drejtim të ri përmes Liqenit të Mavrovës, në Vardar, në Shkup dhe në detin Egje, është forma më e rëndë e krimit mjedisor dhe moral.

Ekspertët thonë se duke devijuar lumin ekziston një kërcënim i madh për zhdukjen e mbi 150 lloje të bimëve endemike, troftës endemike të Radikës dhe rrëqebullit të Ballkanit, i cili në zonën tonë ka gjetur strehën e tyre të fundit në Ballkan.

Detyra jonë tani është të shpëtojmë Radikën dhe të shpëtojmë rajonin nga vdekja totale, për shkak se Dibra dhe Reka, pa Radikën kurrë nuk do të jenë ato që janë tani.

Ne nuk kemi asnjë mundësi tjetër, përveç të vazhdojmë në betejën tonë për të shpëtuar Radikën. Do të luftojmë bashkërisht, ashtu siç është e pandashme edhe rrjedha e ujit dhe Radika, i cili lidh bashkë dibranët, rekasit, zhupjanët... Radika do të na japë forcë, do na e rritë vullnetin dhe do na japë energjinë e paraardhësve tanë për ta shpëtuar.

Në i dërgojmë një mesazh të vetëm të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë, ELEM-it, Bankës Botërore dhe BERZH-it: ndaloni menjëherë dhe tërhiqni të gjitha planet për ndërtimin e objekteve të elektroenergjisë në Parkun Kombëtar të Mavrovës . Ne jemi të vetëdijshëm se Maqedonia ka nevojë për energji elektrike plotësuese, ne jemi të vetëdijshëm se Maqedonia deri në vitin 2020 duhet të ketë 20 % të prodhimit të përgjithshëm nga burimet e ripërtëritshme të energjisë. Ne nuk jemi kundër ndërtimit të hidrocentraleve, ne nuk jemi kundër arritjen së objektivit të 20 % e energjisë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë, ne nuk jemi kundër reduktimin të emetimit të gazit CO_2. Por ne jemi kundër ndërtimit të hidrocentralit në Fushë të Llukovës. Ne jemi kundër ndërtimit të hidrocentralit në urë të Boshkut. Ne jemi kundër shpenzimit të mbi 160 milion € , para të cilat, me nivelin tonë të zhvillimit ekonomik dhe me shkallën e Produktit Bruto të brendshëm vjetor, nuk e dimë nëse nipërit tanë do të jenë në gjendje të paguajnë borxhin. Ndërsa nga ana tjetër, të njëjtat parat mund të përdoret në mënyra të tjera, për shembull parku energjetik nga energjia e erës siç është ai në Bogdanc, i cili kushton 3 herë më pak se digat në fushë të Llukovës dhe në urë të Boshkut, dhe ofron të njëjtën sasi të energjisë elektrike, pa i bërë asnjë dëm mjedisit jetësor, pa bërë asnjë dëm social, pa rrezikuar të ardhmen e askujt dhe në të njëjtën kohë, duke shpenzuar shumë më pak para publike.

Prandaj, së bashku, ne do të fitojmë dhe Radikën! Ne do të shpëtojmë Radikën!

intervistë

"Për problemin e Radikës por edhe të Vjosës Instituti është inekzistent. Unë jam përfshirë thjesht personalisht dhe në asnjë rast nuk prezantohem si punonjës i Institutit. Instituti do përfshihej në rast se shteti do përballej me këto probleme. Nëqoftëse shteti fle ne si institut jemi duke dihatur".

Radika, projekti është i pamundur!

Nga **BEN ANDONI**

Intervistë me specialistin e njohur të hidrologjisë, prof. Dr. Molnar Kolaneci, një nga specialistët më të vjetër të Institutit Hidro-meteorologjik për problemin e Radikës. Ku janë vështirësitë e këtij projekti, pse nuk u bë transparent problemi dhe sa është e mundur në kushtet tona, që ai të realizohet nga vendi fqinj...Problemi është ideja, shprehet specialisti pasi projekti s'është ende gati. Dhe, ky është problemi i vërtetë...

Tashmë e gjithë tollovia e ujrave me Maqedoninë është e zgjidhur. Kuptohet, për momentin. Në një dalje të tij të fundit për median, Ministri shqiptar i Energjetikës u shpreh se është thjesht një furtunë në një gotë ujë. Në fakt, problemi s'është aq i lehtë dhe për hir të së vërtetës edhe njëherë tjetër ka treguar sesa është i neglizhuar kuadri shkencor në Shqipëri. Në këtë intervistë, Z. Kolaneci, një nga autoritetet shqiptare të hidrologjisë, shpjegon të gjithë problemin e Radikës dhe sesi ai ka filluar vite e vite të shkuara. Paradoksalisht, që para 50 viteve më parë, maqedonasit (lexo Ish-Jugosllavia) e ka bërë devijimin e lumit, madje edhe me mbështetjen e miratimin e shqiptarëve. *"Tani historia që po përflitet ka të bëjë me një rimarrje tjetër plus nga lumi Radika duke bërë ndërhyrje gjigande (diga 71 m dhe kanale 20 km) në një zonë që është edhe park kombëtar. Ky është një projekt që është i shpallur publikisht dhe ata po kërkojnë donacione. Qeveria shqiptare është vënë në dijeni që ekziston ky lloj projekti në 27.11.2013 dhe Gjiknuri ka mbajtur pozicion shumë të saktë"*, cilëson profesori Kolaneci...

A mund të na shpjegoni teknikisht se për çfarë rëndësie strategjike ekonomike janë për vendet respektive devijimet e Radikës në Maqedoni dhe Vjosës në Greqi?

"Pikësëpari, Maqedonia ka probleme me ujërat se nuk ka asnjë lum të vetin. Në Maqedoni të gjitha rrjedhat ujore hyjnë dhe dalin nga territori i saj meqenëse nuk ka dalje në det.

Me ujërat e Radikës është formuar sistemi hidroenergjetik më i madh i Maqedonisë që mbulon rreth 34-35% të prodhimit total (hidro). Me ujërat e Radikës është krijuar liqeni artificial i Mavrovës (1949) dhe më vonë në vitet 1950 u krijua kaskada hidroenergjetike e Mavrovës me tre hec-e. I pari, Verben, derdh ujërat në Mavrovë, ndërsa dy të tjerët (Vrutok dhe Raven) nëpërmjet një tuneli marrin ujë nga liqeni i Mavrovës. Uji që përdorin këto dy hec-et e fundit nuk kthehet në Radikë por shkojnë në Vardar dhe përfundojnë në detin Egje. Hec-i Vrutokut është hec-i më i madh në Maqedoni. Në mënyrë të përmbledhur, Maqedonia ka mbi 50 vjet që e ka devijuar Radikën dhe me pëlqimin e shqiptarëve. Tani historia që po përflitet ka të bëjë me një rimarrje tjetër plus nga lumi Radika duke bërë ndërhyrje gjigande (diga 71 m dhe kanale 20 km) në një zonë që është edhe park kombëtar. Ky është një projekt që është i shpallur publikisht dhe ata po kërkojnë donacione. Qeveria shqiptare është vënë në dijeni që ekziston ky lloj projekti në 27.11.2013 dhe Gjiknuri ka mbajtur pozicion shumë të saktë dhe unë se kuptoj pse kanë heshtur deri tani, disa organizime të shoqërisë civile që po ngrenë zërin ! Sikur Gjiknuri të kishte dhënë përgjigjen që i dha Alsat-it të Maqedonisë dhe për mediat shqiptare nuk do ishte bërë ky konfuzion. Në bazë të këtij projekti në sistemin hidroenergjetik të Mavrovës do të ketë një përfitim shtesë prej 159 GWh për Maqedoninë".

Dhe cila është humbja jonë?

"Përsa i përket humbjeve që kemi ne në anën tonë paraprakisht po të citoj vlerësimin e komisionit të atëhershëm që thotë, citoj: 'Pala shqiptare ka dhënë pëlqimin për marrjen e ujerave të pjesës së sipërme të Radikës. Në këtë mënyrë pala shqiptare do të ketë në të ardhmen, kur të ndërtohen gjithë hidrocentralet në Drin një humbje energjie prej 250 milion kw-ore në vit, me një vleftë prej 2.5 milion dollarë'".

A ekzistojnë memorandume mes vendeve tona, konform të drejtës ndërkombëtare, që projekte të tilla të kenë marrëveshje bi ose trilaterale?

"Ekziston marrëveshja me Jugosllavinë nëpërmjet një Komisioni të Përbashkët të ujërave e cila është kurorëzuar mbas shume takimesh në Protokollin e vitit 1962. Në këtë marrëveshje nga gjashtë pika në pikën 6 përfshihet edhe Radika. Në të vërtetë në shpjegimin e Protokollit thuhet që pavarësisht se data e protokollit është 1962 marrja e ujit ka filluar që në 1958, që përkon afërsisht me fillimin e punës se hidrocentraleve që punojnë me ujin e liqenit të Mavrovës. Të drejtat ndërkombëtare janë rregulluar me ligj me konventa të ndryshme që datojnë pas 1990, pra marrëveshjet tona janë para këtyre dhe janë me tepër bilaterale.

Kohet e fundit sidomos pas viteve 2000 ka marrëveshje bilaterale dhe trelaterale për Prespën dhe Ohrin dhe një e fundit fare 2011 është një marrëveshje multilaterale për pellgun ujëmbledhës të lumit Drin që nga Prespa e deri në Bunë dhe detin Adriatik. Sot thuajse është e pamundur të bëhen aventura sepse po ti kthehemi Radikes, projekti që po përflitet kërkon minimalisht 62 milion euro që Maqedonia po kërkon t'i gjejë borxh dhe është shumë vështirë të gjesh sot donatore që mund ta hanë atë projekt".

A njihen precedentë të tillë të viteve ose dekadave të mëparshme dhe si janë zgjidhur?

"Bisedimet në mbledhjet e komisioneve të përbashkëta me jugosllavët kanë qenë tepër të egra dhe në një moment të caktuar për të bërë balancim pala shqiptare me në krye Prof. Petrit Radovicka kërcënoi duke paraqitur një projekt, që do merrte ujë nga liqeni i Ohrit nëpërmjet një tuneli të Qafa e Thanës dhe ta hidhte në Shkumbin. Natyrisht që kjo i tërboi jugosllavët dhe më në fund marrëveshja përfundoi ashtu siç duhej me miratim të të dy palëve. Në atë kohë komisioni ynë kishte shumë ekspertë...".

Sa i përfshirë është Instituti shqiptar Hidrometeorologjik në të gjithë këtë proces?

"Për problemin e Radikës por edhe të Vjosës Instituti është inekzistent. Unë jam përfshirë thjesht personalisht dhe në asnjë rast nuk prezantohem si punonjës i Institutit. Instituti do përfshihej në rast se shteti do përballej me këto probleme. Nëqoftëse shteti fle ne si institut jemi duke dihatur".

Si një nga specialistët më me përvojë të ujërave, si e shihni këtë proces, a është i mundshëm apo është thjesht një stuhi ngritur në një gotë ujë?

"Tani ndofta s'ka vlerë mendimi im se situata precipitoi dhe nuk ka diskutim që s'ka për të ndodhur gjë. Personalisht që në fillim ju kam thënë të gjithëve, madje edhe njerëzve të protestës se kjo nuk është kauzë pasi ajo është e fituar që në fillim. Ishte e pamundur të realizohej ai projekt. E gjithë kjo për mendimin tim vjen nga ngadalësia e qeverisë që përkthehet në



paaftësi, ose ndonjë lloj strategjie të cilës nuk i gjej dot emër".

Sipas mendimit tuaj, a duhet që politika shqiptare t'i dalë përpara qoftë edhe përfoljes së projekteve të tilla?

"Pa dyshim politika e ka mundësinë të dalë përpara. Ne si institut për një jave arritëm t'i japim në mënyrë jo zyrtare Ministrisë së Energjetikës situatën e reshjeve të vitit 2013 dhe situatën aktuale të prurjeve të Drinit të Zi. Megjithatë instituti është në periferi të interesit. Nëse e keni vënë re, në programin e qeverisë, si edhe në strukturat e saj, fjala shkencë as nuk përmendet. Kini parasysh se jashtë modestisë edhe për pak vjet do të zhduket ajo kujtese teknike që kanë disa njerëz që kanë mbetur akoma në pune dhe pastaj hendeku i krijuar është tmerrshëm.

Të mos harrojmë se për problemin e ujërave duhet të dini se ekzistojnë komisionet e përbashkëta të eksperteve për çështjet e ndryshme që dalin. Për ironi të fatit, unë jam anëtari i komisionit me Maqedoninë. Mirë që nuk jemi mbledhur asnjëherë (4-5) por ata fare mirë në një moment të tillë mund të mbledhin anëtarët e komisionit dhe problemi kishte marrë përgjigje nëqoftëse qeveria do të japë përgjigje të përgjegjshme. Duket se qeveritë e pas '90 nuk e dinë se ku ta kapin thelbin e problemit.

Kam ndjesinë që ndërrimi i qeverive ndërron gjithë stafet dhe specialistet, ndërkohë që ata të rinjtë që vijnë mund të dinë shumë, mirë por duan një mandat të marrin vesh ku janë çelësat e zgjidhjes se problemeve të ndryshme. Shiko çfarë ndodh me Ministrinë e Mjedisit (e drejtuar nga LSI-ja) për çështjen e Radikës, në ministri ekziston një drejtori e administrimit ujor të vendit që nëpërmjet komisioneve bilaterale që ju shpjegova me sipër duhet ta kishte kapur situatën. Por shikoni se çfarë ndodhi ... LSI na kërkon interpelance me ministrinë e jashtme duke mos ditur se ministria e mjedisit (drejtuar prej tyre) është po aq përgjegjëse".

Marrë nga revista JAVA.
(http://www.revistajava.al/)



Lumi Radika. Foto: © *Flamur Bajrami*

Shenim

Paradokset ballkanike dhe kur flitet për lumenjtë

Nga **BEN ANDONI**

Në protestat që u zhvilluan për devijimin e Radikës dhe të gjithë çështjeve lidhur me të, do bënte shumë përshtypje edhe dalja e LSI-së, partnerit kryesor qeverisës të maxhorancës aktuale. Madje, përmes deputetëve të saj me ton të lartë, ajo i kërkoi qeverisë së sotme transparencë. Deri këtu, gjithçka është konform interesit publik. Për publikun e gjerë që nuk njeh mirë strukturat e shtetit shqiptar, ky do quhej një lloj emancipimi skajor politik. Në fakt, 'problemi' nëse mund të quhej i tillë serioz, përfshinte direkt edhe vetë LSI-në. Ministria e Mjedisit (e drejtuar nga LSI-ja) për çështjen e Radikës, duhej të përgjigjej e para me anë të drejtorisë së saj të administrimit ujor të vendit pjesë e këtij dikasteri, e cila nëpërmjet komisioneve bilaterale duhet ta kishte kapur situatën dhe të merrte të gjithë hapat e nevojshëm. Nuk ndodhi asgjë nga kjo, përveç faktit që LSI-ja kërkon interpelance me ministrinë e jashtme duke mos ditur se ministria e mjedisit ishte po aq përgjegjëse!

Në hullinë e ngjarjes, për problemin e ujërave që përshkojnë vendet fqinje, ekzistojnë komisionet e përbashkëta të eksperteve për çështjet e ndryshme që dalin. *"Për ironi të fatit,* citojmë z. Kolanecin- *unë jam anëtari i komisionit me Maqedoninë. Mirë që nuk jemi mbledhur asnjëherë (4-5) por ata fare mirë në një moment të tillë mund të mbledhin anëtarët e komisionit dhe problemi kishte marrë përgjigje nëqoftëse qeveria do të japë përgjigje të përgjegjshme. Duket se qeveritë e pas '90 nuk e dinë se ku ta kapin thelbin e problemit"*. Edhe njëherë ka dalë në pah ajo që i mungon këtij vendi dhe që lidhet direkt me nënvlerësimin në maksimum të trurit shkencor. Institucionet shkencore me varësitë ndryshe strukturore, pas prishjes së Akademisë, jo që nuk janë më efikase, por më shumë akoma po atrofizohen duke marrë me vete në këtë bjerrje dhe kujtesën dhe punën e madhe që kanë bërë breza të tërë njerëzit të pasionuar shkencëtarësh, mes tyre shumë atdhetarë të vërtetë.

Në rastin tonë, ndryshe nga ne shqiptarët, Maqedonia edhe pse shumë më tepër inferiore se ne në resurse natyrore por edhe njerëzore, ka punuar në interesin e saj. Radikën që e ka prekur dikur, madje me miratimin e shqiptarëve ka ndërmend ta rimarrë sërish për ta shfrytëzuar. Dhe ketu qëndron çështja: Ideja e tyre për ta prekur sërish Radikën. Sipas mënyrës së saj, Maqedonia ka punuar. Nga deklaratat disi kontroverse të Shoqërisë Civile dhe të zyrtarëve tanë kuptohet se nuk ka hapa konkretë, por në fakt që është punuar prej tyre: Po. Dalja e ministrit Gjiknuri i ka fashitur zërat, kurse ajo e homologut të tij të Maqedonisë, duket se i ka dhënë pak oksigjen më shumë shqiptarëve (ai vetë është shqiptar) kur ka thënë se: *"Projekt final për Fushën e Lukovës ende nuk ka dhe nuk ka as studim mbi ndikimin ndaj ambientit jetësor, që janë dy elemente kyçe për një projekt për të pasur bazën që të fillojë. Çështje tjetër, ky projekt ende nuk ka siguruar burime financiare; Banka Botërore nuk e ka kreditуar këtë projekt, duke pasur parasysh, sipas rregullave të këtij institucioni, po qe se ka efekte negative sidomos ndaj ambientit jetësor, atëherë nuk besoj, se do të kreditonte një projekt të tillë"*. Fakti që ministri Valon Saraçini e ka mbështetur dhe tregon ecurinë tregon se institucionet funksionojë gjithsesi më shumë se tek ne, madje edhe me më shumë largpamësi.

Dhe, në të gjithë këtë qerthull, publiku i gjerë dhe Shoqëria Civile që donte ta bënte kauzë, nuk e dinte se Radika është shfrytëzuar nga Maqedonia prej më shumë se 50 vjetësh. Për fat të mirë, për ndryshe në atë kohë, bisedat zhvilloheshin me specialistë të niveleve vërtetë të larta dhe me tagër shkencor dhe moral, të tillë Prof. Petrit Radovicka që kur jugosllavët (flitet për 50 vite të shkuara) kërcënuan duke paraqitur madje edhe projektin e përfunduar, ai ua ktheu në emër të Shqipërisë se do merrte ujë nga liqeni i Ohrit nëpërmjet një tuneli të Qafa e Thanës dhe ta hidhte në Shkumbin. Kjo e bëri federatën që të ishte konform kërkesave të shqiptarëve dhe të nënshkruante me miratimin e të dy palëve. Mbase kjo na duhej dhe tani dhe jo cic-micet e politikanëve dhe metaforat e hedhura për të fshehur ato që nesër mund t'i vuajnë jo pak shqiptarët dhe ekonomia e vendit.

Rruga e Arbërit nr. 94

Flet kryetari i Këshillit të Komunës të Dibrës së Madhe,
Bashkim Mashkulli: Presim mbështetjen e qeverisë shqiptare.

intervistë

"Zona aktualisht është militarizuar dhe po punohet në kantierin e ndërtimit"

Nga **HASAN PASHA**

DIBËR E MADHE-Bashkim Mashkulli, kryetar i këshillit komunal të Dibrës së Madhe është një ndër më aktivët për ndaljen e devijimit të lumit Radika. Ai dhe mbështetës të tij kanë marrë pjesë në tubimet e organizuara në Dibër të Madhe, Peshkopi e Tiranë. Në një intervistë për gazetën "Rruga e Arbërit", Mashkulli thotë se "këshilli komunal ka siguruar një kopje të projektit për ndërtimin e hidrocentralit, por vendorët e Dibrës së Madhe njëzëri e kanë kundërshtuar projektin e qeverisë së Maqedonisë". Meqenëse janë kërkuar fonde nga Banka Botërore, këshilltarë e specialistë të Dibrës së Madhe kanë asistuar në një takim me ekspertët e kësaj banke. Sipas Mashkullit, zakonisht Banka Botërore nuk zbaton projekte që bien ndesh me interesat e komuniteteve, pra kërkohet dakordësia e tyre. I zgjedhuri lokal në komunën shqiptare shprehet se "qeveria shqiptare duhet të mos lejojë devijimin e Radikës, ndryshe pasojat do të jenë të rëna". Ai thotë se fundja shteti shqiptar duhet ta çojë në arbitrazh ndërkombëtar këtë çështje delikate.



> Nga shteti shqiptar jo vetëm që kërkojmë mos jepet leja për hidrocentralin e Fushës së Lukovës, por në bazë të rregullave ndërkombëtare të krijohet një grup pune që realisht të mat prurjet e lumenjve ndërshtetëror. Në rast mosmarrëveshje duhet notë proteste për rikthimin e ujërave që në mënyrë të padrejtë janë devijuar deri tani...

> Në terr informativ për publikun, me punime gjoja riparuese të kanaleve ekzistuese, me militarizim të zonës së ndërtimit dhe moslejimin dhe pengimin e qytetarëve për kalim të lirë në ato zona, si dhe furnizime të vazhdueshme me material ndërtimor të kantierit.

Pyetje: Kur është foluar për devijimin e lumit Radika ?

Bashkim Mashkulli: Lumi Radika është devijuar me ndërtimin e Hidrocentralit të Mavrovës nga ish Jugosllavia në vitin 1952, ku në versionin fillestar është përfolur për 9m3 ujë të marra nga rrjedha natyrore direkt nga burimet. Por gjatë këtyre 60 vitesh nuk ka pasur asnjë studim serioz dhe të pavarur për të parë realisht se sa m3 ujë është marrë nga burimet e Korabit dhe Sharrit për t'i çuar fillimisht në liqenin e Mavrovës dhe nëpërmjet saj jo në drejtimin natyror të ujërave, por në lumin Vardar. Nuk kemi studim, prandaj nuk mund të japim fakte konkrete por nga ajo ç'ka kanë konstatuar ekspertët nga shikimi në terren besojmë se në mënyrë të vazhdueshme është rritur sasia e ujërave të devijuar.

Sa i përket projektit Fusha e Lukovës është përfolur që në vitin 1989, por shkatërrimi i Jugosllavisë mesa duket ndaloi realizimin e tij, dhe vijmë në kohët moderne ku në kuadër të "projekteve" të qeverisë Gruevski në shumë sfera, dhe veçanërisht në energjetikë fillojnë punimet për përpilimin e projektit dhe fillimin e punëve të ndërtimit të Hidrocentralit. Në terr informativ për publikun, me punime gjoja riparuese të kanaleve ekzistuese, me militarizim të zonës së ndërtimit dhe moslejimin dhe pengimin e qytetarëve për kalim të lirë në ato zona, si dhe furnizime të vazhdueshme me material ndërtimor të kantierit. Ishte shqetësimi i qytetarëve të cilët gjatë udhëtimit në rrugën nacionale Dibër-Mavrovë gati çdo ditë shikonin mjete punuese që drejtohen nga kantieri i ndërtimit, që na bëri të interesohemi se çka realisht po ndodh dhe po planifikohet të ndërtohet.

Si ka reaguar këshilli komunal dhe të zgjedhurit e tjerë të Dibrës së Madhe ?

Bashkim Mashkulli: Këshilli i komunës Dibër në bazë të detyrës zyrtare dhe unë personalisht filluam të investigojmë rreth të vërtetës që dukej se po tentohej të fshihej, dhe me ndihmën e profesionistëve arritën të sigurojmë projektin e qeverisë së Maqedonisë dhe kompanisë ELEM me financim nga Banka Botërore. Dhe në mbledhjen e 4 qershorit 2013 vendosëm në rendin e ditës diskutimin mbi projektin Fusha e Llukovës. Dhe në mënyrë unanime nga të gjithë këshilltarët pavarësisht partive që përfaqësojnë dhe kombësive të ndryshme pjesë e këshillit të Komunës Dibër duke respektuar edhe mbivotimin në pazë të parimit të badenterit, u votua kundër këtij projekti dhe u sollën konkluzat mbështetëse të vendimit kundër. Vendimi dhe konkluzat iu dërguan menjëherë qeverisë së Maqedonisë dhe ministrive përkatëse, kompanisë ELEM, Bankës Botërore si dhe qeverisë në detyrë të Shqipërisë dhe zyrës së kryeministrit të zgjedhur Rama. Nga gjithë këta institucione, institucioni i vetëm që u përgjigj ishte Banka Botërore e cila kërkoi të zhvillohet një takim. Takimi informues mes pushtetit vendor dhe saj u zhvillua rreth dy javë pas mbledhjes së këshillit, ku Banka Botërore ishte kujdesur që të siguroj edhe prezencën e përfaqësueseve të qeverisë. Në takim nga ana jonë ishin ftuar eksperte të ujërave, pjestarë të shoqërisë civile dhe të gjithë këshilltarët e Kuvendit komunal. Dhe me anë të fakteve dhe fuqisë së argumentit, personalisht nga ana e kreut të Bankës Botërore për Europë dhe Azi morëm premtimin se kjo çështje do të shqyrtohet në bazë të parimeve dhe polikave të saja. Projekti i Bankës Botërore gjendet lehtë online dhe ndër parimet kryesore të saja janë dakordësia me komunitetit për investimin e ndonjë projekti.

A keni kontaktuar Ju me autoritetet shqiptare dhe maqedonase ne lidhje me këtë plan te qeverise se atjeshme ?

Bashkim Mashkulli: Përveç vendimit dhe konkluzioneve të dërguara fillimisht, me autoritetet shqiptare nuk kemi gjetur kanal tjetër komunikimi. Ndërsa me ministrat shqiptar në qeverinë Gruevski u zhvillua një takim, dhe nga ata na u premtua se nuk do të lejojnë ndërtimin e këtij hidrocentrali nëse do të ketë impakt negativ mbi ambientin. Dhe meqë nga ana jonë nuk ka diskutim se ka apo nuk ka impakt negativ mbi qytetin tonë, florën e faunën, prurjet në kaskadën e Drinit nuk besojmë se ka nevojë për asnjë verifikim të ardhshëm, apo marrëveshje të brendshme apo mes dy shteteve për atë se duhet apo s'duhet të ndërtohet ky hidrocentral.

Ju dhe qytetarët shqiptarë po protestojnë fort, ka një reagim konkret nga qeveritarët apo deputetët ?

Bashkim Mashkulli: Megjithë premtimet e dhëna, skepticizmi jonë vazhdoi. Mosbesimi ndaj qeverisë Gruevski nga ana e qytetarëve dibranë është i madh, duke i shtuar kësaj edhe gjendjen në të cilën ndodhet Maqedonia, niveli i demokracisë, mungesës së informacionit për vendimet dhe punët e qeverisë, kapjes së medias nga pushteti (ku asnjë media kombëtare nuk ka pasqyruar as edhe një lajm të vetëm për shqetësimin tonë), sidomos pas deklaratës këmbëngulëse të zëdhënësit të qeverisë së Maqedonisë, se projekti do të realizohet pavarësisht zërave kundër, shtuan frikën tonë se pas disa kohësh mund të gjendemi para faktit të kryer, dhe mjetet tona të tanishme të protestës do ishin të pamjaftueshme nëse projekti do të arrinte në fazën përfundimtare. Nga shoqëria civile u organizua një protestë fillimisht në qytetin e Dibrës, duke u pasuar nga protestat në Tiranë dhe Peshkopi.

Nëse zëri Juaj dhe shqiptarëve në përgjigjësi nuk dëgjohet cili do të jetë reagimi i metejshëm?

Bashkim Mashkulli: Fillimisht ne shpresojmë që shteti shqiptar do të ndërmarrë masat e duhura për ndalimin e këtij projekti, pasi Radika është një lum ndërkombëtar dhe me termin lumenj ndërkombëtar nënkuptohen rrjedhat e ujërave të cilat ndajnë ose kalojnë nëpër territoret e shteteve të ndryshme, pra të gjithë lumenjtë e lundrueshëm ose të palundrueshëm. Lumenjtë e tillë janë nën regjim juridik special. Ata, në një anë, janë pjesë përbërëse e territorit shtetëror, në atë pjesë që shtrihet brenda kufijve shtetëror, kurse në anën tjetër janë gjithashtu instrument i rëndësishëm i jetës ekonomikë ndërkombëtare. Rregullat e sovranitetit të plotë shtetëror mbi tërë territorin e vet, kur është fjala për lumenjtë ndërkombëtar, nuk vlejnë në kuptimin absolut. Shtetet dhe në këtë rast Maqedonia nuk mund të disponojë plotësisht me ujërat e lumit që kalon apo buron nga territori i tij e as të ndërmarrë ç'kado qoftë që do të dëmtonte interesat e shteteve tjera në të cilat vazhdon rrjedha e atij lumi, në këtë rast shteti shqiptar. Pra, e drejta ndërkombëtare nuk lejon që një shtet t'i shfrytëzoje ujërat e lumit në atë mënyrë që do t'u shkaktonte dëme shteteve tjera. Nga shteti shqiptar jo vetëm që kërkojmë mos jepet leja për hidrocentralin e Fushës së Lukovës, por ne bazë të rregullave ndërkombëtare te krijohet një grup pune që realisht të mat prurjet e lumenjve ndërshtetëror. Në rast mosmarrëveshje duhet notë proteste për rikthimin e ujërave që në mënyrë të padrejtë janë devijuar deri tani, dhe në rast rezistence shteti shqiptar duhet të zgjedh arbitrazhin ndërkombëtar që besojmë do të gjykojë drejtë dhe do të ngelet si precedent për të mos guxuar çfarëdo qeverie apo propagande mbi dobinë ekonomike të devijimit të ujërave, në të ardhmen të krijojnë projekte të ngjashme. Ne jemi të bindur se ky projekt është thellësisht politik, pasi në rrjedhën natyrore të ujit ekziston mundësia e ndërtimit të hidrocentraleve me dobi shumë më të madhe ekonomike dhe pa dëme ekologjike. Nuk i besojmë arsyes qeveritare, pasi qeveria e Maqedonisë, sidomos qeveria Gruevski ka treguar se është sinonim i absurdeve dhe shpërdorimeve të mëdha të këtyre 8 viteve të fundit. Me padurim pritëm reagimin e qeverisë shqiptare dhe kryeministrit shqiptar, dhe përtej frazave klishe si ajo e "shumë zhurmë për asgjë", fillimisht duam të sigurojmë se protestat dhe zhurma jonë nuk drejtohen drejt shtetit shqiptar, por drejt qeverisë së Maqedonisë, me shpresën se do të ngacmojmë reflektorët ndëgjues të institucioneve qeveritare shqiptare. Qeveria e Maqedonsië ka projekt të detajuar mbi liqenin e Fushës së Lukovës dhe devijimin e lumit Radika. Historia na ka treguar se këta devijime janë bërë edhe pa miratimin e shtetit shqiptar, në kohë të vështira për shqiptarët këtej e andej kufirit. Besojmë se qeveria e re shqiptare përtej reformës mbi doganat deri dje pa tra, shtetit fatkeqësisht pa institucione të forta, të pavarura dhe të besueshme, të hedh sytë edhe drejt raportit me fqinjët, drejt ujit që hyn në Shqipëri, sasisë së saj, dhe moslejimit të keqpërdorimit në dëm tonë si qytet fillimisht, dhe vet shtetit shqiptar. Për mendjet dhe shpirtrat e qetë, zhurma është veçse një tingull i heshtur, por për ne zërat dhe gojët që mezi dëgjohemi, për çështje parimore, zhurma që po bëjmë është mënyra e vetme për të na lehtësuar shpirtrat.

SHËNIM I REDAKSISË:

Kjo intervistë u realizua nga gazetari Hasan Pasha për një gazetë qendrore në Tiranë, e cila refuzoi ta botonte intervistën. Më pas, ajo u soll në redaksinë e gazetës Rruga e Arbërit për botim, por meqë gazeta ishte përgatitur më parë, vendosëm ta shtyjmë për botim në Shkurt. Me këtë rast, redaksia i dërgoi edhe disa pyetje të tjera zotit Bashkim Mashkulli, për ta aktualizuar cështjen si dhe për të qënë më e përshtatur me faktet e reja. Pyetjet e redaksisë janë si më poshtë, por përgjigje nuk morëm nga zoti Mashkulli, me gjithë premtimin që na dha përmes komunikimit në FB. Shpresojmë që përgjigjet për këto pyetje t'i botojmë numrin e ardhshëm.

- Muaji dhjetor 2013 dhe Janar 2014, pati një sensibilizim të madh edhe në media, jo vetëm në Maqedoni dhe Shqipëri, por edhe në Europë. Si mendoni se paraqitet gjendja tani? A ka një tërheqje të qeverisë së Maqedonisë nga këto projekte?

- A ka Komuna e Dibrës së Madhe një program-plan se si do ti kundërshtojë këto iniciativa për devijimin e Radikës në ditët që vijnë?

- Në mediat sociale dhe forume të ndryshme në internet, po qarkullojnë ide se "qeveria e Maqedonisë" po paguan njerez me ndikim në komunitetin Dibran dhe me gjerë, për ta ulur nivelin e protestës? Çfarë mendoni ju për këtë? A janë të vërteta këto zëra?

- Kjo çështje herë trajtohet si politike dhe herë si ekologjike? Çfarë mendoni ju? Nga do të vijë zgjidhja e çështjes, nga vendimet politike apo nga mekanizmat për mbrojtjen e natyrës?

propozimi

- Blirët e Shetitores së Peshkopisë duhet të shpallen MONUMENT KULTURE, të vihen në kujdesin e qytetit dhe të shtetit.
- Blirët e Shetitores së Peshkopisë e kanë bërë me kohë thirrjen e tyre për ndihmë. Rrënjët e tyre i kanë çarë betonet dhe kanë dalë mbi pllakat e këmbësoreve në të dy anët e bulevardit. Ata kërkojnë ndihmën e specialistit që të vijojnë jetën e tyre, pse jo, njëqind, dyqind, pesëqind... vjeçare si bashkëllojet e tyre në Gjermani....



Foto: © A.Ashiku

Bliret e Peshkopisë *duhet të shpallen* monument kulture

Nga **ABDURAHIM ASHIKU**

Sot ndoqa një emision për Blirin, pemën që për dibranët, falë mjeshtrit të madh të bimëve dhe luleve Agush Selishta, është bërë simbol i qytetit të Peshkopisë.

Sigurisht emisioni nuk ndalej dhe as fliste për Blirët e Bulevardit qendror të Peshkopisë, madje duke parë e njohur moshën e re të tyre as që do ti fuste njeri në llogari.

Emisioni fliste për blirë shekullorë, madje mijëvjeçarë në Gjermani. Një emision që mua dhe Natashën, bashkëshorten time, na ngjalli kërshëri dhe e ndoqëm nga fillimi deri në fund. Nostalgjia na mori me vete dhe na çoi në Peshkopi nën kurorën e mrekullueshme të blirëve mbjellur dhe rritur me kujdes nga xha Agushi, me gjoksin fryrë nga aroma e luleve në ditët e fundmuajit të qershorit dhe fillimmuajit të korrikut, aromë që në ditën e parë të korrikut 1975 na ngazëlleu ti vinim vajzës sonë emrin Erblina...

Në emision flitej, shoqëruar me filmime tejet profesionale, për blirin si një bimë shënjtore, bimë që i kishin bashkangjitur pas emrin e Maries, nënës së Jezu Krishtit.

Nuk i mbaj mend qytetet e fshatrat mbasi nuk flitej në njejës, por tash e tutje, fiksuar në kujtesë, nuk mund të harroj blirin 1100 vjeçar rreth të cilit çdo vit mblidheshin të rinjtë e të rejat, burrat e gratë, pleqtë dhe plakat dhe duke qarkulluar kurorën, festonin. Të rinjtë, me të dashurat e tyre ngritur lart, si në skenën kur dhëndrri merr në krahë nusen, veshur me rrobat e ndezura kombëtare këndonin dhe vallzonin.

Nuk mund të harroj edhe shqetësimin e të vjetërve që modernizmi po i zbeh këto festa me krye në shekuj.

Kamera na përcolli në blirë katërqind, gjashtëqind, nëntëqind- vjeçarë...derisa më në fund gjeti më të vjetrin e blinjëve, blirin 1105 vjeç..

Mbase do më qëllojë që këtë emision të Eksplorer Natyra do ta shoh përsëri, e mbase do të sjell hollësi. Mbase... por sidoqoftë, lexuesi i këtyre radhëve mos më presë mua, le ta kërkojë e ta shikojë.

E kam për të gjithë, por veç e veç e kam për dibranët, banorët e Peshkopisë dhe ata që i udhëheqin në Bashki, Prefekturë apo Qark.

Ata kanë në dorë një pasuri që mund e duhet ta bëjë qytetin e Peshkopisë një Qytet Turistik të Blirëve.

Blirët e Peshkopisë kanë një moshë pesëdhjetëvjeçare. Pak më i "moshuar" është Bulevardi. Godinat e para, katër dykatëshe radhazi, u ngritën nga themelet (e hedhura nga italianët) në vitin 1946, kohë kur ngritën çatitë kinemaja dhe Shkolla Pedagogjike për të vazhduar me shkollën shtatëvjeçare në vitin 1949, hotel "Korabin" në vitin 1961 e me radhë godinat në tërë bulevardin i cili mori formë në vitin 1955...

Blirët erdhën e mbushën të dy anët e bulevardit në vitet gjashtëdhjetë për të hapur degët e lulëzuar në vitet që erdhën.

Është fat i madh që sopata e keqbërjes nuk ra mbi blirët e bulevardit të Peshkopisë.

Banorët e qytetit të vogël në rrënjë të vargmaleve me Korabin në krye treguan se janë të kulturuar.

Larg, njëmijë kilometra larg, në troje të huaja, kam mall e dashuri për qytetin tim ku kalova 55 vjet të jetës sime. Kam mall për bulevardin e blirëve dhe nostalgji për mbrëmjet kur shetisnim dhe këmbenin në pikëkalimet përshëndetje me njerëzit e mirë të tij.

Kam mall që e shuaj kur vij, kur shetis nën degët e blirëve. E vërteta është se koha midis dy ardhjeve sa vjen e rritet. Mbase kur të kthehem nga mërgimi i mallkuar e Rruga e Arbrit do ma lehtësojë ardhjen, do të vij më shpesh.

Dy vjet më parë u ngroha në shpirt kur pashë njerëzit nga mëngjesi në mbrëmje të shetisin bulevardit, të përshëndeteshin me njeri tjetrin e të kalonin të gëzuar. Bashkia kishte bërë gjënë më të bukur, e kishte çliruar bulevardin nga prania e makinave dhe kundërmimi i karburantit tek digjej. E kishte lënë në aromën natyrale të blirëve, e kishte shndërruar në SHETITORE...

Shetitorja e Peshkopisë është ndoshta e vetmja në Shqipëri që njeriu shetit i qetë deri vonë në mbrëmje. Një shetitje ëndërr nën dritat që përshkojnë degët e blirit që bijen si shigjeta mbi asfalt.

Blirët e Shetitores së Peshkopisë, krahasuar me blirët shekullorë shenjtorë në Gjermani janë në moshë "foshnjore".

Blirët e Shetitores së Peshkopisë duhet të shpallen MONUMENT KULTURE, të vihen në kujdesin e qytetit dhe të shtetit.

Bashkia e Peshkopisë do të jetë e nderuar në qoftë se një ditë, me një vendim unanim, të kërkojë shpalljen e Blirëve të Shetitores MONUMENT KULTURE.

Të nderuar do të jenë edhe Këshilli i Qarkut dhe Prefektura e Dibrës.

Blirët e Shetitores së Peshkopisë e kanë bërë me kohë thirrjen e tyre për ndihmë. Rrënjët e tyre i kanë çarë betonet dhe kanë dalë mbi pllakat e këmbësoreve në të dy anët e bulevardit. Ata kërkojnë ndihmën e specialistit që të vijojnë jetën e tyre, pse jo, njëqind, dyqind, pesëqind...vjeçare si bashkëllojet e tyre në Gjermani...

Shpresoj që këto radhë ti lexojnë qytetarët dhe ti ligjërojnë pushtetarët.

Mbase një ditë do të vij në Peshkopi për të ndjerë madhështinë e Blireve-Monument Kulture.

Mbase në qendër të qytetet atje, ku bashkohen bulevardet, Bashkia do të ngrejë një monument për atë që e ideoi dhe i dha jetë Bulevardit të Blirëve, Agush Selishtës.

Unë shpresoj....

Athinë, 15 shkurt 2014.



Peshkopia në Dimër. Foto: © B.Karoshi

Rruga e Arbërit nr. 94

kujtime

Refik Pustina lindi në lagjen Bodulec të Dibës së Madhe, më 5 janar 1928. Vinte nga një familje qytetare e shquar për fisnikëri e bëma atdhetare.

M'ka marrë malli për nënën time

Nga **GAFUR ZOTA**

Në sëndukun prej dërrase, çelësat e të cilit i mbante nënë Zurka, kishte të ruajtura shumë letra. Letrat e Refikut ishin palosur me kujdes të veçantë. Telat –i thoshte të birit! Hajde mi lexo pak letrat e Refikut. Dua të çmallem me tim bir. Ballë- përball, me kafe përpara e letrat në dorë, nënë e bir uleshin në bahçe. I biri, Telati, lexon e nënë Zurka shpërthen në lot. Me cigaren e ndezur, mbi shaminë e njomur nga lotët, formon figurën e zëmrës. Refik! Zemra e nanës. Lofka e nanës. Refiku për të ishte lofka që gjendej thellë në zemër, për të cilin ka mall e trishtim. Telati, tek e shikon të lënduar, përpiqet t'a qetësojë, madje i thotë: "Nuk t'i lexoj më". Por nëna këmbëngul:"Vazhdo bir, vazhdo të çmallem pak me Refikun". Kjo u bë si një refren që përsëritej shpesh.

Një ditë, vëllai tjetër, Nexhati, i mallëngjyer nga skena dhe letrat e Refikut, shkruan tekstin e këngës "M'ka marrë malli për nënën time". Është një histori e dhimbshme, por që pak kush e din domethënien e saj. Ajo merr jetë nga paradokset e kohës, kur shqiptarët ishin të ndarë me kufi mes vedi, një kufi nën të cilin nënë Zurka, pas ndarjes me të birin, Refikun, nuk e pa më kurrë Atë, nusen e Tij, nipër e mbesa.

Refik Pustina lindi në lagjen Bodulec të Dibës së Madhe, më 5 janar 1928. Vinte nga një familje qytetare e shquar për fisnikëri e bëma atdhetare. Nga goja e të atit, Nazifit, kish dëgjuar për bëmat e Llanit, Nuredinit (Nurçe), Sefedinit, Alushit, Aliut e pustineve të tjerë. Ata kishin qënë në ball të kuvendeve, të qëndresës kundër pushtuesit turk e më pas atij serb. Axha i Refikut, Hamit Pustina, bashkë me Ali Pustinën, kishin qënë ndër aktivistët e rëndësishëm të klubit "Bashkimi" të Dibrës. Bashkë me Ejup Xhidrin, Haki Stërmillin, Reshit Dacin, Zija Tërshanën, Rifat Langun, Tafë Agolin, Azis Menzelxhiun e tjerë, gjatë viteve 1908-1912 ishin vënë në ballë të përpjekjeve për shkollën shqipe. Ata e vijuan qëndresën edhe kundër synimeve të qarqeve serbe. Gjatë kryengritjes së Dibrës, shtator 1913, Sefedin Pustina ishte njëri nga protagonistët e saj kryesor, kryetar i qeverisë Provizore të Dibrës, kurse Ali Pustina u vra në përpjekje me serbët në zonën e Gollobordës, qershor 1915.

Mësimet e para i mori në qytetin e lindjes, Dibër e Madhe. Këtu vijoi edhe arsimin e mesëm. Nga një mjeshtër Italian, që fëmijë, mësoi profesionin e axhustatorit. Ngriti edhe një bango pune të cilën e kompletoi me vegla të ndryshme. Profesioni i axhustatorit u bë shumë i dashur për të, madje edhe gjatë viteve në burg vazhdoi t'a ushtronte.

Qysh fëmijë fjala i zinte vend në kuvend. Duke qëndruar larg shtëpisë, mes më të mëdhenjve në moshë, ishte burrërua shpejt. Ata që kanë patur rastin ta njohin nga afër, kanë gjetur te Refiku një natyrë që nuk e kishte për gjë t'i shpaloste hapur pikëpamjet e Tij, madje me krenari. Në moshë madhore bashkëmoshatarë por edhe më të mëdhenj, madje edhe nga rreth shoqëror i ngritur, ndjeheshin komod të ndodheshin mes Tijë. Kjo i kishte dhënë edhe një farë krenarie, por jo pa risqe. Natyrën e Tij e njihte mirë edhe nënë Zurka. Jo thjeshtë se ishte djali më i vogël, i larguar qysh herët nga shtëpia, por më tepër natyra e Tij, bënin që Ajo t'mos ndjehej kurrë e qetë. Ah, Refik…. Refik -thosh shpesh herë dhe zhytej thellë në mendime.

Kishte të drejtë të merakosej për të birin, nënë Zurka. Prinërit e Tij kishin blerë një banesë në Peshkopi, lagjen Dobrovë. Këtu bashkë me Jahe Nazifin (vëlla nga nëna) kishte kaluar një pjesë të fëmijërisë edhe Refiku. Që këtej u mobilizua ushtarë në repartet e ndjekjes. Situatat e hodhën në Shkodër. I zhgënjyer nga qëndrimi i reparteve partizane, dezerton dhe bashkohet me kryengritësit antikomunist të Malësisë së Mbishkodrës. Me shtypjen e rezistencës antikomuniste arrestohet. Edhe pse vetëm 18 vjeç, gjykata ushtarake e Shkodrës e dënoi me vdekje, dënim që më pas iu ul në 30 vite .



Refik Pustina

Më 1954 lirohet nga burgu politik i Burrelit dhe fillon punë në minierën e Krrabës. Falë natyrës së Tij shumë shpejt fitoi respektin e punëtorëve. Profesioni i mjeshtrit si: axhustator, tornitor, mekanik dhe saldator bëri që të ishte i shumëkërkuar. Këtu martohet me Drita Vërzivollin, bijë e verzivollëve nga Dibra e madhe. Kadri e Ramadan Verzivolli kishin qenë aktivist të klubit "Bashkimi" të Dibrës dhe bashkë me Reshit Dacin, Hamit Pustinën, Zija Tershanën , Azis Menzelxhin e tjerë student të gjimnazit të Dibrës ishin përfshirë në lëvizjen për shkollë shqipe. Vërzivollët, si shumë dibranë, për shkak të gjenocidit serb ishin vendosur në Tiranë. Këtu vazhdojnë të merren me tregti. E bija, Arita Pustina, kujton: " Ishin shumë të pasur. Nana ecte mbi florinj dhe kadife të jashtme. Pas luftës pasuria e tyre u konfiskua". Drita kishte mbaruar shkollën "Nana Mbretëreshë". Punoi si arkëtare në teatrin e kukullave , Tiranë.

BURGU I DYTË

Edhe pas daljes nga burgu, Refiku vazhdon të mbroj pikëpamjet e tij, si i thonë nuk i rinte goja rehat. Në biseda me punonjës në minierë e jashtë sajë nuk heziton të shfaqte pakënaqësinë ndaj sistemit në fuqi. Mes punëtorëve nuk nguron të deklaroi për mungesën e lirive dhe të drejtave të njeriut, vuajtjet e popullit për bukë, trajtimin e keq të punëtorëve në krahasim me vendet perëndimore. Propagandon kundër kolektivizimit të bujqësisë. Mes punëtorëve dhe ambjente shoqërore shfaq solidaritet me kundra-revolucionin Hungarez duke kritikuar hapur ndërhyrjen e ushtrisë Sovjetike. Refiku propagandon sistemin e demokracive perëndimore, epërsinë e tyre ushtarake ndaj vendeve të Lindjes, veçanërisht ndaj Bashkimit Sovjetik. Por bisedat dhe qëndrimi ndaj sistemit u bënë shkas për të mbushur faqe pas faqeje dosjet e sigurimit të shtetit. Siç duket kupa u mbush, ndaj më 17 prill 1962 e arrestojnë përsëri. E bija Arita, kujton: " Babi, si zakonisht, erdhi të hajë drekë në ora 12. Unë isha 4 vjeç dhe ngulja këmbë që Ai të qëndronte edhe pak kohë me mua. E puthja pa pushim dhe këmbëngulja të mos ikte në punë. Sapo arriti te ofiçina e minierës, e arrestuan. Me të mësuar mbi arrestimin e Refikut, axha Jahe (Nazifi) ja mbrrinë në Krrabë. Na mori me ato pak plaçka dhe erdhëm në Peshkopi. Për afro një muaj qëndruam në një shtëpi me axhën Jahe. Pastaj mami takoi sekretarin e parë, Jashar Menzelxhiun, me të cilin nga prindërit kishin lidhje miqësore. Mami mori punë po ashtu u sistemuam në një hyrje, bodrum. E lyem me gëlqere të bardhë. Na dukej sikur jetonim në Paris–përfundon tregimin e saj, e bija, Arita".

Në qytetin e Peshkopisë Drita u tregua një grua burrneshë e vërtetë. Edhe pse e re, me tre fëmijë, punojë e jetoi me dinjitet. Me punë, bujari e besnikëri bashkëshortore e mbrojti dhe lartësoi personalitetin e Refikut. Përkushtimit të Sajë në punë dibranët do ti përgjigjeshin me respekt e dashuri të pashoqe. Ata e njihnin si "Nana e qytetit".

Gjyqi i Refikut u zhvillua në Tiranë. Në akuzën e ngritur theksohej se veprimtaria e tij kishte patur si synim të dobësonte vijën e partisë e të pushtetit popullor . Në gjyq u ballafaqua me dëshmitarë të cilët nga viti 1956 e në vazhdim kishin "kontribuar" në plotësimin e dosjes me të cilën u akuzua e dënua 7-të vite burg. Ky ishte burgu i dytë.

Vuajtjen e dënimit e kreu në burgun e Laçit. Këtu të burgosurit punonin në ndërtimin e uzinës së superfosfatit. Të burgosurit e gdhinin dhe ngrysnin në kantier. Kishin norma marramendëse. Askush nuk mund të kthehej në kamp pa realizuar atë. Në këtë uzinë punon edhe mjeshtri duarartë, i burgosuri, Refik Pustina. Falë duarve të tij drejtuesit e burgut ia kishin nevojën. Refiku punon si axhustator, tornitor, mirëmbajtës mekanike dhe saldator. Ishte një novator i vërtetë. Punon në lartësitë e kullave dhe oxhaqet e uzinës. Edhe sot, ndonse uzina ka degraduar thuajse tërësisht, gjen të shkruar në pllaka metali, në lartësitë e kullave dhe oxhaqeve të uzinës, emrin e axhustatorit duarartë Refik Pustina.

NJË BISEDË TELEFONIKE E KËPUTUR NË MES

Mbrëmjen e 31 dhjetorit 1967 autobusi me të cilin Refiku vinte nga burgu i Laçit arrit vonë. Në pritje kishin dalë fëmijët, miq e shokë të shumtë. Përqafime e lot. Më pas iu drejtua të vëllait, Jahjes: "Nga do shkojmë or vëlla"(Refiku nuk e dinte ku banonte familja). Do shkojmë te shtëpia ime, në Dobrovë-ishte përgjigja e Jahjes". Vizitat nga miq e shokë nuk kishin të sosur. Refiku ishte njeri shumë enigmatik dhe që mbante shumë të fshehta brenda vetes. Bënte shaka edhe pse sapo kishte dalë nga burgu. Në bisedë ishte i hapur, ndaj dhei bënte për vete të ardhurit. Këta të fundit, nga humori që Refiku krijonte, harroheshin të ktheheshin në shtëpi.

Më 3 janar 1968 kishin planifikuar një bisedë telefonike me Dibrën e Madhe. Refiku do të fliste me nënë Zurkën. Sa mall e lot. Kishin më shumë se 20 vite që nënë e bir nuk takoheshin. Ah kufiri. . . ! Refiku me familje, po ashtu, vëllai, Jahja, me familjen e tij, mbushën një dhomë në postë-telegrafë. Pas pak u dëgjua zëri i centralistes: "Refiku me Dibrën e Madhe". Alo nënë. Jam Refiku. Si je? Ah zemra e nanës… lofka e zemrës dhe zëri u ndërpre. Alo…alo, por nënë Zurka nuk përgjigjet më. Në telefon dëgjohet një zë burri… Jam , unë, Nexhati. Refik! Nana nuk ndjehet mirë. Flasim bashkë. Kjo bisedë më shumë se çmallje ishte një plagë e re.

Refiku filloi punë në ndërmarrjen elektrike të qytetit. Falë duarve të arta në garë u vunë edhe ndërmarrje tjera. Më pas filloi punë në ndërmarrjen komunale, dega e shërbimeve. Kryen punë të ndryshme axhusterie. Rregullonte makina shkrimi, kasaforta etje. Madje e thërrisnin të rregullonte kasaforta me kode në bankat e thesarit dhe dikastere të ndryshme. Në këto të fundit punimet kryheshin me mbikqyrje dhe proces-verbal. Refiku duhej të nënshkruante atë. Refiku ishte duarartë.

LINDA PUSTINA NUK SHKOI NË DIBËR TË MADHE

Në vitin 1971 një grup gjimnazistësh nga Peshkopia do të bënin vizitë në shkolat e Dibrës së Madhe. Më në fund, mendoi Refiku, së paku vajza, Linda, do të takohesh me gjyshen e sajë, Zurkën. Nxituan të bënin edhe një telegram duke e njoftuar për datën dhe orën. Erdhi data e nisjes dhe të gjithë mësues, nxënës…, kishin zënë vend në autobus. Përgjegjësi i grupit bën apelin. … Linda Pustina? –Vajza e Refik Pustinës!? Zbrit nga autobusi. Çfarë skene!? Ndërsa Linda e brengosur u kthye në shtëpi, grupi vazhdoi rrugë. Në të errur autobusi arriti në Dibër të Madhe. Një plakë e rënduar nga hallet dhe mosha e thyer, duke u mbajtur me një shkop, ngjit shkallët e autobusit. Ishte nënë Zurka. Sapo ngjitet në autobus dëgjohet urimi i saj i mirëseardhjes: "Pa t'ju përqafoi nana të gjithëve dhe ma në fund ta puth fort edhe çat cucën teme, Linda Pustinën. Ma dëftoni se se kam parë kurrë e nuk e njoh-vazhdoi nanë Zurka". Ra një heshtje vari. Të gjithë u ndjenë keq e s'kishin fjalë të flisnin. Më në fund e mori fjalën përgjegjësi grupit: "Nane? -Linda do të vijë një rast tjetër". Nanë Zurka, edhe pse e kuptoi gjithçka, gjeti forca e tha: "Dola se më kishin bërë telegram. Megjithatë shyqyr Zotit që ju pashë e qënkeni mirë. Ju kam si cucën teme , Lindën, ndaj ju pres nana të vini në shtëpi".

Linda ishte nxënëse e mirë në mësime. Falë rezultateve e kishin caktuar të ishte në mbrëmjen qendrore që kom. rinisë i atëhershëm bënte me rastin e vitit të ri. Ishin pionierët dhe të rinjtë e zgjedhur nga gjithë rrethi. Atë mbrëmje Linda ishte veshur me një pelixhe (kapot amerikane). Ia kishte sjellë gjyshe Zurka nga Dibra e Madhe. Veshja e saj kishte rënë në sy të drejtuesve të partisë dhe rinisë së rrethit, të pranishëm në mbrëmje. Të nesërmen rreth orës 6. 30 minuta të mëngjesit një trokitje në portë. Ishte korieri. Refik Pustina bashkë me vajzën, Lindën, në ora 7- të mëgjesit duhet të jenë tek zyra e sekretarit të parë të partisë së rrethit-theksoi ai. Ashtu u bë. Ende pa u futur në zyrë, sekretari i parë filloi të thërriste: "Ju jeni mikroborgjez. Ju manifestoni shfaqje të huaja, ndiqni modën e huaj- vazhdonte të bërtiste e godiste me grusht pa pushim tavolinë. - Do të shikoni…" Refiku, që kur nuk kishin arritur t'ia mbyllnin gojën, madje goja e kishte degdisur në qelitë e errëta të burgut, mezi përmbahet. Të nesërmen muret e bulevardit të qytetit ishin mbushur me fletë-rrufe. Që nga ajo natë Linda nuk e veshi më pelixhen (kapot amerikane). E brejti mola. Sot banon në Gjermani dhe nuk pranon t'ja kujtosh atë skenë.

Por kapitulli sapo ishte hapur. Gjyshe Zurka, - tregon Arita, - herë pas hera dërgonte dhurata nga Dibra e Madhe. Shumë prej tyre ishin antikuarë. Punonjësit e degës na bënin presion që t'mos i pranonim. Shumë prej tyre zbukuronin si relike tavolinat e mezit e bufetë e kuadrove të degës së brendshme. Na solli edhe një televizor Filips. Nuk na lejonin ta përdorim. Mbi gjashtë muaj e mbajtëm në kuti. Vetëm kur në qytet erdhën 4-5 të tjerë, na u dha leja t'a përdornim. Por edhe pse morëm leje, çdo mëngjez, poshtë derës, gjenim letra me mbishkrimin: "Refik Pustina! Ktheje antenën nga Shqipëria, jo nga Serbia"! Ç'paradoks! Sot, ata që fusnin dikur letra poshtë derës, janë të lirë të shikojnë gjithë stacionet e huaja, madje edhe TV Beogradin

AXHA REFIK!?

Ishte maji i vitit 1972. Ansambli 'Xheladin Zeqiri" nga Tetova do të vinte të jepte shfaqje në Tiranë. Refiku kish marrë një telegram nga djali i vëllait, nipi, Shpendi. Kishte dalë me familje ta priste. Vendi para 15-katëshit ishte mbushur plot e përplot. Kishin dalë shumë dibranë që banonin në Tiranë. Prisnin të çmalleshin me njerëzit e tyre të një gjaku, por që nuk e kishin parë kurrë njëri-tjetri. Refiku ecte ngadalë, kur befas, ende pa u ndalë au-

(Vijon në faqen 16)

sociale

Familja Xhajku apelon për ndihmë për të shpëtuar jetën e vajzës



Një familje në nevojë ekonomike, në fshatin Trenë të komunës Melan në rrethin e Dibrës, apelon për ndihmë financiare pranë strukturave shtetërore, shoqatave, biznesmenëve dhe qytetarëve, që sipas mundësive të ndihmojnë sado pak, për të mbajtur në jetë normale vajzën e tyre të mitur. Bëhet fjalë për familjen e Ferit Xhajkut në këtë fshat, ku vajza e tij, Denisa, 11 vjeç, ka nevojë për një ndërhyrje të specializuar kirurgjikale, e cila siç dhe e kanë rekomanduar mjekët realizohet në një klinikë në Ohër. Denisa, tregon e ëma, Flutura, në moshën 8 vjeçare, nis dhe shfaq shenja të dhimbjes në gjymtyrët e këmbëve, ku si pasojë krijohen disproporcione në zhvillimin harmonik të tyre, ku njëra mbetet 4 centimetra më e shkurtër se tjetra.

Kjo ka shkaktuar jo vetëm që Denisa e vogël të çalojë, por siç dhe janë shprehur mjekët në spitalin e Ohrit që e kanë vizituar atë, nëse brenda dy viteve nuk do realizohet operacioni i saj, ajo fatkeqësisht do të paralizohet për gjithë jetën e saj, thotë me mjaft keqardhje, babai i Denisës, Feriti. "Siç dhe e shifni, unë jam krejt i pamundur për të siguruar 7 mijë euro, pasi për fat të keq edhe vetë jam invalid". Feriti, kur ka qenë i vogël, duke luajtur me shokët në një qendër zjarri që po ndërtohej në atë kohë në afërsi të fshatit, rrëshqet një element i kësaj qendre, duke më goditur në mes, dhe prej asaj kohe, ai ka qenë një invalid.

> Aktualisht, familja Xhajku, me kushtet ekonomike që ka, ku e vetmja e ardhur është pensioni i invaliditetit prej 9 mijë lekësh që merr kryefamiliari, Feriti, nuk ka asnjë mundësi financiare për të siguruar shumën prej shtatë mijë eurosh, aq sa duhet për të operuar Denisën e vogël.

"Dua që vajza ime të mos ketë fatin tim të keq, që për mungesë parash për kurim, të mbetet, qoftë larg, edhe më keq se unë, jo vetëm invalid, por më keq krejt e paralizuar për gjithë jetën e shtruar në dyshek".

Teksa Feriti flet kështu me dhimbje, në bisedë mes lotësh ndërhyn edhe bashkëshortja e tij, Flutura. "Më besoni, - thotë ajo, - ka net që ashtu si bie ngrihem, pa i mbyllur sytë. E çfarë nuk bluan mendja ime në ato çaste, vetëm errësinën e natës kam dëshmitare".

Fukarallëku është derë hekuri që nuk çilet kollaj. Gjyshja e Denisës, ulur në krye të dhomës, pasi ka dredhur një cigare nga kutia e duhanit dhe nis ta tymosë atë, teksa dëgjon fjalët e nuses mes ofshamash, ndërhyn në bisedë si për të prerë fjalët e dhimbshme të saj: "Dëgjo mor bir, - na drejtohet ajo. Për evlaten tonë, Denisën, jemi gati të bëjmë çdo gja, që të sigurojmë lekët për ta ba operacion. Tokën e shesim, por sa fajde ban pasi kemi shumë pak tokë, vetëm 1 dilim. Shpëjn po ashtu, po kush e blen pasi si e shejfni, kjo është përdhese. S'na metet gja qetër, vetëm të apim jetën, por kuj i duhet se?!"

Aktualisht, familja Xhajku, me kushtet ekonomike që ka, ku e vetmja e ardhur është pensioni i invaliditetit prej 9 mijë lekësh që merr kryefamiliari, Feriti, nuk ka asnjë mundësi financiare për të siguruar shumën prej shtatë mijë eurosh, aq sa duhet për të operuar Denisën e vogël.

Vetë Denisa e mbërthyer nga emocionet, e ka tepër vështirë që të flasë, por përsërit si mbyturazi mes lotëve: Edua jetën, më ndihmoni ta gëzoj atë. E dua shkollën, më ndihmoni ta vazhdoj atë! Dhe krejt e shokuar dhe habitur nis e shkruan në fletore këto fjalë.

Të imagjinojmë për një çast që të vihemi në kushtet e familjes Xhajku, kur jeta e vajzës kushtëzohet me sigurimin e 7 mijë eurove, që edhe pse nuk është ndonjë shumë e madhe kjo familje e ka krejt të pamundur t'i gjejë, natyrshëm që do mbërthehemi nga ankthi, trishtimi e gjendja stresante e tejskajshme që kjo familje përjeton.

Dhe një gjendje e tillë në substancë përmblidhet në thënien e xhaxhait të 11-vjeçares, Hekuranit, se "jetën e japim, por paratë për shërimin e vajzës, s'kemi ku t'i gjejmë". - E vetmja gja që na metet, vijon ai, asht tu bajm thirrje të gjithë atyne që kan munsi të na ndihmojnë me sa të munden, që të na e zgjidhin këtë hall të madh që ne kemi si familje.

Le të jetë kjo thirrje e familjarëve të Denisës së vogël, një këmbanë e fortë në veshët e atyre që duhet dhe mund të bëjnë diçka për këtë vogëlushe, që edhe ajo ashtu si të gjithë bashkmoshatarët e saj, të cilët kemi bindjen se do jenë të parët që do sensibilizohen në këtë drejtim, ti gëzohet jetës, pasi ajo na jepet vetëm një herë.

HYSEN LIKDISHA.

Apel për ndihmë humanitare për 18 vjeçaren e sëmurë nga leucemia

Nga **BEQIR SINA**



> Mbasi ëndrra e saj është që Dorina të shërohet dhe që ajo mund të shkojë përsëri në shkollë dhe të kthehet përsëri pranë familjes dhe shokëve e shoqeve të saj - të bëhet një financiere në të ardhmen që t'ju ndihmojë njerëzve - por mbi të gjitha të jetojë edhe ajo si të gjithë ne.

Çdo ditë që kalon për të tashmë është bërë si një kapërcim i sfidës së saj - për të mundur sëmundjen dhe për të luftuar për jetë. 18 vjeçarja nga Peshkopia Dorina Fatmir Mani, e lindur më 10 shkurt 1996, është ekzaminuar në Hematology Clinic në Tiranë dhe ka dalë me diagnozën Acute Leukemia, një sëmundje e rëndë dhe shumë e kushtueshme për tu shëruar.

Ministria e Shëndetësisë në Shqipëri, ka konkluduar në bazë të vendimit numër 83 datët 30 Dhjetor 2013 nga Komisioni Shëndetësor i Spitalit Univeristar "Nwnw Tereza" aprovuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Spitalit në lidhje me pacienten Dorina Mani 18 vjeçe me diagnozën "Acute Leukemia"

Ndërkohw që ajo po vuan nga Leukemia Akute, duhen siguruar të hollat për të paguar shërimin e shtrenjtë që kërkon kjo sëmundje. Sëmundja e saj përveç anëtarëve të familjes së saj, është shndërruar në një ankth të përditshëm edhe për të afërmit e saj - miqt dhe dashamirët. Mbasi duhen 200 mijë euro që t'i paguhen spitalit në Romë - Itali, ku asaj duhet t'i bëhet transplantimi i palcës kurrizore, pasi sipas mjekëve shqiptarë në Shqipëri, nuk mund t'a bëjnë këtë lloj transpaltimi.

Andaj kërkohet në se keni mundësi dhe dëshironi të ndihmoni një jetë, që çdo cent i dhuruesve të derdhet në xhirollogarinë e hapur për shërimin e Dorianës, është i vlefshëm vetëm për të siguruar jetën e saj.

Vajza që është në luftë me sëmundjen dhe lutet çdo ditë Zotit, po kërkon edhe ndihmën tuaj t'a sfidojë atë sëmundje, Ajo shkruan në një mesazh kurajoz nga shtrati se: "Unë jam Dorina Mani, jam 18 vjeçe. Vij nga Peshkopia, një qytet në verilindje të Shqipërisë, dhe studioj në vitin e fundit në gjimnaz. Nga fundi i dhjetorit 2013, u diagnostikova dhe dola me Luekemi dhe u shtrova në spital ku edhe gjendem aktualisht në përfundimin e fazës së parë të kimioterapisë."

Më tej ajo sqaron se si e mësoi ajo sëmundjen: "Në fillim askush nuk ma tha të vërtetën në lidhje me sëmundjen me pretesktin se ishte thjesht një anemi pak e rëndë, por pas 21 ditësh fillova të kisha humbje të flokëve dhe ky ndoshta ishte momenti i parë, kur unë zbulova sëmundjen time, që më pas mjekët më thanë se kisha nevojë për një transplant në palcën kurrizore, i cili sipas tyre nuk realizohet dot në Shqipëri. Ky lloj transplanti më kanë thënë kushton 200 mijë Euro ."

Kurse, për arsye ekonomike se familja e saj nuk i disponon një shumë kaq të madhe, në luftë me jetën e saj është e detyruar të kërkojë ndihmë, tashmë tek të gjithë shqiptarët, në Shqipëri, Europë dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Mbasi ëndrra e saj është që Dorina të shërohet dhe që ajo mund të shkojë përsëri në shkollë dhe të kthehet përsëri pranë familjes dhe shokëve e shoqeve të saj - të bëhet një financiere në të ardhmen që t'ju ndihmojë njerëzve - por mbi të gjitha të jetojë edhe ajo si të gjithë ne.

Zëri i saj na thërret dhe na ndjek kudo: "Ju lutem më ndihmoni se kam me të vërtet shumë nevojë për ndihmën tuaj dhe të çdo kujt që dëshiron të shpëtojë një jetë - një vajzë të re 18 vjeçe - Ju falemінderit !"

Xhirollogaria për Dorina Valbona Mani :
Llogaria bankare për transferë në Banka Kombëtare Tregëtare IBAN. AL,1320511179752946 CLIDCFUSDW - SWIFT : NCBAALTX

Rruga e Arbërit nr. 94

Një histori mbi lidhjet martesore. Suksesi, por edhe shkaku i ambicjeve midis familjeve të mëdha feudale. Çelësi i forcimit të miqësive por edhe i konflikteve.

studim

Martesat dibrane më të famshme

Nga **Mentor HOXHA**
Master Shkencor në Studime Letrare

(Vijon nga numri i kaluatr)

ÇIFTI HOXHA: DASHURI QË LINDI DHE U RRIT NË LUFTË

Nexhmije Xhuglini u njoh me Enver Hoxhën në vitet e luftës kundër okuptarorëve nazifashistë. E ka njohur për herë të parë më 23 Nëntor 1941 në Mbledhjen e Themelimit të Rinisë Komuniste të Shqipërisë që bë në shtëpinë e Sabrije (Bije Vokshit) në Tiranë. Më parë as që kishte dëgjuar për të. Nexhmija ishte vetmja vajzë që merrte pjesë nga 12 delgatët e 12 grupeve të ndryshme, ku mbajti dhe një diskutim mbreslënës. Në atë mbledhje u zgjodh Komiteti Qendror i Rinisë Komuniste, me Sekretar politik Qemal Stafën, sekretar organizativ Nako Spiru dhe anëtarë Nexhmije Xhuglini, Tasi Mitrushi dhe Ymer Pula nga Kosova. Mbledhjen e drejtonte Qemal Stafa, ndërsa Enveri ishte dërguar nga Komiteti Provizor i PKSH. Enveri, u dha dorën të gjithëve, dhe kur shkoi tej ajo, Qemali i tha: "Kjo është Shoqja Nexhmije Xhuglini, për të cilën të kam folur". Celebrimin e martesës e kanë bërë më 1 janar 1945 në shtëpinë e tyre në "Tiranën e Re", ku lindën tre fëmijë: Ilirin (13 mars 1949), Sokolin (14 shkurt 1951) dhe Pranverë (24 qershor 1954). Në librin e saj "Jeta ime me Enverin" ajo kujton: "Çdo çift i dashuruar ruan si kujtim të bukur njohjen e parë, takimin e parë. Dikush i bën poezi, dikush këndon këngë, tjetri e pret të dashurën në park, në rrugë, në oborrin e shkollës ose të shkalla e apartamentit. Kështu ndodh pak a shumë në kohë paqeje. Po në luftë? Në kushte ilegaliteti? A lind dashuria? Përderisa je i ri ose e re, edhe atëherë çel dashuria, si lulet në praverë. Lufta me egërsinë dhe acarin e saj nuk e mbyt e nuk e than dot këtë ndjenjë njerëzore e jetësore. Një ditë kur po qëndroja te shtëpia e Bijes, Enveri erdhi, u mbështet te kasa e derës dhe po më vështronte që po fërkoja fort dërrasat e dyshemesë me furçë. -Ditke të lash mirë! -foli duke qeshur.-Pse, ç'pandeh? Unë jam dibrane, -i thashë. Më 22 maj 1942 shkova në bazën e Enverit, te shtëpia pranë Centralit elektrik të Tiranës. Afërsisht ora 10. Aty gjeta Enverin. U gëzua kur më pa dhe më çoi në dhomë, u ul pranë meje, te divani dhe më tregoi disa foto të tij në rini gjatë kohës në Gjirokastër, Korçë dhe në Francë. Në album ishte dhe fotoja e një vajze të re, brune, e bukur, e vetmja foto-portret. Ai nuk foli për të dhe unë nuk e pyeta, as atëherë, as më vonë dhe asnjëherë gjatë gjithë jetës sonë të përbashkët. Për mua ishte e qartë, nuk mund të pretendoja, as të përfytyroja që një i ri, si qe Enveri, aq më tepër që ishte në Francë, të bënte atje një jetë asketi. Siç ishim mbështetur te muri, të ulur pranë njëri-tjetrit e tek po tregonte këtë fotografi të fundit, tentoi të mbështeste kokën te supi, si për të më shprehur pa fjalë "unë ty të dua".Menjëherë ngrita supet, si për t'i thënë: "Mos guxo! Kjo Enverin e vuri në siklet dhe, me siguri, mendoi: "Si t'ia bëj kësaj? Kjo s'marrka vesh. Shkova në kuzhinë, ndërkohë që unë isha me shpinë nga ai duke përgatitur kafenë, Enveri ia pati që andej ku po rrinte: "E di Nexhmije, meqë s'po kupton gjë ose bën sikur nuk kupton, po ta them copë:"Dua të martohem me ty". Unë ngriva e tëra. Një propozim i tillë, i thënë kaq "bram" më ra si bombë në kokë. Nuk e prisja të më qëllonte shfaqja e dashurisë nga ana e një djali në mënyrë kaq "prozaike", mua një vajze romantike, që dashurinë e imagjinonte ndryshe, dhe, që, sidomos në kushtet e luftës, ajo i trembej asaj e jo më martesës. Për të mbledhur veten nga turbullimi që më shkaktoi ky propozim i papritur, e zieva kafenë disa herë. Kur ia çova kafenë isha skuqur në fytyrë. Pasi mori fiilxhanin, për të qetësuar, duke qeshur dhe më zë të ëmbël e qetësues më tha: "Se prisje ë? Pa ulu këtu, se nuk të ha! Unë u ula në anë të divanit e heshtur. Ai më foli, por tani më serrioz: "E, çthua?" Unë, pa e parë në fytyrë i thashë: "Unë nuk martohem



Dasëm dibrane. Pikturë nga Zaim Elezi (ZAYA)

gjatë luftës…". "Po kush tha të martohemi gjatë luftës? "…Unë atëherë isha 21 dhe Enveri 34. …Në imagjinatën time nuk do të më pëlqente ta kisha bashkëshortin moshatar, e doja të kishte disa vite më shumë se unë, pasi kështu do të isha më e mbrojtur e njëkohësisht më e "përkdhelur". Kështu mendoja kur isha e re, por, me kalimin e kohës, kjo diferencë moshe mori kuptim tjetër, ajo çimentoi gjithnjë e më shumë dashurinë tonë. Unë qeshë dhe jam e lumtur që u lidha me të, që munda t'i shërbej si grua e si shoqe deri në fund të jetës së tij. Edhe këto "kujtime", që po shkruaj, unë i shkruaj nga dashuria e pashuar dhe dëshira për t'i shërbyer përsëri derri në fund, sa të kem jetë. Dhjetë ditë pas kësaj ndodhie, vajta te Baraka e Nushajve, që ishte diku afër ku tani është Ekspozita "Shqipëria Sot".Kozma Nushin e pata për disa muaj sekretar të celulës ku bëja pjesë. Aty, pa e ditur më parë, gjeta Enverin. Ai më tërhoqi për dore dhe u ulëm në një minder. Folëm për punën tonë me rininë dhe nga fundi më pyeti prapë: "Po tjetër ç'kemi?" Këtë pyetje e bëri duke buzëqeshur dhe duke më vështruar drejt e në sy. Unë e kuptova ku e kishte fjalën dhe iu përgjigja po me buzëqeshje: "S'ka asgjë të re në Frontin e Perëndimit". "Mirë", tha, "pasiansë" (durim-në frëngjisht) dhe më përcolli deri te dera, duke më thënë: "Mirupafshim në shtëpinë tonë". -Oj, dreq o punë! - thashë me vete, duke qeshur, përbrenda - u bëra dhe me shtëpi tani…" U largova me një turbullim të ri në kokë e në zemër, sepse po shihja që "koncepteve" të mia për dashurinë gjatë luftës u ishin lëkundur keq themelet. Po e ndieja se "kisha rënë në dashuri". Prita edhe nja dy javë duke pyetur e duke i bërë provimin vetes për këtë vendim jetik që duhej të merrja për të ardhmen time, kalova disa net pa gjumë dhe më në fund vendosa. Diga ime e ngritur artificialisht para ndjenjave të natyrshme e të mrekullueshme të dashurisë u shemb. Më 22 qershor shkova në "shtëpinë tonë". Aty gjeta Enverin duke shkruar e duke pirë cigare sa kishte bërë gjithë dhomën tym. Atë ditë pashë qe Enveri i kishte hequr edhe mustaqet, Sakrifica e parë që bënte për mua!, pasi kur më kishte pyetur njëherë, i kisha thënë që nuk i shkonin. Vendosa të shkruaj nga jeta ime me Enverin kur ndieva fort nevojën të mposht vetminë torturues të qelisë së burgut. Filllova me kujtimet e rinisë sonë, nga jeta e përbashkët me Enverin, që nga njohja e parë e dashuria që na lidhi aq fort e për trë cilin nuk kisha biseduar as me fëmijët e mi. Gjatë gjithë jetës sime, të re e më vonë, i ruajta këto kujtime vetëm për vete, me kalimin e kohës, bashkëjetesa jonë ideale i pasuroi, e i zbukuroi"

MARTESAT, ÇELËSI I FORCIMIT DHE I KONFLIKTEVE BRENDA PARISË DIBRANE

Martesa si një prej institucioneve më të lashta dhe më të rëndësishme të familjes, ka lindur bashkë me njeriun. Gjurmët e saj shfaqen që në parahistori (periudha e Gurit 6000 000 vjet para krishtit deri rreth 4000 vjet para Krishtit). "Parahistori"është quajtur periudha para se të lindte shkrimi dhe të shkruhej historia. "Parahistoria" apo "Prehistoria" është periudha më e gjatë e shoqërisë njerëzore, që zë fill me shfaqjet e para paleolitike të grupeve primitive njerëzore deri në lindjen e jetës qytetare ilire. Përfshin epokën e paleolitit (1500 000- 10. 000 vjet më parë) dhe të mezolitit -guri i mesëm (10 000-7000 vjet p.e.sonë) epokën e neolitit (Guri Ri), që fillon nga mijëvjeçari i shtatë dhe mbaron nga fundi i mijëvjeçarit të katërt p.e.sonë dhe eneolitit si dhe epokën e metaleve të forta, përkatësisht atë të bronzit e të hekurit. Etapa e fundit e kësaj periudhe, e njohur me termin "protohistori" i referohet epokës së hekurit, në periudhën e hershme të së cilës (shek. XI-IX p.Kr.) përfundon procesi i formimit etnogjenetik të popullsisë ilire, bashkësitë fisnore të së cilës do të shfaqen në burimet historike me emrat e tyre të përveçëm duke filluar nga periudha e vonë e kësaj epoke (shek. VI-V p. Kr.), e njohur edhe si periudhë arkaike ose protourbane. Në Bibël, shkruhet që Zoti bëri njeriun e parë Adamin dhe i dha jetë me anë të frymës, ndërkohë në mite të tjera, thuhet se njeriu i parë u formua nga argjila dhe mori jetë po me anë të frymës . Po sipas Biblës, pas Adamit, u krijua edhe femra e parë, e quajtur Eva, që sipas librit të Gjenezës, u krijua për të mos e lënë të vetmuar Adamin. "Eva, si femra e parë e njerëzimit, si femra tipike, me aftësitë e saj për të bërë mëkate dhe për ta tërhequr edhe burrin drejt mëkatit, është një gjeneruese e madhe energjishë njerëzore e dramës së madhe njerëzore, që vërvitet në këtë planet që prej mijëra e mijëra shekujsh .

Nga fundi i neolitit, për të parën herë dalin dhe veglat e objektet prej bakri, të cilat shënojnë fillimet e metalurgjisë në vendin tonë. Në këtë të fundit përfshihet edhe periudha e bakrit ose eneoliti (nga bashkimi i fjalës lat. eneos – bakër dhe greq. lithos – gur), që përbën etapën e fundit dhe kalimtare për epokën e bronzit . Gjatë kësaj periudhë pati një zhvillim të madh në, bujqësi, blektori, gjueti, peshkim, industri etj, gjë që"solli ndryshime dhe në organizimin shoqëror, që u pasqyrua në përmirësimin e mëtejshëm të strukturës gjinore. Gjinia matriarkale e lindur që në paleolitin e lartë dhe e zhvilluar dalëngadalë gjatë mezolitit, arrin tani fazën e lulëzimit të saj. Martesa me grupe, karakteristike për periudhën e hershme të matriarkatit, zëvendësohet në periudhën e lulëzimit të saj me një formë të re më të përsosur, me martesën me çifte .Ndarja e shoqërisë me klasa, solli ndryshime e diferencime të mëdha edhe në martesa, që tashmë filluan të bëhen sipas statusit civil e shoqëror të gjithësecilit. Kjo ndarje vazhdoi edhe gjatë mesjetës me lidhjet martesore midis familjeve fisnike feudale, të cilat forconin pozitat e tyre shoqërore, politike, ekonomike e ushtarake. "Martesa, si një prej institucioneve të rëndësishme të feudalizmit që rregullonte një varg rregullash juridike dhe tradicionale, përveç rëndësisë shoqërore, i lidhte familjet fisnike në aleanca, koalicione dhe në marrëdhënie të varësisë së shumëfishtë . Për martesat e fisnikëve dibranë në mesjetë, Barleti shkruan: "Në Epir, shquhej ndërmjet mbretërvet të vegjël dhe princërvet të tjerë emri mjaft fisnik i Gjon Kastriotit për sundimin e tij si në qytete të tjerë, si në Krujë veçanërisht . Gjon Kastrioti (babai i Skënderbeut M.H) u martua me Vojsava Tribaldin, familja e së cilës, jetonte në Pollog (me këtë Barleti emërtonte rajonin që shtrihej nga qyteti i Shkupit në lindje deri në krahinën e Dervenit në perëndim, ndoshta edhe rajonin në rrjedhën e poshtme të lumit Treskë Stefan I. Prifti). Gruaja e këtij e kish emrin Voisavë, të cilën e bënin jo të padenjë për atë burrë më nj'anë i ati shumë fisnik, princi i tribalëvet (emër i një fisi, i cili në kohë antike, banonte në trevat e Maqedhonisë dhe e Bullarisë së sotme), m'anë tjetër bukuria, sjellja dhe shpirti i saj i lartë për mbi natyrën e femrës. Asaj mund t'i bëhen lavdërime ndoshta jo më të vogla edhe për filizat e reja, për të cilat me të drejtë përmenden zakonisht gratë, sepse thuhet që lindi dhe rriti 9 fëmijë, 5 femra; Marën, Jellën, Anjelinën, Vlajkën, Mamicën, të tjerët meshkuj: Reposhin, Stanishën, Konstandinin dhe Gjergjin. Më i vogli nga mosha ishte Gjergji, të cilit më vonë tek barbarët (turqit) iu dha emri Skënderbeg .Për të forcuar pozitat e tij, Gjon Kastrioti, krahas martesës së tij me një grua fisnike, edhe 4 vajzat i martoi "me anëtarë të familjeve më të fuqishme të kohës: Mara me Stefan Gjurashin (Cërnojeviçin), Jella me Stres Balshën, Angjelina me Vladan Arianitin, vëlla i Gjergj Arianitit, Vlajka me Gjon Muzakën . Gjithashtu fejoi në mungesë edhe njërin prej djemve Konstandinin me Helena Topinë. Kjo fejesë nuk u realizua me martesë, sepse Kostandini u martua me një zonjë turke dhe nga kjo martesë lindi Hamza Kastrioti, njëri prej protagonistëve të luftës shqiptaro-turke

(Vijon në faqen 22)

cyan magenta yellow black

botime

Bibliografi e punimeve shqiptare të fushës së Psikologjisë



Puna studimore kërkon një mbështetje të fuqishme në burime të shumta të literaturës së botuar dhe në gjithë dokumentacionin tjetër shkencor, kërkon përvetësimin e gjithë atij bagazhi të madh njohurish dhe atij trashëgimi kulturor dhe shkencor që ka përpunaur njerëzimi, kërkon organizimin e një informacioni shkencor sa më të përsosur.

Realizimit të kësaj detyre të rëndësishme, mendojmë se do t'i shërbejë sadopak edhe plotësimi e ribotimi i kësaj bibliografie, e cila do të përbëjë një hallkë tjetër në tërë sistemin e informimit shkencor mbi të rejat dhe arritjet në shkencën e psikologjisë shqiptare.

Veçanërisht të mëdha janë detyrat që na dalin, lidhur me problemin e organizimit dhe të përsosjes së informacionit shkencor për bibliotekat e kategorive të ndryshme, si institucione kryesore bibliografike dhe departamenteve të psikologjisë e të punonjësve shkencorë për plotësimin e atyre mangësive që vihen re në këtë drejtim, për t'i ushqyer studiuesit e ndryshëm, pedagogët, mësuesit dhe studentët me burime bibliografike të panjohura, për t'i ndihmuar në punën kërkimore – shkencore të ndërmarrë prej tyre.

Punë më e gjerë dhe më e kualifikuar duhet bërë edhe për informacionin, nëpërmjet botimeve të ndryshme bibliografike retrospektive dhe bashkëkohore sipas profileve.

Bibliografia e psikologjisë, si çdo degë tjetër e bibliografisë, ka objektin e vet. Ajo studion zgjedhjen, përshkrimin, klasifikimin, sistemimin, metodikën e hetimit dhe të gjetjes, si dhe të zbulimit të përmbajtjes me anën e shënimeve dhe referimeve. Ajo është degë e dijes që merret me parimet, me kriteret dhe metodat e këtij përshkrimi e klasifikimi të veprave, punimeve, studimeve dhe artikujve nga rrafshi i dijes së psikologjisë, të botuara në organe të ndryshme ose si vëllime më vete.

Në veprimtarinë praktike, bibliografia e psikologjisë është pjesë e pandarë e punës studimore, me rëndësi të madhe njohëse dhe edukuese.

Në këtë bibliografi, siç shihet edhe nga përmbajtja, janë përfshirë edhe punime me aspekte të ndryshme nga fusha e gjerë e psikologjisë së përgjithshme, moshore, pedagogjike, të psikologjisë shoqërore, të psikologjisë kombëtare të popullit tonë (etnopsikologjisë) etj. Janë përfshirë gjithashtu përkthime dhe përshtatje të autorëve të huaj, të mirëfillta ose që lidhen me fushën e psikologjisë dhe degëve të saj, si dhe recensione, vlerësime kritike për tekste dhe punime të ndryshme psikologjike, etj.

Në këtë bibliografi, që është e para në llojin e vet, nuk pretendojmë se kemi bërë një paraqitje krejtësisht të plotë dhe shterues të punimeve që lidhen me problemet e psikologjisë.

> Kjo bibliografi do të ndihmojë departamentet, studiuesit tanë, veçanërisht ata të fushës së psikologjisë e të pedagogjisë dhe degëve të shumta të tyre, studentët dhe punonjësit e bibliotekave, që të gjejnë me lehtësi dhe në mënyrë sa më të plotë materialet dhe të dhënat që u nevojiten për studimet, punimet dhe botimet e tyre në këtë fushë.

> Bibliografia e punimeve shqiptare të fushës së Psikologjisë deri në vitin 2000 është një botim i plotësuar. Botimi i parë për përdorim të brendshëm, titulluar "Bibliografi e punimeve psikologjike e për psikologjinë, të botuara në vendin tonë para dhe pas Çlirimit" deri më 1985, është bërë nga Instituti i Lartë Pedagogjik i Shkodrës më 1986, me përkujdesjen e çmuar të z.Vili Kamsi

Në këtë bibliografi, siç shihet edhe nga përmbajtja, janë përfshirë edhe punime me aspekte të ndryshme nga fusha e gjerë e psikologjisë së përgjithshme, moshore, pedagogjike, të psikologjisë shoqërore, të psikologjisë kombëtare të popullit tonë (etnopsikologjisë) etj. Janë përfshirë gjithashtu përkthime dhe përshtatje të autorëve të huaj, të mirëfillta ose që lidhen me fushën e psikologjisë dhe degëve të saj, si dhe recensione, vlerësime kritike për tekste dhe punime të ndryshme psikologjike, etj.

Në këtë bibliografi, që është e para në llojin e vet, nuk pretendojmë se kemi bërë një paraqitje krejtësisht të plotë dhe shterues të punimeve që lidhen me problemet e psikologjisë.

Shkalla e kërkimeve dhe e njohjes së dokumenteve dhe burimeve bibliografike nga ana jonë, si dhe paraqitja e klasifikimi i tyre nëpër treguesit përkatës, është në një nivel që lë ende për të dëshiruar e diskutuar.

Gjithashtu, nuk mund të mos theksojmë se dokumentacionin dhe burimet bibliografike të periudhës 1990-2000, nuk kemi mundur ta sigurojmë dhe ta shfrytëzojmë në masën e duhur, për çka i kërkojmë falje lexuesit.

Jemi të ndërgjegjshëm se lexuesit e kësaj bibliografie, sidomos specialistët e fushës së psikologjisë e të pedagogjisë, nuk mund të mos kenë sugjerime, vërejtje dhe kërkesa edhe në lidhje me klasifikimin dhe vendosjen e zërave të ndryshëm në këtë ose atë nënndarje.

Gjer më tani, një pjesë e punimeve dhe botimeve nga fusha e psikologjisë janë pasqyruar në vepra të ndryshme bibliografike, si në ato për problemet e zhvillimit të mëtejshëm të shkollës, ashtu edhe në ato të karakterit të përgjithshëm, të botuara në vendin tonë, qoftë para, qoftë edhe pas vitit 1944. Le të përmendim disa prej tyre, si: Manek-Pekmezi-Stotz (1909), E.Legrand (1912), H.Guys (1938), J.Kastrati (1955), ato të F.Tabakut, M.Fezgës, P.Dakës, V.Barutit, F.Lulit si dhe në "Bibliografia e librit shqip në fondet e Bibliotekës Kombëtare (1913-1944)" (2010), hartuar nga Maksim Gjinaj, Margarita Mele, Myrvete Elmazi etj. Punime dhe botime nga fusha e psikologjisë janë pasqyruar në mënyrë të veçantë në bibliografinë e periodikut e të librit shqip, si dhe në disa revista e botime të veçanta që, për vetë drejtimin e tyre, kanë botuar më shumë materiale të psikologjisë, si "Revista pedagogjike", "Edukimi parashkollor", etj.

Kjo bibliografi do të ndihmojë departamentet, studiuesit tanë, veçanërisht ata të fushës së psikologjisë e të pedagogjisë dhe degëve të shumta të tyre, studentët dhe punonjësit e bibliotekave, që të gjejnë me lehtësi dhe në mënyrë sa më të plotë materialet dhe të dhënat që u nevojiten për studimet, punimet dhe botimet e tyre në këtë fushë.

Bibliografia do të ndikojë gjithashtu edhe në zgjerimin e shkallës së njohjes në drejtim të asaj tradite të pasur edhe në fushën e mendimit psikologjik e të studimeve psikologjike shqiptare.

Kjo bibliografi është rezultat i punës shumëvjeçare që ka bërë dhe vazhdon të bëjë autori i saj mbi temën "Kontribute themelore në zhvillimin e mendimit psikologjik shqiptar gjer më 1939" si dhe i studimit "Mbi punimet shqiptare në fushën e psikologjisë pasçlirimit", etj.

Rruga e Arbërit

Njoftim për bashkëpunëtorët

Na shkruani email:
<**rrugaearberit@gmail.com**>

Të nderuar bashkëpunëtorë,
Për të pasur një bashkëpunim të suksesshëm, ju lutemi të kini parasysh disa kritere për materialet që sillni pranë redaksisë.
- Shkrimet duhet të jenë të daktilografuara, jo më shumë se 1500 fjalë (10000 karaktere, përfshirë hapsirat). Shkrimet duhet të përmbajnë shkronjat "ë" dhe "ç". Shkrimet me më shumë fjalë, do ti nënshtrohen procesit të redaktimit.
- Fotografitë për shkrimin duhet të jenë me diçiture dhe më emrin e fotografit.
- Materialet me karakter aktual dhe problematikën e ditës kanë përparësi botimi.
- Materialet historike, recensat apo portretet, nuk do pranohen për botim, n.q.s. ato konstatohen se janë botuar në ndonjë media tjetër apo rrjete sociale.
- Shkrimet duhet të jenë origjinale dhe të respektojnë të drejtat e autorit.
- Shkrimet duhet të sillen nëpër nëpërmjet Postës Shqiptare në adresën e gazetës, postës elektronike në e-mail <**rrugaearberit@gmail.com**>, ose mund tu dorëzohen personave të autorizuar nga redaksia.
- Shkrimet që janë jashtë platformës së gazetës, nuk botohen dhe redaksia nuk është e detyruar të japë shpjegime për çdo rast.

Duke shpresuar në mirëkuptimin tuaj, ju përcjellim konsideratat më të mira për bashkëpunimin e deritanishëm.
Për sqarime më të hollësishme mund të na kontaktoni me email në adresën <**rrugaearberit@gmail.com**>

Rruga e Arbërit nr. 94

Suksese në Repartin për sëmundjet e syve në Spitalin Klinik të Tetovës

portret

Nadi Rustemi, gjithmonë në shërbim të pacientëve

Nga **REXHEP TORTE**

Për atë person që nuk e ka provuar sëmundjen, operimin dhe spitalin mund të themi lirisht se me siguri nuk e ka kuptuar rëndësinë dhe domethënien e jetës. Gjithashtu secili person që nuk e respekton mjekun e mirfilltë mund të themi se është mediokër, mendjemadh dhe i pa edukuar.

Perëndia që fal jetën, spitali dhe mjeku janë trekëndëshi që përpiqet dhe mund të kontribuojë për mbarëvajtjen e shëndetit të njeriut, pa të cilin askush nuk do të mund ta shijonte jetën në lumturi dhe domethënie të plotë.

Spitalin Klinik të Tetovës tashmë është vënë në hap me kohën që dëshmohet me ekipet mjekësore të aftësuara e që po i zbatojnë metodat bashkëkohore të mjekimit për pacientët.

Në katin e pestë të Spitalit Klinik në Tetovë gjendet Reparti për sëmundjet e syve. Që në hyrje të këtij reparti të bie në sy rregulli, qëndrimi e kujdesi maksimal s edhe shërbimi cilësor ndaj pacientëve.

Mua, gazetarit dhe autorit të këtj teksti, veç sëmundjes së rëndë në sy me të cilën po ballafaqohem tash pesë vite, tani mu paraqit edhe katarakta e syve. Me që pas vendosjes së procedurës së re të mjekimt në Maqedoni nëpërmjet caktimt të vizitave mjekësore nëpërmjet rrjetit kompjuterik, në Shkup më duhej të pres gjatë për të ardhur në radhë. Në cilësinë e pacientit erdha në Repartin për sëmundjet e syve në Spitalin Klinik në Tetovë, për të operuar kataraktën në syrin e djathtë, siç i thotë populli perden e syrit, dhe u mrekullova nga pritja e shërbimet që ofrohen në këtë repart.

I pari që i pret pacientët është Dr. mr. sci. oftamologu Nadi Rustemi, përndyshe edhe udhëheqës i këtij reparti.

Përkundër moshës së tij të re është karakteristike sjellja e tij njerëzore, korrekte dhe



Dr. mr. sci. oftamologu Nadi Rustemi.

profesionale, që e bën pacientin të çlirohet nga ankthi që ndjen secili person që sëmundja e ka detyruar t'i drejtohet spitalit. Në këtë repart vijnë pacientët për ta mbrojtur dritën e syrit, pa të cilën nuk mund të shikohen dhe përjetohen bukuritë e jetës dhe të natyrës.

I pyetur ku e merr këtë energji dhe ellan porofesional për këtë punë me kaqë përgjegjësi, Dr. Nadiu thotë se, " Profesionin e mjekut e kam ëndëruar dhe dëshiruar që si femijë. Bluzat e bardha gjithmonë i shikoja me admirim. Mendoja se si mjek më së miri do të kem mundësinë tu ndihmoj njerëzve dhe Perëndia ma plotësoi këtë dëshirë.

Fakultetin e Mjekësisë e kreva në Universitetin e Tiranës gjatë viteve 1994-2000, Specializimin dhe Magistraturën e kreva në vitin 2007 në Universitetin e Prishtinës.

Jam pjesëmarrës rregullt në seminaret shkencore profesionale në vend dhe jashtë vendit, gjë që më mundëson të njihem me të mbërimet, përvojat dhe avancimet shkencore në oftamologji.

Që nga 1 shkurti i vitit 2012 jam emëruar udhëheqës i Repartit për sëmundjet e syve në Spitalin Klinik të Teovës".

Në pyetjen se cilat ndërhyrje kirurgjike kryhen në këtë repart, "Dr. mr. sci. Nadi Rustemi, shprehet se, "Në repartitn tonë kryhen shumë lloje të kurimit dhe operacione të syrit. Për rastet tejet të vështira që i konstatojmë gjatë diagnostifikimit pacientët i orientojmë për në spitalet ku mund të kryhen ato ndërhyrje. Në repartin tonë ka një vit e gjysëm që perdoren metodat më bashkëkohore të mjekimit dhe sidomos të operimit të kataraktës me metodën Phako, që nënkupton operacionin me anë të ultra zërit, ku pas operimit pacienti brënda ditës mund të shkojë në shtëpi.

Në repartin tonë punojnë 6 mjekë, 12 motra medicinale dhe dy pastruese dhe një kuzhiniere. Të gjithë janë me kualifikmet e nevojshme për kryerjen e detyrave.Në këtë repart përveç dhomave të operimit të pajisura me aparatet e nevojshme gjenden edhe dhomat me krevatë për pacientët të cilët duhet për një kohë të qëndrojnë në spital, natyrish nën mbikëqyrjen dhe kujdesin maksimal të personelt mjekësor.

Në këtë repart përveç pacientëve nga Tetova, vijnë edhe pacientë nga shumë qytete tjera të Maqedonisë.

Organizimi i punës në repartin tonë mbështetet në një disiplinë të lakmueshme për të qenë gjithnjë në shërbim sa më cilësor të pacientëve. Paraprakisht përgatitemi dhe mendohemi mirë për çdo segment të punës sonë dhe çdo gjë e zbatojmë me përpikmëri. Mua si përgjegjës i repartit nuk më interesson fare angazhimi partiak i të punësuarve. Synimi ynë është të japim shërbime cilësore dhe t'i kryejmë detyrat me sukses. Në punën tonë nuk ka të privilegjuar.

I pyetur se kur është filluar të kryhet operimi i kataraktës me metodën Phako, Dr. mr. sci. Nadi Rustemi, përgjigjet se, " Kjo është metodë më bashkëkohore për operimin e kataraktës. Jemi aftësuar plotësisht për këtë metodë të operimit. Kemi patur edhe disa trajnime mbrenda dhe jashtë shtetit.

I pyetur sa operime të këtilla ka kryer gjer tani, Dr. Nadiu deklaron se, " Në vitin 2013, kam kryer gjithsej 800 operime kirurgjike të suksessshme, ndërsa në vitin 2012 brenda gjashtë muajve kam kryer 370 operime të syrit.

Në pyetjen se gjatë operimit të kataraktës në syrin tim të djathtë, dëgjova se u paraqit një problem i vështirë. Më rekomanduat që të rrij i qetë, Dr. mr. sci. Nadi Rustemi, theksoi se, " Kur e hoqëm kataraktën vërejta që edhe pjesa e pasme, më saktë kapsula e pasme ishte e turbullt. Këtë difekt e realizuam duke bërë kapsuloreks të kapsulës së pasme. Kjo ndërhyrje është tejet e vështirë dhe me rrezik, por me ndihmën e Perëndisë dhe me angazhimin tonë përkushtues e profesional kjo u realizua shumë mirë. Kemi patur edhe raste te tjera të ngjashme si ky i juaji, por i kemi realizuar me sukses".

I pyetur për bashkepunimin me klnikat e tjera, Dr. mr. sci. Nadi Rustemi, shton se, " Kemi bashkëpunim të shkëlqyer me Klinikën e Syve në Spitalin Shtetëror në Shkup. E përshëndes shumë kolegun tim, Iljaz Ismaili, drejtorin e Klinikës së syrit në Shkup, me të cilinn kemi specializuar së bashku, por që tani është i gatshëm të bashkëpunojë e të na ndihmojë. Uroj dhe dëshiroj që ky bashkëpunim të vazhdojë edhe në të ardhmen. Jemi të gatshëm të bashkëpunojnë edhe më klinikat e tjera brenda e jashtë për të shkëmbyer përvojat dhe në të mirë të pacientëve", tha në fund Dr. mr. sci. oftamologu Nadi Rustemi.

HOMAZH

Blerofsh për jetë Vaçe Zela!



Atë mëngjes, ndërsa me nge po bënim ritualin e kafes, një kafe-shtëpiz, prej druri e xhami, këtu në Peshkopi, e po ndiqnim përtej xhameve si rrëshqsnin, të heshtur, si në një vajtim, gajtanët e argjendët të shiut të ftohtë të shkurtit, nga ekrani i televizorit, varur diku mbi tavolinën tonë, u derdhën plotë madhështi tingujt e fjalët e këngës " O ku ka si ti, o Shqipëria ime...". Një ujëvarë madhështore tingujsh të artë, derdhej e derdhej mbi ne...

Miku im, sa e dëgjoi, lëvizi nga vendin prej magjisë së këngës e shtoi: Ah Vaçe Zela, je e madhe Vaçe... Ndërsa unë, dëgjoja këngën që vërshonte e mëndafsht e kristalt ngado, befas lexova në ekran titrat, me të zeza, titrat që përhapnin gjithashtu një kumt të zi, të zi e të hidhur për gjuhën dhe gjakun, për shpirtin dhe qenien shqiptare....

I ndërhyra mikur tim, me kujdes, të mos e lëndoja, ia mora foljen: "është" Vaçe Zela, për t'ia rikthyer në një kohë tjetër, në kohën e ikjes, të largimit, në "të shkuarën" pa kthim... Me dhimbje miku im, por, nga ky çast e në pafundësi, s'do të themi më "është", por "ishte", Vaçe Zela; jetuam në kohën e Vaçe Zelës..E madhja Vaçe nuk është më...,nga sot atë e kanë qiejtë.

Me gjithë fuqinë e qënies, deri në regtimën e fundit Vaçe Zela, e deshti me frymë e me shpirt dheun e saj, Shqipërinë, e nga sot e përjetësisht, Shqipëria, me të lindurit e të pa lindurit e saj, do ta kujtoj e do ta mbajë të gjallë Vaçe Zelën, emrin dhe zërin e saj.

Vaçe Zela, i zbuloi botës se shqipja është gjuhë e këngës, se shqipja e kënduar është gjuhë e perëndishme. Për ikjen e Vaçes, do të qajë shqipja, do të vajtojë poezia, do të fërgëllojë e dridhet bjeshka, e do të mërrolet Mali i Tomorrit e Korabi...

Mezi i mbaj lotët, të mbledhur lëmsh në grykë, tek më fanitet, ashtu si një re e bardhë, Vaçja që po i shkëputet tokës së saj të shtrenjtë e të dashur, Shqipërisë, në këtë ngjitje të pasosur e pa kthim, drejt përjetësisë. Më duket vetja si një fëmijë i vogël, që i fshikulluar në trishtim e dhimbje, rrekem më kot ta tërheq, e ta mbajë, për të mos e lënë të iki, të ngrihet, atje lart..., nga ku nuk mund të kthehet më...

Por, ah më kot...Ajo iku, iku, ...

S'do jetë më Vaçja, ai flladi i agimit që derdhej fushave të Myzeqesë, e u vishej maleve si puhizë, për t'u shndërruar zanë mali këngëtore, uji burimi, a gurrë që s'shteret kurrë...

Ne, që i përkundëm ëndrrat tona të rinisë, në fugën e "Valsit tënd të lumturisë", ne që mbushëm ditët tona, me ritmet e fyshkëllyera të melodive e këngëve tua, ne që patëm frymë pagëzuese të shoqërive, miqësive e dashurive të rinisë sonë, magjinë e zërit tënd të artë, të atij zëri që mbushte me dritë e me shkëlqim, që jonizonte ajrin anembanë, gjithë atmosferën përreth nesh, në shkolla e në aksione, në pistat e vallëzimi, kampingjet e blerta të fushimeve ushtarake, ne që kemi akorduar telat e shpirtit tonë në pentagramin e shpirtit tënd, ne, një brez i tërë të jemi përjetësisht mirënjohës, jemi fatbardhë që jetuam në kohën e artit tënd të madh, dhe u mëkuam e u fisnikëruam prej tij. Nga shpirti ynë kurrë, sdo mund të të shqis asgjë, asnjë fuqi, se ne të kemi në frymët dhe në ritmet e zemrave tona. Blerofsh për jetë e pavdekshmja Vaçe !

HYSEN UKA

studim

Hilmi Kolgjegja është një nga personalitetet më të shquara të kulturës sonë kombëtare

Kërkuesi i perlave

Nga **XHAFER MARTINI**

(Vijon nga numri i kaluar)

Hilmi Kolgjegja me tufën me alegori që ka sjellë tek libri "Perlat shqiptare" krijon mundësi për të hetuar ato drejtime të reja që ka marrë ky zhaanër në kohën e sotme, në shekullin e ri. Duke u nisur nga kjo tufë me tregime alegorike, por edhe me plot të tjera të mbledhura me shumicë prej tij, arrimë në përfundimin që ky zhanër nuk do të largohet nga skena e artit kombëtar, por do të fuqizohet dhe do të përtërihet. Alegoria sot, për mendimin tim, nuk është më ajo tipikja, alegoria standarte, klasike, e vështrirë për t'u deshifruar. Alegoria sot ka humbur diçka nga elitarizmi i shekujve të kaluar dhe është bërë më e thjeshtë, më popullore, më e përshtatshme për mjedise dhe rrethana të reja, që nuk janë aq komode dhe stabile si odat dhe mexheliset e dikurshme. Duke qenë tashmë një alegori tavolinash dhe lokalesh dhe e mjediseve të shpejtndryshueshme, ka ndryshuar edhe vetë, duke fituar një temporitëm të ri, duke qarkulluar më shpejt, duke zhdërvjelltësuar format dhe mënyrat e shprehjes, duke u bërë më energjike dhe më gjithëpërfshirëse. Në qarkullimin e alegorisë nuk kemi tashmë ato bartësit klasikë, mendimtarët dhe filozofët popullorë, si: Selim Sula, Sali Bitri, Tafë Kola, Mane Kacani, Maliq Nikolli e të tjerë. Nuk janë as odat e Murat Kaloshit, Elez Isufit, Dine Hoxhës etj., përherë të hapura, plot me burra të mençur që ndanin kanun dhe merreshin me alegori. Ata vërtet nuk kishin shkollë, por e kishin mprehur aq shumë mendjen, e kishin kaq shumë të zhvilluar të arsyetuarit sa me të drejtë mund t'i quajmë filozofë. Odat e Dibrës ishin auditorë universitetesh. Alegoria ishte bërë një shkollë e vërtetë.

Në ditët e sotme gjithçka ka ndyshuar. Jeta është bërë shumë e gjallë, dinamike. Alegoria, për të mbijetuar, ka ndryshuar. Gjithçka që do të jetojë, ndryshon. Evoluimi është ligj universal. Edhe ceremonit fetare, sidomos ato kishtare, janë përshtatur pak a shumë për t'iu përgjigjur kërkesave të shekullit të ri. Pak vite më parë kam parë filmin "Murgesha gazmore" dhe aty kam kuptuar se çfarë nuk bëjnë etërit e mençur të kishës për t'i afruar besimtarët. Kjo gjë bëhet me para, me fonde dhe udhëhiqet nga njerëz të përgatitur. Alegoria këtë e bën vetë, pa modele dhe pa ndihma, në saj të vitalitetit dhe të premisave për të kontribuar akoma në zhvillimin e shoqërisë njerëzore. Narratorët e saj sot janë njerëz ta zakonshëm, nga të gjitha shtresat. Alegoria ka pësuar ndryshime edhe në strukturë, në trupin dhe përbërjen e saj, në qëllimet dhe mjetet e mënyrat e aktivizmit. Kjo e fundit - mënyra e aktivizimit -, ka rëndësi të madhe se prej saj varen tipat e formimit të alegorisë nëse mund të flitet për to qysh në këtë fazë të zhvillimit të ri. Në të kaluarën e hershme alegoria zakonisht zhvillohej në çifte: tregohej një mesele, që "vriste"dikë, dhe kësaj i përgjigjej dikush me një mesele tjetër që, për nga mesazhi, ishte e kundërt me meselen e parë. Kjo ishte rruga më normale, më e zakonshme, se kishte edhe vargje me tregime alegorike, raste kur tregoheshin shumë alegori, por brenda asaj ligjësie: ato i kundërviheshin njera-tjetrës.

Në tregimet që ka sjellë Hilmiu, tregohet një alegori, e cila nuk pasohet nga një e dytë, por brenda saj bëhet një replikë që kundërshton mendimin e saposhprehur, duke marrë kjo replikë vlerën e një alegorie më vete. Tipik për këtë mënyrë aktivizimi është tregimi "Babai "paguan" djalin", të cilin po e japim të plotë:

"Babai me të birin shkuan miq në një fshat, i përmendur për alegori. Si hëngrën darkë, djalin e zuri gjumi. Njëri nga fshatarët, për të ngacmuar babanë e djalit, i tha shokut të vet:

- O Sali, a e mbolle arën sot?

- Jo, - ia ktheu Saliu.- Nuk e mbolla se mëzati që kisha me kaun, ra në gjunjë.

Babai i djalit i cili e kuptoi se fjala ishte për djalin e tij, që flinte, tha:

- Or mik, mëzati nuk ka ra në gjunjë nga lodhja, por nga meraku që e ka zënë për ndonjë mëshqerrë, prandaj nesër lere mëzatin ndër lopë se do t'i vijë fuqia".

Siç shikohet, këtu kemi vetëm një tregim alegorik, dhe një replikë alegorike, por që është e mjaftueshme për të dhënë përgjigje për alegorinë e parë që u tregua për të kritikuar qëndrimin e pahijshëm të djalit në odën e burrave. Sipas aktivizimit klasik të alegorive, nëse mund të shpreheshim kështu, mbasi u tregua alegoria e parë që kritikon qëndrimin e djalit, duhej të tregohej një alegori e dytë që, për nga përmbajtja, nuk do të ishte fare e ngjashme me atë që u tregua. Alegoria e vetme me një replikë alegorike kundërshtuese brenda saj më duket se ka fituar tendencën e zhvillimit, se e shikojmë edhe tek alegoritë e tjera të Hilmiut. Për nga tematika, alegoria e mësipërme është në hullinë e temës së zakonshme për të kritikuar veset dhe qëndrimet e njerëzve. Është tipi i alegorisë që trajton probleme shoqërore dhe që ka mundësi të shumta zhvillimi. Krahas kësaj, po zhvillohet edhe alegoria me temë nga politika, mbasi politikanët tanë, siç kanë dëshmuar këto vitet e pluralizmit politik, janë nga më të predispozuarit për t'u bërë objekt i alegorisë.

Një tjetër risi që vihet re në alegoritë e Hilmiut botuar tek "Perla shqiptare", është ajo që kompozimet alegorike nuk janë më ato të tipit klasik, ku ka disa vargje me tregime alegorike; në përbërjen e secilit varg ka katër, pesë ose më shumë alegori që tregohen njera pas tjetrës, nga bartës të ndryshëm dhe që kundërshtojnë njera-tjetrën. Me këtë tip ne jemi marrë shumë duke sjellë shembuj nga kompozimet alegorike në librin"Perlat e Dibrës", studim për alegorinë. Po të kemi parasysh se çfarë është thënë në atë libër, këto që po themi tani për alegorinë janë risi që i ka fituar vetë zhanri në rrugën e tij për mbijetesë, me gjetjen e mënyrave dhe formave të reja të aktivizimit. Se çfarë veçorish kanë fituar vargjet me tregime alegorike në këtë fillim shekulli, le të shikojmë tregimin "Nëpunësi dhe rrushi "Hafuzali". Tregimi është një, por unë e kam ndarë në pjesë për lehtësi studimi:

Pjesa e parë e tregimit: "Një nëpunës nga Tirana shkoi për një problem shtetëror në Luzni të Dibrës. Meqë nuk dinte rrugën, pushteti lokal i dha një shoqërues me vete. Kur vajtën në Luzni, shoqëruesi takoi kryetarin e kooperativës dhe e pyeti:

- A është Hafuzi në shtëpi se do ta takojë ky nëpunësi nga Tirana?

- Për fat të keq nuk është, sepse ka një javë që e kemi dërguar në Tiranë.

- Po djemtë e nipat a i ka në shtëpi? – e pyeti përsëri shoqëruesi.

- Edhe ata i kemi dërguar në Peshkopi, - ia ktheu kryetari.

Si u largua kryetari, nëpunësi i çuditur nga kjo bisedë, i tha shoqëruesit:

- Ç'është ky Hafuz kur unë kam ardhur për tjetër njeri?

- Unë e kisha fjalën për rrushin Hafuzali, - i tha shoqëruesi, - që për fat të keq e paskan dërguar në Tiranë.

- Por djemtë dhe nipat e Hafuzit kush janë?- vazhdoi nëpunësi i habitur.

- Janë variatetet e rrushit, që edhe këto i paskan dërguar në Peshkopi për t'i bërë raki.

Pjesa e dytë: Për darkë shoqëruesi me nëpunësin shkuan te një fshatar. Sa u ulën, nëpunësi nxori gazetën dhe filloi të lexonte. Fshatari, për të ngacmuar mikun me muhabet, i tha shoqëruesit:

- Meqë është ftohtë, bjeri pak me mashë kërcunës që të ngrohemi.

- Kërcunës i bie unë, se e kam afër, - tha nëpunësi dhe mori mashën dhe çukiti zjarrin.

- I zoti i shtëpisë nuk e ka fjalën për kërcuna, por tek ti, që nuk po bën muhabet, - i tha shoqëruesi.

- Përse kërcuna që duhet qukitur qenkam unë! – tha nëpunësi i habitur.

- Kështu është, - vazhdoi shoqëruesi, - prandaj veri vesh llafit se këtu je në Dibër.

Pjesa e tretë: Të nesërmen, kur do të largohej, nëpunësi i tha fshatarit:

- Ke ndonjë porosi për Tiranë?

- Kam vetëm një porosi, - tha fshatari, - u thuaj atyre të ministrisë së tregtisë se në Dibër misri ishte bërë mjaft, por nuk kishin thasë ku ta futin.

- Pse, nuk ka thasë Peshkopia?- pyeti nëpunësi.

- Thasë për misër ka, - tha shoqëruesi, - por ky e ka fjalën për letra duhani, se duhani është bërë, por mungojnë letrat":

Secila pjesë është një mesele ose një tregim alegorik më vete. Tri pjesët bëjnë një kompozim alegorik. Ky lloj kompozimi alegorik ka mjaft largesa estetike, përmbajtësore dhe strukturore nga kompozimet alegorike klasike, që janë sjellë tek "Perlat e Dibrës", ku tregimit të parë i kundërvihet me mesazh dhe me përmbajtje krejt tjetër tregimi i dytë, kur tregimit të dytë i kundërvihet, po në të njejtën mënyrë, tregimi i tretë e kështu me radhë. Për ta bërë edhe më të qartë mënyrën e aktivizimit tek tipi klasik i vargjeve alegorike, do të thoshim se është tregimi i dytë që deshifron kuptimin ose nënteksin e tregimit të parë, siç është i treti që bën të njejtën gjë për tregimin e dytë, siç bën i katërti për tregimin e tretë e kështu deri në fund. Në këtë lloj kompozimi ose vargu alegorik secili tregim është i lidhur ngushtë me tregimin pararendës dhe të gjithë bashkë formojnë një unitet ideoartistik. Tregim i fundit që i "vë shtrazën mullarit" përçon atë ide ose mesazh që del fitues si rezultat i ndeshjes të të gjitha tregimeve alegorike; ai përfaqëson qëndrimin që duhet mbajtur, alternativën që duhet ndjekur. Kështu, si shembull, në një kuvend të malësorëve të Dibrës për të vendosur nëse duhej apo jo që ta nisnin kryengritjen kundër forcave serbe (viti 1920), u treguan pesë tregime alegorike. Tregimi i parë, i tretë dhe i pestë ishin për nisjen e kryengritjes, kurse tregimi i dytë dhe i katërt ishin kundër kryengritjes duke argumentuar se populli do të binte në një robëri të re më të egër se e para. Këtu "fiton" njera alternativë, ajo për fillimin e kryengritjes; këtë nuk e ka siguruar thjesht numri më i madh i tregimeve në favor të saj, por edhe cilësia e tyre.

Kurse tek tipi i tregimit që sjell Hilmiu, tregimi i parë nuk ka të bëjë me të dytin, as i dyti me të tretin. Ato janë të shkëputur nga njeri-tjetri si për nga mesazhet që përcjellin, ashtu edhe për nga konteksti mjedisor ku thuhen. Ato nuk i përgjigjen njeri-tjetrit dhe as nuk zbulojnë e nuk deshifrojnë kuptimin e njeri-tjetrit. Kuptimi i secilit prej këtyre tre tregimeve zbulohet nga një person tjetër në kuadrin e vetë tregimit. Për shembull, shoqëruesi, tek tregimi i parë, i shpjegon nëpunësit se Hafuzaliu nuk është njeri, por një lloj rrushi. i njejti person, tek tregimi i dytë, i thotë po atij nëpunësi se zoti i shtëpisë nuk e kishte fjalën për kërcunën, por për mikun. Po kështu, njëlloj, veprohet edhe në tregimin e tretë ku shoqëruesi i shpjegon nëpunësit që zoti i donte që nga Tirana të vinin letra duhani dhe jo thasë. Siç mund të kuptohet, ky është një tip i ri tregimi alegorik, që më duket se është më i përshtashëm për dinamizmin e kohës në të cilën jetojmë. Për nga ana strukturore këto lloj tregimesh kanë në përbërjen e tyre të njejtët personazhe deri në fund (nëpunësi dhe shoqëruesi i tij), por kanë edhe personazhe të dorës së dytë që shtohen gjatë ecurisë së tregimit (kryetari i kooperativës dhe zoti i shtëpisë). Kryetari është veprues në një tregim, kurse zoti i shtëpisë në dy tregime. Ata janë i njejtin personazh përsa i përket medimit që përçojnë, rolit që luajnë dhe qëllimit që i kanë vënë vetes. Të dy venë në lojë nëpunësin e ardhur nga Tirana, të dy, edhe pse janë në rolin e mikpritësit, tregojnë përçmim dhe mosbesim ndaj tij, të dy tregojnë epërsinë e fshatarit ndaj intelektualit që nuk njeh jetën. Nëpunësi me mosdijen dhe moskuptimin është si i verbëri që duhet ta mbajsh për krahu që mos të rrëzohet. Të tri pjesët e tregimit alegorik kanë një shkak për t'u treguar, baza e tyre estetike është e ndryshme, megjithëse mënyra e rrëfimit dhe e përfundimit për nxjerrejn e mesazhit është e njejtë. Në tregimin e parë estetikisht veprohet me keqkupitmin ose moskuptimin, tregimi i dytë ndërtohet mbi bazën e simbolit të kërcunës me mikun, në tregimin e tretë kemi shoqërimin e ideve ku thasët të kujtojnë letrat e duhanit për nga ana e funksionit.

Tendenca e tretë në tregimet që sjell Hilmiu në këtë përmbledhje është se një pjesë e tyre shërbejnë për të realizuar komunikimin në fshehtësi, ndonëse gjithçka thuhet ndër sy të njerëzve dhe dëgjohet mirë prej tyre. Kjo nuk është një risi, këtë e kemi thënë që në krye të herës kur kemi studiuar tematikën dhe problematikën e tregimeve alegorike. Por këtu është me vend të theksohet se komunikimi në fshehtësi nuk bëhet për modë, ai është mjet artistik, por jo në vetvete, nuk është figurë për figurë, por figurë për të shprehur një përmbajtje, që ka një qëllim të caktuar - realizimin e komunikimit. Me pak fjalë, kjo mënyrë komunikimi përdoret kur ke hall. Fshehtësia është mjeti i vetëm që të nxjerr nga halli ku ke rënë. Pra, komunikimi në fshehtësi lindi nga nevoja dhe realizohet në ato kushte që krijuan hallin. Por brenda këtij tipi i vibron një lloj tregimi tjetër. Edhe në këtë tip tregimi ka hall, ka një problem për të zgjidhur, qoftë ky moral, mendor e çfarëdo tjetër. Dallimi midis tyre qëndron në faktin se në tregimin e parë të nxjerr nga halli thjesht fshehtësia e komunikimit, kurse në të dytin mençuria, veçanërisht mençuria e femrës. Për të ilustruar rastin e parë duhet të sjellim tregimin "Historia e kërcurit që u ndërrua me misër" dhe për rastin e dytë tregimin "Nusja e zgjuar".

HISTORIA E KËRCURIT QË U NDËRRUA ME MISËR

"Turqit kishin arrestuar një patriot të shquar për ta internuar në Bodrum Kala të Turqisë. i biri, për të shpëtuar të atin, shkoi tek një mik t'i kërkonte ndihmë. Tek shtëpia e mikut gjeti një bimbash turk dhe disa ushtarë. i zoti i shtëpisë, për t'i thënë mikut që turqit nuk e kuptonin muhabetin alegorik, tha:

- Fol, or mik, pa merak se misrin tënd nuke bluajnë mullijtë e këtij fshati.

- Nesër dua të pastroj livadhin, mirëpo gurë ka shumë e punëtorë kam pak, - ia ktheu malësori.

- Punëtorët që të mungojnë do të t'i çoj unë, - i tha miku, - ndërsa gurët që nuk të prishin punë, mos i luaj vendit.

- Në mes të livadhit është një kërcunë pishe që më prish shumë punë. Si thua, ta djeg apo ta shkul?

- Kërcunën mos e digj, por shkule se do na duhet për ta ndërruar me misër në pazar, - i tha miku.

Me kaq malësori me mikun u morën vesh për planin e betejës që do të zhvillonin të nesërmen kundër turqve, ndërsa bimbashi me ushtarët, duke kujtuar se e kishin fjalën për ndonjë livadh, as që e vranë mendjen për bisedën e tyre.Të nesërmen ngjarja ndodhi ashtu siç e kishin parashikuar. Bimbashi bashkë me ushtarët ranë në pritën që kishin zënë malësorët. Ushtarët që qëndruan, u vranë, ndërsa të tjerët ranë robër bashkë me bimbashin. Pas disa ditësh "kërcurin e pishës", bimbashin, e shkëmbyen me "misrin", të atin e malësorit".

NUSJA E MENÇUR

"Babai martoi të birin. Tri ditë pas martesës, për të provur sa e zgjuar ishte nusja, i tha djalit:

- Unë po shkoj të mbjell arën, ndërsa ushqimin e drekës të ma sjellë djali yt.

Babai u nis për punë, ndërsa i biri tepër i mërzitur, vuri duart në kokë dhe po mendohej. Nusja, kur e pa burrin të shqetësuar, e pyeti:

- Përse je i mërzitur?

- E si mos të mërzitem, moj grua, - ia ktheu i shoqi, - ka tri ditë që jemi martuar e babai kërkon që drekën në arë t''ia çojë djali ynë.

- Kot mërzitesh, - i tha e shoqja, - këtë punë e rregulloj unë, prandaj rri pa merak.

Nusja përgatiti ushqimin dhe ia çoi vjehrrit në arë. Pas buke nusja i tha vjehrrit.

- Or babë, si të mbarosh mbjelljen, merr një krah me kallzë gruri dhe bjere në shtëpi, se do të përgatisë një lakror me djathë.

- Çfarë thua, moj nuse, - ia ktheu vjehrri i habitur, - si paska mundësi që brenda ditës të mbjellësh dhe të korrësh grurin?!

- Përderisa ke kërkuar që pas tri ditësh martese djali im të të sjell bukën në arë, atëherë s'ka përse të mos mbillet e të korret gruri brenda ditës.

- Të lumtë, nuse, provën e kalove me sukses, se qenke jo vetëm punëtore, por mjaft e zgjuar, - ia ktheu vjehrri".

Në të dy tregimet ka një problem për të zgjidhur, një hall. Në tregimin e parë halli kapërcehet nga fshehtësia e komunikimit, në tregimin e dytë nga zgjuarësia e nuses. Tregimet alegorike, siç po shikohet, kanë prirjen që të ndikojnë edhe në zhvillimin dhe zhdërvjelltësimin e mendjes së njeriut, në vënien e njeriut para situatave të vështira që kërkojnë zgjidhje, por këto zgjidhje nuk jepen të gatshme. Duhet menduar dhe arsyetuar për të arritur ato. Hilmiu e ka të pasur krijimtarinë e tij me këto lloj tregimesh. Tek "Perlat shqiptare" ka një kapitull që ai e ka quajtur "Pyetje proverbale - kanunore", por, pavarësisht se si janë quajtur, këto pyetje proverbale janë shumë të afërta me këtë lloj tregimesh që paraqitëm më lart. Po japim dy shembuj:

"- Cila është gjëja më e rëndë për njeriun?

- Kur të tjerët të njohin për të zgjuar e nuk të njeh fëmija yt, kur të drejtën ta bëjnë të shtrembër dhe kur të gjykon budallai".

***

"- Ka tri lloj mikpritjesh. Mikpritja më e lartë është kur miku bën gabim dhe zoti i shtëpisë ia fal. Mikpritja e madhe është kur mikut i thua mirësevjen pa e parë dhe mikpritja e zakonshme kur mikut i thua mrësevjen pasi ta kesh parë".

Këto lloj konstatimesh, përvojash, mund të kthehen në tregime alegorike ose edhe në vargje me tregime alegorike të tipit që është karaktersitikë për krijimtarinë e Hilmiut.

Si përfundim, me kaq sa u tha për alegorinë në këtë shkrim, del që Hilmi Kolgjegja ka jo vetëm një pasuri shumë të madhe me tregime alegorike, por edhe të atij lloji që të japin mundësi për të hetuar tendencën e zhvillimit të këtij lloj arti të suksesshëm. Nëse solla ndonjë kontribut sado të vogël, por të ri, për studimin e alegorisë nga ç'kam thënë më parë, kjo i dedikohet Hilmi Kolgjegjës.


Rruga e Arbërit nr. 94

Mendime rreth botimit “Kanun” dhe librave të tjerë të Xhafer Martinit

kujtime

Dhjetë ditët e mia në Dibër

Nga **MEHMET DUME**



Dibrën e kisha njohur edhe nga këngët e mrekullueshme të Haziz Ndreut, Arif Vladit, Qerim Sulës, Liri Rashës, Vera Laçit e Saje Poleshit. Rasti e dha që ta shikoj nga afër këtë trevë të njohur jo vetëm në histori por dhe në zgjuarsi, bujari, besë e folklor...

Kisha dëgjuar për Dibrën dhe dibranët që kur isha nxënës në shkollën e mesme “Skënderbeg”, kisha dëgjuar dhe lexuar shumë për heroin tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, kisha lexuar për ato burra qeleshe bardhë që jo vetëm me armë por dhe me mendje të zgjuar prej dibrani kishin bërë të mundur që në kujtesën e kujtdo Dibra të ishte ngulitur mirë. Jo vetëm kaq por unë Dibrën e kisha njohur edhe nga këngët e mrekullueshme të Haziz Ndreut, Arif Vladit, Qerim Sulës, Liri Rashës, Vera Laçit e Saje Poleshit. Rasti e dha që ta shikoj nga afër këtë trevë të njohur jo vetëm në histori por dhe në zgjuarsi, bujari, besë e folklor. Duke qenë lexues i rregullt i gazetës dibrane “Rruga e Arbërit” po dërgoi një shkrim se si qëndron në kujtesën time Dibra me ata njerëz të mrekullueshëm të atyre trevave. E kisha parë këtë zonë nga larg ku ngrihej madhështor mali i Korabit, më i larti në vendin tonë. Nga do që të dilje në maja të ndryshme do të përballeshe me Korabin, ashtu siç është kryelartë buzë kufirit me Maqedoninë, i hapur si dy krahë shqiponje në mbrojtje të trojeve shqiptare. Por nga vetë detyra ime atëherë si oficer madhor mu dha rasti që të kaloj plot dhjetë ditë në Dibër që për mua edhe pse kanë kaluar kaq e ka vite nuk shqiten lehtë nga kujtesa. Atëherë ishte viti viti 1986 , kur në rrugë me sekretarinë sekrete vjen një zarf i mbyllur ku mbi të shkruhej emri im. E hap dhe lexoi me kujdes ku thuhej:”Jeni ndërmjetës pranë komitetit partisë së brigadës së Kastriotit në Dibër. Tema: Stërvitje komando shtabi tre shkallëshe. Marrin pjesë divizioni i Dibrës,Bulqizës e Kukësit. Drejtimi kryesor: Qafa e Korabit, Kastriot,Fushë Alie,Qafa e Lurës, Mirditë,derdhja e lumit të Drinit (bregdet). Përgadituni për këtë stërvitje”. Të them të drejtën u gëzova shumë pasi do të shkoja në një zonë që e kisha ëndërruar herët dhe ja tani më jepej mundësia të shkelja pikërisht në trojet e Skënderbeut i cili bëri që t’i dridheshin gjunjët perandorisë otomane. Fillova të mendoj zgjidhjen e kësaj detyre. Në dorë do të kisha zarfat dhe situatat që dilnin. Me vehte mora shumë materiale nga eksperienca ime. Nuk ishte hera e parë, kisha marrë disa herë pjesë në të tilla stërvitje. Por kjo në fakt ishte temë e rëndësishme. Tre divizione të frontit veri lindor në mbrojtje për të përballuar agresionin përballë tre zonave operative që kishte armiku i imituar, por theksoj se komandanti i frontit veri lindor ishte dibrani i mirë Ismail Shulku. Pikërishtë për aftësitë e tij dhe pregaditjen që kishte i dhanë këtë detyrë. Por duhet sqaruar se në çdo stërvitje apo dalje në pikat e drejtimit apo vendkomanda ishin reale e jo kurrë për të bërë shaka, sikur se thuhet sot në këto kohë kur njerëzit nga politika e mbrapshtë janë hallakatur e nuk dinë se çfarë thonë. Unë kisha për detyrë të përgaditesha dhe në datën e caktuar shkoj në Tiranë ku takohem me ndërmjetësin kryesor e nisem direkt për në Dibër. Gjatë udhëtimit mjaft mbresëlënës njëri nga shokët na ndali në Shupenzë, një fshat ky i mbledhur e plot me mollë. Mikpritja dibrane nuk do të na mungonte siç do të shkruaj dhe më poshtë. Pak përballë nesh shtrihej lumi i Drinit të Zi e matanë këtij lumi shtrihej qyteti i Dibrës së Madhe apo siç e quajnë dibranët Shehri i Dibrës. Çfarë pa drejtësie kanë bërë fuqitë e mëdha me këtë popull. Ja ku është ndarë Dibra në dy pjesë. Më tutje Gjorica ku sapo dikush nga tavolina përmendi emrin e këtij fshati mua më erdhën në kujtesë vargjet e këngës së Hajredin Pashës, kënduar me mjeshtëri nga Haziz Ndreu:

” Hajredin Pasha po vjen Radikës,
pyet ku janë malete Dibrës...”

Ishte pikërisht kjo betejë e famshme që zhvilluan Malet e Dibrës kundër një ushtrie të madhe turke të komanduar nga Hajredin Pasha. Pyeta një të moshuar që na u gjend pranë ato orë pushimi në Shupenzë se ku ndodhej Bllaca, sa larg ishte nga Shupenza.

-Është afro 18 kilometra që këtu, u përgjigj dhe e gjitha në një teren malor e me një rrugë të pa shtruar. Për teqen e Bllacës dija shumë, kisha dëgjuar qysh i vogël në fshatin tim të lindjes në Çepan të Skraparit. Aty për një kohë të gjatë kishte shërbyer gjyshi i babait tim baba Zeneli. Ishte pikërisdht ky baba që më kishte lënë dhe emrin mua. Baba Zeneli një mik i ngushtë i heroit të popullit Haxhi Lleshi, teqen e Bllacës e ktheu në një bazë të fuqishme të luftës nacional-çlirimtare. Ishte larg teqeja e Bllacës e unë këto ditë të pakta që isha me shërbim nuk mund të shkoja të përkulesha para varrit të baba Zenelit. Pas një pushimi të shkurtër në Shupenzë përsëri u nisëm për udhë. Qyteti i Peshkopisë vërtet ishte i bukur, i pastër dhe me një shëtitore për ta patur lakmi të gjithë qytetet e tjera të vendet. Nuk di se sapo shkela për herë të parë më nxorri mallin e Beratit dhe Gjirokastrës me shtëpi njëra mbi tjetrën dhe rrugët me kalldrëm. Por kjo ishte në hyrje të qytetit. Më tutje Peshkopia ndryshonte me shumë qytete të tjera të vendit tonë, i pastër, me plot gjelbërim dhe ujë nga bjeshkët e Korabit jashtë si dhe stola të shumtë ku çlodheshin qytetarët. Më së fundi makina ndaloi në Kastriot, atje ku ishte dhe brigada. Këtu çdo gjë lidhej me figurën e heroit tonë kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu. Kudo toponimet lidheshin me këtë figurë të madhe të kombit tonë por dhe në kujtesën e të rinjëve dhe pleqve Skënderbeu ishte kryefjala e bisedës në Kastriot. Në moment sapo vajta filloi dhe puna ime. U dha sinjali i alarmit e vazhduam në drejtim të Sllovës e Kalasë së Dodës. Unë vazhdoja të mbaja shënimet e mia që nga përgaditja, dhënja e sinjalit e në vazhdim të veprimeve sipas varianteve që ishin të sintetizuara në zarfat që hapja. Komandant brigade ishte Gani Farruku. Më vjen shumë keq që u nda shpejt nga jeta ky njeri i mirë dhe ushtarak me përvojë. Model dhe mjaft i komunikueshëm që krahas artit ushtarak, artin e komunikimit e kishte pronë të vetin. Ai së bashku me Selim Abdiun interesoheshin që ne të na krijonin kushte sa më të mira. Kjo bëhej me realizuar detyrën e ngarkuar sa ma mirë e të mos mungonte asgjë. Unë përveç ndihmës që jepja dhe kjo ishte e pa kursyer sodisja edhe natyrën e bukur në këto anë. Që aty në atë majë mali ku ishim shikoja si në pëllëmbë të dorës të gjitha fshatrat e Dibrës që ishin shtrirë buzë Drinit dhe në të dy faqe malesh. Fshatin e Kastriotit më shumë e zbukuronin më shumë plantacionet e mollëve si dhe kavaletat e tyre që ndodheshin në mes të plantacioneve, e pikërisht këtu ishte dhe brigada. Shikoja Korabin kryelartë që dukej sikur thoshte: ”Unë jam me ju”. Aty në krahun tonë Kalisi. Dukeshin fare qartë shtëpitë e para. Me Dibrën e ndante vetëm një lumë i rrëmbyeshëm; Veleshica e cila në dimër fryhej e fryhej e vinte si e tërbuar duke rrëmbyer çdo gjë që i dilte përpara e derdhej në lumin Drin pikërisht në Zalldardhë. Këtu ishin vendosur batalionet artmitraliere të vendosura përgjatë kufirit. Sigurisht brigadat e kufirit kishin tre batalione të tilla plus dhe nga një kompani. Por ishin edhe tre batalione këmbësorie. Pastaj shtabi, kompanitë autonome, grupet e artilerisë tokësore e kundër ajrore por mos harrojmë bateritë e lartësissë të kalibrit rëndë. Për vëmëndjen e lexuesve, dy të tretat e largëhedhjes predhave ishin jashtë kufirit. Kjo për tu prishur formacionin e skalioneve të dyta që i afroheshin kufirit shtetëror. Kjo mund të jetë një temë e veçantë se si përgaditeshim. Stërvitja vazhdonte sipas varianteve që jepeshin. Unë përveç ndihmës që jepja e shënimeve për konkluzionet mahnitesha nga natyra e bukur. Më tregonin se në majë të Korabit kishte sheshe të pa fundnme ku kullosnin mijra tufë bagëti. Për një moment mu kujtua kënga e këngëtares Liri Rasha:

”Moj fushë e Korabit, moj e mjera unë

Na ndave prej shtratit moj e mjera unë...”

Kanë shumë të përbashkëta Fusha e Korabit dhe Lëndina e lotëve në Korçë. Jo nga sipërfaqet që zënë e bukuritë por nga dramat njerëzore që mbartin të dyja këto fusha. Këtu përcilleshin djemtë dhe burrat e martuar duke nisur udhët e kurbetit, një plagë e madhe e shoqërisë e cila dhe sot është e pranishme në çdo familje shqiptare. Burrin e Lirie Rashës , Pashk Jushin nga Mirdita e kisha shef hetuesie të brigadës. Ai e bënte mirë detyrën se ishte vërtet specialist. Kur ndodheshim në Lurë më kërkoi leje se do zbriste në këmbë poshtë deri në Zalldardhë për të takuar babën e Liries dhe ne i dhamë leje. Shikoja Kalanë e Dodës,fshatrat matanë Drinit, Lurën e kudo natyra i ka qëndisur këto anë si me dorë. Një mrekulli të tillë vetëm në Dibër e gjen. Shumë afër Sllovës shtrihej një fushë e bukur me shtëpi të mbledhura. Ishte Shumbati, një ndër fshatrat më të mëdhenj në këtë zonë e me më shumë histori. Unë nuk e dija se kur do të vija me banim në Tiranë do të takoja përballë shtëpisë time një shumbatas të mirë, një studiues të zellshëm Shaqir Skarrën. Stërvitjes po i vinte fundi. Komanda, shtabi, aparati kishin punuar me një përkushtim të madh. Dallojmë Gani Farrukun komandant e Selim Abdiun komisar. Unë punova gjatë gjithë kohës që në fund do ti lexoja. U hodhën sipas variantit, përballë Korabit nga krahu i Lurës. Aty një takim i shpejtë. Shtabi e aparati lexoi konkluzionet për t’i falenderuar e nxjerrë faqe bardhë edhe ndërmjetësit. Sidomos ai që ishte pranë komandantit e shtabit. Pasi i lexova ashtu rrjedhshëm ku spikatnin:mobilizimi, shkathtësia, përgaditja,, mikpritja e shumë të tjera. I pari foli komandanti i brigadës Gani Farruku: ”Ju faleminderit, edhe ne sikur ti kishim shkruar nuk do ti shkruanim më bukur”. Ndërmjetësi pranë komandantit të shtabit më tha: ”Të lutem kur të shtypen e dua dhe unë një kopje, të jemi me një mendim”. Kaq u desh, komandanti Gani Farruku i thotë komisarit Selim Abdiut: ”Tani unë do vazhdoj në këto momentet e fundit se stërvitja kish mbaruar, çoje me makinë në baterinë e lartësisë, në Qafën e Lurës. Atje ishte një komandant shumë i përgaditur por kështu ishin dhe kuadrot e ushtarët. Pikërisht në këtë bateri që ndodhej në Qafë Lurë tregonin një histori që u kishte ndodhur vërtet. Para pak kohësh kishte rënë rrufeja por me mjaft shpejtësi kishin shmangur municionin që kishin dhe kështu nuk kishte ndodhur asgjë me rrezik për zonën. Komandanti i baterisë pyet se nga është komisari.

-Nga Skrapari, i thotë Selimi, por ne dibranët me skraparlinjtë kemi qenë miq herët.

-Atëherë, thotë komandanti i baterisë, ajo gjysmë kile raki na vjen nga Skrapari, jepjani komisarit. Ajo natë mes ushtarëve në Lurë kaloi shumë mirë, me muhabet Dibre, mish derri të egër e raki skrapari. Më vjen sinqerisht keq që nuk e mbajta mend emrin e atij komandanti babaxhan e hokatar që ishte një me ushtarët e oficerët por kur vinte puna tek disiplina dhe rregulli ushtarak nuk të falte por shpreh besim se kur ta lexoi këtë shkrim në gazetën e Dibrës them se do më kërkojë vetë të pimë qoftë dhe një kafe e të kujtojmë edhe njëherë atë natë në Lurë mes ushtarëve. Të nesërmen mbaroi stërvitja. Më përcollën me makinë për në qytetin e Peshkopisë. Kur u nisa për Tiranë pashë në bagazhin e makinës me të cilën udhëtoja një arkë plot me mollë Kastrioti. Nuk do ti harroj kurrë ato njerëz të mrekullueshëm, fisnik ,bujar e me një inteligjencë popullore për t’i patur zili.

** Ish ushtarak madhor*

M’ka marrë malli për nënën time

(Vijon nga faqja 10)

tobusi, një djalë i ri e i bëshëm u shkëput prej tij. Axha Refik!? Sikur deshi të sigurohej që ishte Ai dhe e ngiti lart duke e mbërthyer për mesi e përqafua fort. Nuk e kishin parë kurrë njëri-tjetrin, por e njohu për rude, si i themi ne gjaku e ndjen gjakun e vet. U bënë shumë foto. U filmuan skena nga më prekëset. Gjithçka e filmuan të ardhurit, kurse nga pala jonë asnjë foto apo filmim.

* * *

Refiku nuk ishte nga ato që e mbyllte gojën kollaj. Madje në akuzën e ngritur gjatë gjykimit të dytë e kishin etiketuar si njeri të pakorrigjueshëm. Ndoshta përsëri goja kishte provokuar një mbledhje urgjente në këndin e kuq të ish-ndërmarrjes komunale banesa, ku edhe vazhdonte të punonte. Ishte një lajmërim rrufe, me porosi të partisë. Njerëzit vinin me nxitim, e salla nuk nxë më. Syri të zinte fytyra punonjësish të degës së brendshme. Refiku e Drita ishin ulur përkrah Avni e Jashar Agolit. Me baban e tyre, Ali Maliqin (Agolli), Refiku kishte qenë në burgun e Laçit.

Ora 12-00. Duke bërtitur e lotuar futet në sallë sekretar(ja) e partisë. “Refik Pustina ! Armik i popullit. I marrsh të keqen shokut Enver dhe lotët i shkonin rrëke. Ti vihen hekurat në vend, këtu, në sallë-vazhdonte sekretarja”. U krijua një situate tejet e vështirë. Refiku nuk përmbahet. Nuk ishte mësuar me një gjuhë të tillë. “Me kë flet ti –iu drejtua sekretares së partisë. Ti e din se unë nga burgu vijë e se kam problem të rikthehem përsëri atje. Gojën nuk ma mbyll as ti dhe askush. Më arrestoni kur të doni. Nesër udhëtoj për Durrës, ndaj mund të më arrestoni edhe rrugës”. Në të vërtetë Refiku dhe Drita duhet të ishin në Durrës pasi pinin kafet e fejesës së vajzës, Aritës. ” Unë, –tregon Arita, babin dhe mamin i prita te prindërit e burrit, në Durrës. Babi mu duk i zbehtë, i shpërqëndruar. Babi nuk është mirë, -i thashë mamit. Le të mbarojmë punë. Flasim më vonë, –ma ktheu Ajo.

* * *

Refiku mbështeti proceset demokratike. U bë pjesë e ndryshimit. Shkoi edhe në vendlindjen e Tij, në Dibër të Madhe. U ç’mall me fëmijët e vëllezërve, nipër e mbesa. Mbi varrin e nënë Zurkës, lule e lot, lotë që lulet të mos thaheshin kurrë. “Ne e mendonim demokracinë më ndryshe, më të vërtetë, kurse kjo më ngjan disi e tradhtuar”, - thoshte shpesh herë. Kujdes gojën Refik, sepse përsëri (nuk jeton më) mund t’a pësosh si dikur... Kishte të “drejtë” prokurori kur thoshte se “ishe njeri i pakorrigjueshëm” (nuk vije mënd), por edhe nënë Zurka që merakosej.

(***G.Zota***)

portret

Mevlud Buci, mbledhësi i visareve popullore

Nga Prof. dr. **HAJRI SHEHU***

Në një shkrim për Çidhnën, botuar në gazetën "Rruga e Arbrit", 2013, është thënë që e folmja e Dibrës është si Ujëvarat e Niagarës në punë të fjalëve e të shprehjeve popullore, ende të panjohura për gjuhën e sotme letrare shqipe dhe përpara kësaj pasurie nuk duhet ndenjur me një shimatës. Një ndër ata bashkëpunëtorë të jashtëm të Institutit të Gjuhësisë e të Letërsisë që ka gjurmuar e mbledhur shumë fjalë e shprehje popullore nga e folmja e Dibrës është Mevlud Buci. Ai ka skedat e tij në Kartotekën kombëtare të leksikut të shqipes. Është punë dhe vepër për gjuhën tonë amtare. Kurse në Institutin e Kulturës Popullore ka fletore të tëra me krijimtari gojore popullore. Është punë dhe vepër për kulturën tonë kombëtare.

Unë i kam njohur dhe vlerësuar gjurmimet e hulumtimet e Mevlud Bucit në fushën e fjalës dhe të shprehjes popullore që në vitet '80. Në ato vite, për punën me bashkëpunëtorët e jashtëm të Institutit kam pasur në kujdestari rrethin e Dibrës, me porosi të drejtorit, profesor Androkli Kostallarit. Ai i priste e i përcillte shumë ngrohtë të gjithë bashkëpunëtorët e jashtëm të Institutit. Për materialin e parë të Mevlud Bucit më ka thirrur në zyrë. Pasi bëri vlerësim shumë të mirë për lëndën leksikore, më tha: "E ke patriot. E ke nga Lukani i Katër Grykëve të rrethit të Dibrës. Ti duhet të kesh qenë në Lukan. Duhet të jetë fshat i bukur e me tradita". I thashë si me ndrojtje se nuk kisha qenë. "Të shkosh, - më tha. Ta ecësh më këmbë gjithë Dibrën se mëson shumë nga Dibra. Po këtë Mevludin e njeh?" "Nuk e njoh, - i thashë, - por do ta njoh". "Ta njohësh e ta mbajmë afër sepse më duket djalë i formuar e me intuitë". Më pas, me Mevludin u njohëm shumë. E njohu i gjithë Instituti. E njohu vetë puna e vet.

Për dikë që mund të mos e dijë, Lukani është fshat në zonën e Katër Grykëve. Nga Mevludi e librat e tij i kam tashmë dijet për Lukanin e Katër Grykët. Nga Katër Grykët dilet në Bulqizë nga gryka e Kacnisë, në Lurë nga gryka e Vanasit, në Mat nga gryka e Murrës, në Muhurr e në Luzni nga gryka e Selishtës. Katër Grykët janë shquar gjithnjë për atdhetarizëm, trimëri, punë, mençuri, ndershmëri e çiltërsi. Por edhe për urtësitë e fjalët e odave. Sigurisht, në këto mjedise odash Mevlud Buci ka vjelë e tubuar gjithë ato fjalë e shprehje popullore. Edhe krijimtari gojore popullore. Anekdotat e alegoritë dibrane. Ndoshta, edhe subjekte letrare. Por ai ka vjelë edhe shumë më tej se Lukani e Katër Grykët.


Zyrtarisht, nga drejtoria e Institutit iu dërgua Mevludit një letër si njëfarë udhëzuesi se çfarë mund të mblidhej më tej: emërtime bimësh (sidomos bimësi pyjore), profesionalizma bujqësorë, ndërtimorë, mjeshtërish popullore etj., emërtime të njerëzve sipas dukës a vetive morale, emërtime lojërash popullore e mënyra të luajturi, njësi frazeologjike, fjalë të urta e proverba etj. Vetëm kjo letër qe profesionale e udhëzuese. Letrat e tjera – të gjitha me emrin dhe nënshkrimin e drejtorit të Institutit, akademikut Androkli Kostallari – qenë letra vlerësimi dhe falënderimi. Besoj që Mevludi i ka ruajtur ato në arkivin e vet.

Për ata që mund të mos e njohin punën e Mevlud Bucit për mbledhjen e visarit popullor edhe këto pak fjalë të miat mund të thonë shumë.

Gjurmimet e vjeljet e Mevludit nisin nga Lukani e Katër Grykët e shkojnë deri në Bllacë, Lurë e Kala të Dodës, nga Zall-Dardha në Çidhën, nga Kastrioti në Shupenzë – në të gjitha katundet e Dibrës. Përfundimi: qindra e mijëra fjalë e shprehje popullore, urime e betime, fjalë të urta e proverba, vargje këngësh popullore, anekdota etj.

Në lëndën leksikore e frazeologjike (fjalë e shprehje) të mbledhur nga Mevlud Buci nuk ka njëanshmëri, domethënë nuk ka ndodhur të mblidhej vetëm leksik konkret (ngaqë është më lehtë të mblidhet) e të lihej leksiku abstrakt. Ai nuk e ka bërë as gabimin që të sillte fjalë, thjesht se pasqyronin ndonjë dukuri fonetike. Kjo do të thotë se ai i njeh mirë edhe leksikun popullor krahinor, edhe leksikun e gjuhës letrare.

Pas botimit të dy Fjalorëve shpjegues të gjuhës shqipe (1980 e 1984), Instituti hyri në një etapë intensive të kërkimit e të mbledhjes së fjalës e të shprehjes popullore. Kjo fazë kërkonte njohje të thelluar e sistemore të leksikut – në çerdhe fjalëformuese dhe në strukturën kuptimore. Ishte


Mevlud Buci

dhe është një ndër kërkesat shkencore kryesore për mbledhjen e fjalës popullore. Mevludi e përvetësoi këtë kërkesë dhe lënda e tij vinte me çerdhe fjalëformuese dhe me strukturë të plotë kuptimore.

Shpjegimet e fjalëve kanë qenë të mjaftueshme e të plota. Kjo do të thotë se është bërë analiza kuptimore e fjalëve dhe ai nuk është kënaqur duke hedhur në skedë atë shpjegim (të pamjaftueshëm) që mund të jepte folësi. Është synuar që të zbulohej përmbajtja e fjalës duke pyetur e ripyetur, duke e riprodhuar atë në disa kontekste e duke u këshilluar me Fjalorin kombëtar të gjuhës shqipe. Kjo tregon, ndër të tjera se është synuar të njihet mirë e thellë leksiku i shqipes. Kjo vihet re sidomos në fushën e emërtimeve të bimëve, të shpendëve të egër, të kandrrave etj., të emërtimeve të veshjeve e të pjesëve të tyre etj.

Në lëndën e Mevlud Bucit është synuar fjala shqipe ose me burim e formim shqip dhe jo fjala e huaj e paintegruar në sistemin e gjuhës. Kjo, natyrisht nuk është e lehtë sepse duhen dije, duhet mprehur vëmendja, duhen njohur ndikimet e huaja etj.

Teorikisht e praktikisht është vërtetuar që edhe sot të folmet krahinore të shqipes janë një rezervë e mundshme (potenciale) për pasurimin e mëtejshëm të leksikut të gjuhës së përbashkët letrare. Këtej është edhe vlera e fjalës dhe e shprehjes popullore, pra, edhe e fjalëve dhe e shprehjeve që ka vjelë edhe Mevlud Buci. Ato mund të bëhen pronë e përbashkët kombëtare, domethënë, nga fjalë a njësi frazeologjike me vlerë letrare potenciale, mund të bëhen fjalë a njësi frazeologjike me vlerë letrare reale, kur i sjellin gjuhës së përbashkët letrare pasurim të mëtejshëm. Shih, p.sh., nga Mevlud Buci: *ciliminë* "bishtatundës"; *gilëzoj* "gudulis, giciloj"; *gilibishte* "zogj që sapo kanë dalë nga veza"; *grezde* (= gresë /?) "vesh rrushi me kokrra të rralla; fre rrushi"; *kambëcimuem* "këmbësëmbuar": *hecte kamcimuem; ndërhije* "vend me hije"; *pupës* "belbacuk"; *pupëzoj* "shtrëngoj fort diçka (barrën e kashtës" / besojmë se fjala mund të ketë edhe kuptim të figurshëm); *shushël* "lëpushkë misri; shushull"; *vesulkë* "koka që formon lulja pasi i bien petlat"; *kur të baje (= bëjë) dushki arra*; *kur të rruejnë mjekrën e krosit;* etj.

Mevlud Buci ka botuar edhe një "Fjalor me shprehje e njësi frazeologjike të Dibrës". Fjalori ka mbi 2500 njësi frazeologjike e fjalë të urta. Atëherë, pasi doli nga shtypi, kam shkruar një recension për të me vlerësime shkencore dhe nuk dua t'i përsëris ato. Ajo që dua të përveçoj tani është vlera pasuruese e këtyre njësive frazeologjike e fjalëve të urta për Fjalorin e frazeologjizmave të gjuhës shqipe. Përse? Sepse në dallim nga një këngë popullore, një anekdotë etj., a edhe nga një fjalë me kuptim konkret, njësia frazeologjike (ose siç jemi mësuar ta themi – shprehja popullore), fjala e urtë a proverbi mund të dalë vetëm në situata bisedash të gjata historish, tregimesh e rrëfimesh etj., - thënë në mënyrë alegorike – kur je në përgjim. Kësisoj, kërkimi e regjistrimi i frazeologjisë është, vërtet hulumtim shkencor. Dhe imagjinoni pastaj 2500 "përgjime" e hulumtime të tilla! Së dyti, në dallim nga fjalët popullore krahinore, të cilat gjuha e përbashkët letrare e fjalori i përpunojnë

- Gjurmimet e vjeljet e Mevludit nisin nga Lukani e Katër Grykët e shkojnë deri në Bllacë, Lurë e Kala të Dodës, nga Zall-Dardha në Çidhën, nga Kastrioti në Shupenzë – në të gjitha katundet e Dibrës. Përfundimi: qindra e mijëra fjalë e shprehje popullore, urime e betime, fjalë të urta e proverba, vargje këngësh popullore, anekdota etj.

- Mevlud Buci e ndien përgjegjësi shpirtërore mbledhjen e fjalës e të shprehjes popullore, të dijes e të urtësisë popullore, për t'ua kthyer brezave këtë pasuri të vyer të popullit të Dibrës

- Mevlud Buci ka dy medalje "Naim Frashëri", dhënë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor si drejtor shkolle e mësues novator dhe distinktivin "Mësues i dalluar", dhënë nga Ministria e Arsimit. Por Mevludit mund t'i jepej një medalje e posaçme për gjurmimin e mbledhjen e visarit popullor. Puna e tij e palodhur dhe e pandalshme është motivacioni më i spikatur.

nga pikëpamja normative, njësitë frazeologjike e fjalët e urta i marrin siç vijnë (kuptohet, me një përpunim të gjymtyrëve të tyre, nëse vijnë me shqiptim a shkrim fonetik krahinor a me morfologji krahinore). Kjo do të thotë që Mevlud Buci e ka pasuruar Fjalorin e njësive frazeologjike të gjuhës së përbashkët letrare me 2500 njësi frazeologjike e fjalë të urta. Fjalorët janë zakonisht libra referimi e jo libra leximi. Por fjalorët me njësi frazeologjike e fjalë të urta si ky i Mevlud Bucit mundet mirëfilli të lexohen me kënaqësi për përmbajtjen e tyre, për mënyrën e motivimit të tyre, për vlerësimin për këtë a për atë dukuri të realitetit etj. Jam i bindur që po ta kenë në dorë këtë fjalor shkrimtarët, do të nxitojnë ta vjelin për ta futur në skedarët e tyre të punës. Shih për shembull grupin e njësive frazeologjike që e karakterizojnë njeriun sipas vetive mendore e morale: *asht arkë me shtatë dryna dikush; nuk të lëshon krunde në thes dikush; e do pa litar e pa kandar dikush; prashit në kep; asht si mola në dollap; e fal mushkën veç për krushkën; nuk e di ku ia shkarkon mushka drutë; shkon si mushka pa samar; asht si myku në fund të hambarit; asht si miza në kërcunë; bahet ligtyrë dikush; e ka eshkën ndezë përmbrenda; rrëshqet si mushka në akull* etj.

Mevlud Buci ka qenë dhe është mësues shumë i mirë. Dhe drejtues shumë i mirë shkolle. Kaq mund t'i mjaftonte si qytetar i këtij vendi. Mirëpo, jo. Mevlud Buci e ndien përgjegjësi shpirtërore mbledhjen e fjalës e të shprehjes popullore, të dijes e të urtësisë popullore, për t'ua kthyer brezave këtë pasuri të vyer të popullit të Dibrës, - siç thotë ai në parathënien e Fjalorit frazeologjik. Ky është çelësi i suksesit të tij në këtë fushë. Sa mirë do të ishte sikur edhe mësues të tjerë, po aq të zotë sa Mevludi e me këtë shpirt si Mevludi t'u suleshin visareve popullore të Dibrës! Si dikur, shkrimtari Haki Stërmilli, në vitet '50, mësuesi Islam Vani, në vitet '60 - '70, Hilmi Kolgjegja, Naim Plaku, Xhemal Domi e në vitet '80, Ahmet Tomja, Ali Hoxha, Astrit Shahu, Enver Zeneli, Hafiz Shehu, Ramazan Ilnica, Teki Çera e shumë të tjerë dhe në ditët e sotme, Duro Ibrahimi, që mbledh etnografizmat në të folmen e Dibrës.

Gjurmimet e Mevlud Bucit i ngjajnë një visari ku mundet vetëm të marrësh. Ai vijon të gjurmojë shprehje të tjera frazeologjike në zonën e Katër Grykëve. (Me sa duket, frazeologjinë e ka shumë për zemër). Por jo vetëm shprehje frazeologjike. Edhe toponime (emra vendesh) dhe këto, me siguri do të jenë një libër tjetër i tij. Me vlerë të jashtëzakonshme gjuhësore sepse tek toponimet mund të ruhet një fjalë a një trajtë fjale e vjetër ose e vjetruar e shqipes, një kuptim i kryehershëm i një fjale - natyrisht, edhe historia e fjalës a historiku i toponimit. Ajo është një punë e vyer edhe sepse sot, me largimet e emigrimet e edhe me shuarjen e brezit të vjetër, toponimet, sidomos mikrotoponimet mund të harrohen a mund të na humbasin. Të nxitojmë edhe ne të tjerët aty ku jemi e aty ku shkojmë në Dibër a përtej Dibrës e t'i mbledhim mundësisht shtereshëm të gjitha toponimet! Mevludi na jep një shembull të madh.

Krahas gjurmimeve leksikore pothuajse në çdo fshat të Dibrës e më tej, Mevlud Buci ka gjurmuar e ka vjelë qindra fjalë, shprehje e rrëfenja të thëna tërthorazi, zakonisht me thumb a si i quan ai, të thëna alegorike, alegori. Këto do t'i përfshijë në një libër të veçantë, me titull "Qesh e qaj". Po e përgatit për shtyp. Janë rreth 500 faqe. Libri do të na njohë me alegorinë popullore dibrane. Njëherësh, me urtësinë popullore e me filozofinë popullore. Ato kanë të bëjnë me jetën dhe filozofinë e jetës, me dijen dhe vlerën e dijes, me mirënjohjen dhe fisnikërinë e njeriut, me luftën për virtytin dhe me luftën kundër vesit etj. Por, me siguri libri do të na njohë edhe me fjalë e shprehje popullore, që do të vijnë nga këto alegori e nga replikat e holla dibrane.

Populli është gjuhëkrijues. Brenda popullit e brenda gjuhëkrijimit është atëherë, sigurisht çdokush. Por Mevlud Buci veçantohet sepse ka krijuar vetë mbi 4000 aforizma (në parantezë: ka tre libra të botuar me aforizma) e domosdo nuk mund të mos ketë në to shprehje popullore a shprehje të ndërtuara sipas gjedhes (modelit) popullore. Me këtë sy mund të shihet edhe libri tjetër i tij me fabula, satira, epigrame e epitafe "Krushqia e korbit".

Kur erdhi për herë të parë në Institut, mësova se Mevludi ishte mësues plot pasion (tani di që ka plot 44 vjet punë në arsim). Por ajo që e mësova këto ditë është se tani, kur është rreth 63 vjeç, ka mbrojtur gradën për master, me "shumë mirë" për "drejtim-administrim në arsim". Një shembull tjetër për t'u ndjekur. Di që është metodist e organizator i zoti jo vetëm i klasës e i lëndës që jep, por edhe i shkollës e i punëve të shkollës. Mbi 25 vjet mësues gjuhe e letërsie dhe drejtor shkolle në vendlindje. Më pas, mësues e zëvendësdrejtor shkolle në Tiranë. Bashkëpunëtor i Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë dhe i Institutit të Kulturës Popullore. Por edhe i Radio-Tiranës, Radio-Kukësit e i rreth 25 gazetave e revistave. Ka mbi 20 libra publicistikë e letrarë. Një ndër ta është vlerësuar si libri më i mirë publicistik-fetar nga Instituti i Mendimit dhe i Qytetërimit Islam, Tiranë.

Mevlud Buci ka dy medalje "Naim Frashëri", dhënë nga Presidiumi i Kuvendit Popullor si drejtor shkolle e mësues novator dhe distinktivin "Mësues i dalluar", dhënë nga Ministria e Arsimit. Por Mevludit mund t'i jepej një medalje e posaçme për gjurmimin e mbledhjen e visarit popullor. Puna e tij e palodhur dhe e pandalshme është motivacioni më i spikatur.

* *Ish - punonjës shkencor në Institutin e Gjuhësisë dhe të Letërsisë, Tiranë*

Lexuesi, edhe në autobus, i nxjerr nga xhepi "50 Do-me-thëniet" dhe i lexon me një frymë, sepse kanë kolorit gjuhësor të figurshëm dhe të kuptueshëm.

Bota e Gafur Mukës e derdhur ne vargje



Nga **LUTFI HANKU**

Të peshosh dhe të çmosh vlerat e fjalës së dalë nga shpirti i flakëruar, të ngroh ndjenjat nga intuita e përzgjedhur artistike e autorit. Ing. Gafur Muka në librin "50 Domethënie" që, si një paralelizëm domethënës shfaqet kopertina "Para pasqyrës" e Pikassos që, në harmoni me vargjet, zbërthehet brendia e metaforave, ku...vezullojnë tingujt e ngjyrave, idetë e vargjeve të gatuara me thërrime shpirti të një intelektuali me botë krijuese.

Në dukje, ky vëllim i vogël, por me gjurmët dhe vlerat dritëronjëse si një vepër e madhe gjelbëruese, që mbajnë aromën e vjollcave të vendlindjes së autorit-Sopoti i Zerqanit, ka luajtur në 36 shkronja bukurinë e vyrtyteve me filozofinë e metaforave.

Çdo lexues mbetet i ngujuar mbi këto vargje dhe i befasuar që ky talent shpërthen mbi thjeshtësinë e mendimit poetik dhe logjikës së shtrydhur të Mukës, i dehur në botën e vet, ku dhe zbulohet jeta qysh në fillim me një pastërti sinqeriteti në koloritin poetik të frymëzimit:

„...Unë jam
Ne kërkim të vetvetes..."
Dhe vetveten e gjen tek lëvizja:
"çdo të thotë
Majtas-djathtas?
Edhe përpjekja,
Edhe çoroditja..."

Pastaj: "Nëna"...E tërheq... Mall nëne! Nuk e lëshon. I futur në botën mistike, vargëzon:

"...Pse harroj...!
...vargu
Është varg
Dhe ti nënë…
Je TI"

Nganjëherë inxhinieri poet, i "çoroditur dhe nga hijet në udhëkryq, ndjen "ndalesa". Bota e tij "i tëri mbetet në gjeometrinë e humbjes" dhe në "arkitekturën e hiçit!?". Këto ndalesa jete janë "sens i humbur". Por ai, sido, niset nga ajo që kërkon në botën e tij të përparimit e zhvillimit. Këtu zbulohet sensi i vargjeve të mesazhuara të humanizmit me ngjyrat e petaleve të jetës.

"50 Domethëniet" zbulojnë në vargje një botë morale me origjinalitet, që dallon krijuesin nga shumë personalitete të kulturës së të shkruarit. Flet vetë fjala e shpirtit dhe mençuria krijuese e mendimit të intelektualizmit. Në tërësi vargjet blerojnë vlera artistike, siç është gdhendur dashuria e fëmijëve me fjalët magjike, të ngrohta. Apo vargje portretizimi, universale për Anakreonin të ing. Mukës, që krijojnë një shtrat të vetin poetik, në të cilin provon vlerën e tij tek lexuesi për mendimet e vargëzuara, filozofike, me pretendime idealiste. Vargjet e thjeshtë freskojnë aromën e shijes tek lexuesi sa autori i drejtpeshon fjlaët që të kenë burimin shpirtëror të tij. Ato mbillen aq njerzore e te imta nga jeta, sa krijojnë përgjithësime siç krijojnë edhe gjinitë e tjera të letërsisë. Imtësia poetike e Mukës ka specifikën e vet dalluese. Përshembull vjershëron për punën që e quan "pafund hapësirë" . Popullorçe thuhet: "A mbaron puna ndonjëhere"?; apo tek "Optimizëm" që këndon domosdoshmërinë e lëvizjes:

„Ndalesa, miku im, është vetëm çast,
Lëvizja po…është ligjësi..."

Ndërsa tek "orteku", autori ndalet tek fillesa e fenomenit natyror, "pothuajse hiçi...", por një bukuri e dhimbshme. Imazhi poetik krijon aleanca mistike të befasishme në natyrë si në politikë, midis partive. Me pak vargje është dhënë bukur kjo lëvizje shumëzhurmëshme e shoqërisë sonë demokratike pluraliste. Poeti e mbyll me idenë:

„...E befta ka përmasa orteku/Mbi shpatullat e brishta të lirisë...". Kjo e vërtetë e ditës është poetizuar bukur me simbolin „ortek" të natyrës së njeriut.

> "50 Domethëniet" zbulojnë në vargje një botë morale me origjinalitet, që dallon krijuesin nga shumë personalitete të kulturës së të shkruarit. Flet vetë fjala e shpirtit dhe mençuria krijuese e mendimit të intelektualizmit. Në tërësi vargjet blerojnë vlera artistike, siç është gdhendur dashuria e fëmijëve me fjalët magjike, të ngrohta. Apo vargje portretizimi, universale për Anakreonin të ing. Mukës, që krijojnë një shtrat të vetin poetik, në të cilin provon vlerën e tij tek lexuesi për mendimet e vargëzuara, filozofike, me pretendime idealiste.

Fjala poetike aq e gdhendur poetikisht, e ushqyer me ide të thella jetësore, e frymëzuar nga bëmat e botës sonë, që autori e njeh, e idealizon për peshën e vyrtyteve dhe aftësinë për të dalluar me art mençurinë, karakterin, temperamentin dhe fisnikërinë e njeriut, të cilat autori i ka mbjellë në kopshtin e tij krijues. Prandaj bëhet interesant me origjinalitetin, larg ndikimit tematik e brumit të gatuar dhe të pjekur në furrën e mendimit por shtjelluar përmes gjykimit frymëzues, e me nota shkencore.

Veç kësaj veçorie kahja e artit të tij ka dhe erën e frymën e kohës sonë demokratike, me plot dritare për ta vizatuar këtë botë realiste, siç bën vetë Gafuri para pasqyrës së Pikassos. Shqetësimet e poetit janë njerëzuar me gojën e vargjeve të thjeshta, me impenjim të thekur artistik. Me më pak impenjim për anën teknike të vargut, do të rridhte i rimuar më bukur dhe me shije dinamizmi i kohës demokratike me gjithë dritëhijet e tranzicionit.

Simboli "thinjat" me nëntekst revolta e njeriut për mplakjen dhe dashuria e thellë për jetën shprehet nga autori me fjalën revoltë:

„Nga mbitë ju
Që unë....
të mos jem më unë..."

Edhe "thinjat" kanë "ndijime" të shijeve të Mukës. Ndaj i bën "qejfin" dashurisë dhe shkon të dëgjojë "gurgullimën e gurrave të Kaqakëve", atë copë në Atdheun të vet, në Sopotin hyjnor, ku lindi, u bë inxhinier dhe poet, ku gjelbërimi e përtërin jetën e përmallur, thashethemet e plakave, këngët e fëmijëve, bredhjen e arushave, përgjimet e ujqërve, urithëve në...gjirize etj. Sa jetësore!

"Le të shkruaj dhe unë... Fshati im i dashur..." Sa bukur!, zgjohen ndijimet e poetit për Sopotin !

Në "50 Domethënie" në formën simbolike shpjegohet vlera e pafundësisë së dijeve, me simbol folozofinë e Sokratit në rrolin e pedagogut që këshillon: Nëse din "Shumëçka... anija e Kolombit të pret..." – të pret për zbulime në shërbim të njeriut... Sejcila poezi peshon në vlerën që mbart, sepse aty bën zë ashku i krijuesit ku ndizet një grimë shpirti nga poeti. Ndaj dhe mushti del i ëmbël, frymëzues, njohës dhe edukues, ku zbulohet edhe karakteri dibran si personalitet e fisnik. Ku e merr vlerën libri? Në të janë mbjellë vyrtytet. Këto çelin metaforat përmes bukurisë së dashurisë së frymëzuar dhe kulturës artistike e shkencore të krijuesit.

Talenti lind dhe formohet me punë e vullnet të pathyeshëm. Filozofinë e "levës së Arkimedit, ku poeti gjen pikën magjike të forcës për të mbështetur levën, të lëvizë botën, cili Arkimed e mësoi poetin për ta gjetur? Ai "saktë" e përcaktoi "pozicionin". Dhe prapë Arkimedi e "kërkon" magjinë... Bravo! Sa thellë! Sa bukur! keni vargëzuar punën e vullnetshme dhe dashurinë e njeriut për shkencën, zotni poet!

Sido "pikën magjike" akoma s'e kemi gjetur. Arkimedi "kërkon". Shkenca nuk ka limit. Ndërsa poeti edhe pse i "kënaqur" lëviz rreth djallit, i këndon djallzisë së injorancës... "Arritje çmendurie...". Pastaj në vargje ringjallet "Babai". Iku. E kishte marrë "Marsi i vrarë". "Dua të ketë mbetur tek unë"... Një dhimbje e gjatë, e përhershme, që e thotë autori me një fjalë si një hiperbolë e zvogëluar. Sa bukur i këndon dashurisë prindërore! Të emocionon thjeshtësia e figurave, e gjetjes së metaforës dhe lakonizmi që thellon kuptimin e fjalës poetike. Këto veçori e prezantojnë me dinjitet autorin, edhe pse ai shfaqet me një grusht fjalësh të ndërtuara si fabula. Copëzat poetike etikomorale, të gatuara nga mençuria dibrane dhe etnia e gjenezës së kulturës estetike, e sjell në këtë libër me ego krenarie dhe me afsh dashurie e origjinalitet talentuari Gafur Muka.

Ja:
"Të mori '97...
Mars i vështirë....
Dua të ketë mbetur gjithmonë tek unë
Babai".
Prandaj edhe mistikisht kërkon zbulimin:
"Dua të jem Kolomb"... Ai pyet:"Ku jam unë? Unë dua ta di këtë...".

Ai e përjeton botën e korrupsionit dhe... "shpresoj në ditëvdekjen e pjellës tënde";

Interesant është poeti tek poezia „Referencë", ku evokon sjelljen e Anakreonit... „kur fokët i lanë shëndenë" dhe vajzat i venë përpara pasqyrën që "të vështrohet një thërrime..." dhe të bindet që „në kokë s'i ka mbetur asnjë qime... Dhe...

„Ç'të bënte ditëziu prushak?
U shkreh paksa në vaj
Dhe tha mendueshëm zëpak
Eh...Pasqyra s'ka faj.

Sa bukur, Gafur Muka! Sa njerzor, i thellë për zërin e vlerave moralizuese të poetëve të pavdekshëm që poetikisht i transmeton njeriut se dashuria nuk plaket, nuk ka as moshë.

Me intuitën e kërkimit të imtësirave poeti arrin tek përgjithësimi artistik. Kjo veçori e rrallë shton vlerën e vëllimit të vargjeve. Këtë na e diktojnë copat frymëzuese si: "Bulqiza" ku "nuk ndalet ora e varfërisë… ishe dhe mbete hirushe,… pa një djalë mbreti… Bulqizë". Në këto vargje Muka identifikohet si zerqanas, me një sharm shpirtëror të virgjër. Ai e gdhend fjalën deri sa ta veshë, për paradë, me shijen e metaforës pa vrapuar se "po ikën treni". Prandaj lexuesi, edhe në autobus, i nxjerr nga xhepi "50 Do-me-thëniet" dhe i lexon me një frymë, sepse kanë kolorit gjuhësor të figurshëm dhe të kuptueshëm. Poeti është kthyer në Sopot të Zerqanit. Atje, nga Qafë-Bualli tek ura e Çerenecit ndjen tik-takun e zemrës në metaforat e kërkuara për "shkëmbin me xixa" që "ka dhe Bulqizë!"

Pastaj i bën zë "shprese", ku poeti mesazhon: "Koha të shërojë plagë"… të tranzicionit demokratik. A duhet vonesë? Koha kërkon shpejtësinë e lëvizjes, jo trenin e ngarkuar me indiferencë, sepse duam "Integrim" (?!), jo politikë në korrnizë gjeomterike…

Në tempullin parlamentar derdhen argumente e sharje që "vetëm fjala bën hatanë dhe kalanë". Pastaj „kafja qetëson mendjet e lodhura.

Nga fundi autori e mbyll me paqe:
„Si të doni:
Edhe majtas, edhe djathtas..."

Vargjet bukurinë dhe vlerën e fitojnë me ritmin dinamik dhe rimën, që poeti i ka kursyer pak. Sido vargjet poetike të gozhdojnë dhe të rrëmbejnë me imazhet e përkëdheljet realiste edhe pse autori ndalet paksa në udhëkryqet poetike. Vëllimi mbyllet me një risi sentencash proverbiale filizofike, ku nuk duhet që në të ardhmen të divorcohet me logjikën e metaforave me ngacmim të thellë logjik, të papërsëritshme.

Fruti i talentit shpërthyes të Ing. Gafur Muka, i mbyll " 50 Do-me-thëniet" me një prozë metaforike mirënjohje ndaj mësuesit Fil:…Jam përpjekur të jem vetvetja…Të vij pranë lexuesit "si një mysafyr i këndshëm", i botës sonë shqiptare derdhur në vargje…

simpozium

Simpoziumi shkencor u organizua nga
Instituti për hulumtime shkencore "Max Van Der Stoel"-UEJL.

Reka dhe shqiptarët e Rekës së Epërme

Nga **EDIBE SELIMI-OSMANI**

Instituti për hulumtime shkencore " Max Van Der Stoel"-UEJL, bordi organizativ dhe shkencor i konferencës prof.dr.Nasir Selimi-kryetar i konferencës, Prof. Dr. Ali Pajaziti - nënkryetar i konferencës, Prof.Dr. Xhelil Rufati – koordinator i konferencës dhe Mr. sc. Rasim Zuferi-kordinator i konferencës, "Nipërit rekalinj", ku në hotelin e fshatit Leunovë, buzë liqenit të Mavrovës, organizuan në mënyrë të shkëlqyeshme Koferencën Shkencore "Reka dhe Shqiptarët e Rekës së Epërme".

Për të parën herë ligjërues universitar, dhe ekspert të lëmijve të ndryshme të ardhur nga qytete të ndryshme të Maqedonisë, Shqipërisë, Kosovës si dhe studiues nga diaspora shqiptare, u mbajt simpozium madhor që i dhanë kësaj krahine karakter shkencor duke i shpalosur sfidat shumëdimensionale të një populli autokton shqiptar i cili përballoi luftëra, tortura, djegie të fshatrave, shpërngulje me dhunë e tjerë.

Secili nga ligjëruesit dhanë mbi të mundshmen duke i paraqitur kumtesat në mënyrë sa më reale të argumentuara me literaturë të bujshme. Për një krahinë që meriton më shumë se kaq u përfshinë në Librin e Abstrakteve 49 kumtesa të grumbulluara si guriçka lumi që hodhën dritë dhe lanë gjurmë shkencore mbi këtë krahinë e lënë pas dore.

Ishte e arsyeshme të trajtohen tema shumëdimensionale për një zonë të harruar, rrallëherë e përmendur, që ndër shekuj këta anë janë përballuar me sfida të shumta, nga ata të natyrës religjioze, politike, historike, kulturore, ekonomike e tjera.

Për hir të asaj që nuk duam t'i lodhim lexuesit, shkëputëm disa nga kumtesat edhe pse e kemi vështirë t'i veçojmë nga njëra tjetra.

ARKEOLOGJI

Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe arkeologia e njohur Prof. Dr. Exhlale Dobruna-Salihu, në abstrakt bën fjalë për motivet e diellit në monumentet mbivarrore të Dardanisë e më gjerë të territorit ilir dhe trashëgiminë e tyre në monumentet e këtij karakteri deri në ditët e sotme-kryqet e varreve në disa treva të banuara me shqiptarë siç është edhe Reka e Epërme. Paraqitja e këtyre motiveve në këto monumente ka përmbajtje religjioze. Duke u takuar kulteve astrale, në mbarë territorin ilir që herë kishin të bënin me vazhdimësinë e ekzistencës së shpirtit në mes yjeve dhe, rrjedhimisht, besimin në jetën e amshueshme. Prania e tyre në kryqet e varreve te shqiptarët, flet se kemi të bëjmë me një vazhdimësi të lidhjes së ngushtë me kultin e pasvdekjes që prej kohëve të lashta midis ilirëve dhe shqiptarëve.

Ishin historianët ata që shpalosën të kaluarën e hidhur dhe plagët e pashëruara të kësaj krahine. - Prof. Dr. Fejzulla Shabani - me studimin Rezistenca e shqiptarëve të Rekës kundër pushtuesit serb 1912-1913. Kjo kumtesë ka të bëjë me rezistencën e shqiptarëve të Rekës kundër pushtimit serb dhe formimi i grupeve të armatosura në luftën për shpalljen e pavarësisë, në luftërat ballkanike si dhe masakrat që janë bërë ndaj shqiptarëve të këtyre trevave. Burrat e kësaj ane kanë qenë pjesë përbërëse e kryengritjes së Shtatorit 1913, ku shqiptarët e Rekës kanë qenë shumë aktivë në mbrojtje të kauzës.

-Ndër pjesëmarrësit zgjoi interes edhe kumtesa Betejat e mëdha mbi Mavrovë dhe pjesëmarrja e shqiptarëve të Rrekës e prof. dr. Vebi Xhemailit. Punimi në fjalë flet për kontributin e çmuar të shqiptarëve të Rekës në mbrojtjen e tokave amtare kundër forcave serbe që gjithnjë kanë atakuar viset shqiptare me tërë arsenalin, duke lënë pas vetes shkrumb e hi e duke ndikuar kështu në zhvendosjen e popullatës vendore.

- Kryengritja e viteve 1913 në Dibër dhe krimet në Rekën e Epërme, - Prof. Dr. Liman Rushiti, duke u mbështetur në të dhënat autentike arkivale nga literatura e shfletuar por dhe nga shtypi i kohës shkruan si reagim ndaj veprimeve të shumta kriminale me elemente të gjenocidit shpërtheu edhe Kryengritja e vitit 1913 në Dibër e rrethinë. Gjatë dhe pas kësaj kryengritjeje u bënë krime të llahtarshme

Për të parën herë ligjërues universitar, dhe ekspert të lëmijve të ndryshme të ardhur nga qytete të ndryshme të Maqedonisë, Shqipërisë, Kosovës si dhe studiues nga diaspora shqiptare, u mbajt simpozium madhor që i dhanë kësaj krahine karakter shkencor duke i shpalosur sfidat shumëdimensionale të një populli autokton shqiptar i cili përballoi luftëra, tortura, djegie të fshatrave, shpërngulje me dhunë e tjerë.
Ishte e arsyeshme të trajtohen tema shumëdimensionale për një zonë të harruar, rrallëherë e përmendur, që ndër shekuj këta anë janë përballuar me sfida të shumta, nga ata të natyrës religjioze, politike, historike, kulturore, ekonomike e tjera.

edhe në viset e Rekës së Epërme, me të cilat u dëmtuan shumë shqiptarët, gjë që tronditi Evropën dhe botën.

- Prof. Dr. Qerim Lita dhe kumtesa Shqiptarët ortodoksë në Rekë të Epërme dhe shkombëtarizimi i tyre gjatë shekullit XX-të. Përpjekjet e serbëve, bullgarëve më vonë të jugosllavëve, përkatësisht maqedonasve zhdukjen e gjurmëve shqiptare në viset e robëruara të Shqipërisë. Ata në planin e tyre kanë përdorur metoda të ndryshme represive siç ishin: rrahje dhe vrasje masive, burgosje plaçkitje, shkombëtarizim të dhunshëm e tjerë.

- Nga Instituti Albanologjik i Prishtinës mr. sc. Sejdi M.Gashi, Reka e Epërme përballë fenomenit të asimilimit gjuhësor e kombëtar. Janë të hartuara me dhjetëra e dhjetëra punime monografike të gënjeshtërta të autorëve të huaj (serb e maqedonas por edhe të tjerë si autorë rusë) për popullatën shqiptare të zonës së Rekës së Epërme në Maqedoni. Të krijohet përshtypja se Rekalinjtë janë popullatë serbomaqedonase që nën trysninë e shqiptarëve të Maqedonisë kanë filluar të shqiptarizohen, e në fakt, në bazë të burimeve historike e gjuhësore, dihet tashmë botërisht, është krejt e kundërta e këtyre propagandave serbe.

- Komuniteti fetar që më tepër ka qenë i ndikuar nga nacionalizmi është ai i kishës ortodokse në përgjithësi. Edhe sot nuk mund të flitet për kishën ortodokse se ajo të mos jetë e nacionalizuar, si për shembull Kisha Ortodokse Greke, Kisha Ortodokse Serbe, Kisha Ortodokse Ruse e tjerë. Në mungesë të një kishe ortodokse shqiptare dhe nga pamundësia që ata t' i bashkëngjiten Kishës Ortodokse Autoqefale Shqiptare detyrimisht kanë qenë nën presionin e sllavizmit. Gjegjësisht të maqedonizmit të tyre. Është shkrimi i kumtesës të Prof. Dr. Qani Nesimit –Ortodoksët shqiptarë të Rekës së Epërme viktimë e nacionalizmit të kishës ortodokse.

-Nga Instituti Albanologjik i Prishtinës Prof. Dr. Emin Kabashi në abstraktin Zhvendosja-forma më e lartë e gjenocidit etnik, ndër të tjerat shkruan se Reka e Epërme është vetëm një pjesë e gjeografisë shqiptare, e cila është zhbërë nga pushtues të ndryshëm, ideologjikë e fetarë, krejt njësoj, si dhe është zhbërë në periudha të ndryshme kohore. Në këtë mënyrë Reka e Epërme si atëherë edhe pas Luftës së Dytë Botërore u gjet nën peshën e rëndë të zgjedhjes në mes të ekzistencës me përkatësi kombëtare apo asaj fetare, gjë që as njëra as tjetra nuk u shpëtua nga asimilimi.

-Është edhe profesor i Universitetit të Sofjes, Anton Pançev - Shqiptarët e Rekës në fillim të shekullit XX sipas burimeve bullgare. Ky autor na njofton se shqiptarët kanë qenë në kontakt të ngushtë me bullgarët. Për këtë arsye ka shumë dëshmi dhe dokumente bullgare të cilat tregojnë për gjendjen politike, ekonomike, sociale, në trojet lindore të shqiptarëve. Kumtesa në fjalë do të përfshije përbërjen etnike dhe numrin e popullsisë, humbjet njerëzore në luftëra dhe trazira, metodat e asimilimit të pushtuesit serb dhe çështje të tjera.

- Punimi i Prof. Dr. Kadusi Lama - Kohë të reja me politika të vjetra, zgjon interes në mesin e studiuesve ku autori zbardhë raportin midis Maqedonisë dhe sllavëve që janë bërë banorë të saj, dokumenton me plot arsye se hapësirat që quhen Maqedoni janë treva shqiptare. Politika sllave në Maqedoni, konsiderohet politikë e vjetër në kohë të reja.

-Arkitektura në fshatrat e Rekës së Epërme e doc. dr. Enis Jakupit, e prezantuar edhe me foto terreni. Arkitektura e këtij rajoni zë një vend të rëndësishëm dhe bëjnë pjesë në të gjitha llojet e ndërtimit. Ajo bën pjesë në grupin e banesave të krahinës së Dibrës.

EKONOMI

- Një kumtesë tjetër e Afërdita Dervishit - Defaktorizmi njerëzor dhe ekonomik i Rekës së Epërme, ku kjo studiuese shpalosi historinë e vërtetë të shqiptarëve të Rekës së Epërme. Luftërat ballkanike, pushtuesit dhe grabitqarët e kanë plaçkitur dhe shkretuar këtë trevë. Një faktor tjetër që e ndihmon këtë është edhe papunësia e zhvillimit ekonomik. Të dhënat flasin se në Rekën e Epërme ka ndodhur zbrazja e rajonit nga faktori njeri dhe rrëmbimi i të mirave ekonomike. Pushtuesi dhe grabitqarët e kanë plaçkitur dhe shkretuar këtë trevë. Golgota shqiptare është bërë e plotë vetëm kur është rrënuar ekonomia e rajoneve shqiptare siç është rasti me Rekën e Epërme.

-Nga lëmi i ekonomisë ishte edhe kumtesa Nxitja e zhvillimit të turizmit alternativ-shans i mirë për rivitalizimin e Rekës së Epërme të prof. dr. Nasir Selimit, ndër të tjerat, tha se potencial ekonomik ka ky rajon për një rivalizim që është i domosdoshëm nëse nuk duam që ky rajon definitivisht të kalojë në histori. Boshatisja e këtyre vendeve ka ardhur pikërisht nga lënia pas dore e zhvillimit të ekonomisë e sidomos të zhvillimit të blegtorisë, bujqësisë dhe pylltarisë. Në vazhdim të artikullit do të jepen sugjerime për një shan të ri dhe zhvillim ekonomik të këtyre viseve.

- Resurset natyrore dhe ndikimi i tyre në zhvillimin ekonomik të Rekës së Epërme që e prezantoi mr. sc. Rasim Zuferi, ku tha se në mesin e faktorëve të shumtë ekonomik, studimet kanë identifikuar rolin e burimeve natyrore në zhvillimin ekonomik të një vendi. Gjithë kjo pasuri që posedon kjo hapësirë e Rekës së Epërme, nuk ka ndikuar në zhvillimin ekonomik të këtij regjioni. Përkundrazi neglizhimi dhe lënia pas anash nga sistemi i dikurshëm ka shkaktuar që ky regjion - fshatrat të zbrazen, banorët të marrin rrugën e kurbetit ose të shpërngulen nëpër qytetet e afërta për një jetë më të mirë.

GJUHËSI

-Prof.dr.Mustafa Ibrahimi, hodhi dritë mbi disa dokumente dhe dorëshkrime të gjetura në Maqedoni të shkruara në të folmen shqipe të Rekës, por me alfabet cirilik. I shkruar në një gurë varri i vitit 1889. Një dorëshkrim tjetër në gjuhën shqipe i gjetur në fshatin Niçpur të Rekës së Epërme, i shkruar nga Joan (Gjon) Serafimi në të folmen shqipe të Rekës me alfabet cirilik. Me këto gjetje autori dëshmon se popullata shqiptare me fe ortodokse, në shkrimet, meshat dhe varrezat ka përdorur gjuhën shqipe, por me alfabet cirilik.

-Në aspektin gjuhësorë, Prof. Dr. Asllan Hamiti, ndër të tjerat tha se Reka e Epërme, paraqet një të folme shqipe shumëruajtëse në fushën e fonetikës e të leksikut. Por, nga ana tjetër ajo ka kryer disa zhvillime gjuhësore që nuk i gjejmë në asnjë të folme tjetër përreth e më gjerë.

- Edhe doc. Ajtene Qamili, në abstrakt, shënon se kjo e folme shqipe, dallon mjaft nga të folmet e tjera përreth si në intervalin e fonemave bashkëtingëllore, ashtu edhe në ndërtimin e tyre, veçmas në bashkëtingëlloret mesgjuhore.

FOLKLOR

-Edhe kumtesa e Prof. Dr. Vebi Bexhetit, Elemente etnografike në poetikën e vargut popullor të krahinës së Rekës, tha se do të shqyrtojmë disa vargje të këngëve popullore të kësaj ane me theks të veçantë në elementin etnografik të veshjes.

- Zejna Halimi me kumtesën Vajet në rajonin e Rekës. Vajet sot janë në zhdukje e sipër si te popullata e religjionit islam ashtu edhe te popullata shqiptare e regjionit ortodoks. Rekalinjtë në formë vajtuese i këndojnë jetës së vështirë të banorëve të kësaj zone, varfërisë, kurbetit, ndarjes nga familja e tjerë.

LETËRSI

-Reka dhe emri i Josif Bagerit në letrat shqipe të dr. Rovena Vata, ku hidhet dritë mbi letrat shqipe. Citon:"...Gjithnjë po orvatem me qenë një mburonjës i rreptë për të drejtat e këtij kombi..."Janë fjalët e patriotit tonë rilindas Josif Bageri i cili jetën dhe veprën e tij e vuri në shërbim të popullit shqiptar.Bageri u quajt edhe "përlindja e kombit".

-Reka shqiptare, krahas të gjitha vuajtjeve, ka dhënë njerëz të kulturës e të arsimit, si gjyshi i Migjenit, rilindësi Josif Bageri, Llazër Siljani, Villdan Faiku, Hasan Leka, Jusi Mani, Pop Davidi, Danul Metaj, Olimbia Sava, Hoxhë Tanusha e shumë të tjerë kështu e filloi kumtesën prof.dr.Avzi Mustafa- Anastas Albanski (Arnaudov/ mësuesi nga Reka e Epërme, i cili sipas J.Erebarës, numëronte 130 nxënës shqiptar. Ishte punë e madhe e mësuesit Anastas, sepse ai dinte si t'i bindë shqiptarët, sidomos ata të cilët e kishin ngatërruar problemin e fesë me çështjen e kombësisë.

-Josif Bageri, një ndër themeluesit aktiv të shoqërisë "Dëshira", botoi gazetën e parë në gjuhën shqipe në Bullgari" Drita", bëri përpjekje për hapjen e arsimit dhe shkollave shqipe në Shqipëri.Në fund të shtatorit të vitit 1908 u nis prej Sofjes në vendlindje për të hapur shkollë shqipe në fshatin e lindjes në Rekë, ishin fjalët e kumtesës së Mc.Rezehana Hysa, e cila u ndjek me mjaft vëmendje nga pjesëmarrësit e Konferencës.

-Qendra e Studimeve Albanologjike, Tiranë, doktorant Rudina Llazari-Kontributi i Edibe Selimit Osmanit në proklamimin e vlerave të kulturës të Rekë.Reka e ka gjënë më të shenjtë, të ndihmon të shtosh njohuritë për këtë trevë shqiptare me një histori të tillë, që e bën atë të shndrisë si margaritar në historinë e kombit shqiptar.Janë disa mijëra faqe që të sjellin në skenar gjithçka për kulturën materiale popullore të Rekës, veshjet, punimet, rite e zakone, të shkruara të lidhura ngushtë me prejardhjen ilire të kësaj zone. Janë me dhjetëra studime të Osmanit, nëpërmjet një "enciklopedie" siç është e gjithë veprimtaria shkencore e një kërkueseje pasionante të një intelektualeje të urtë që pa asnjë dyshim duhet cilësuar si eruditë e mbi të gjitha të një patrioteje të zjarrtë që Rekën e ka gjënë më të shenjtë.

LËMI I KULTURËS

-Dr.prof. Zeqirja Neziri, -Ritet e lindjes, martesës e të vdekjes në Shtirovicë të Rekës së Epërme sipas përshkrimit të Doda-Nopçës (1914). Si vepër e parë e studimeve etnografike të shqiptarëve të Rekës së Epërme të hartuar nën përkujdesjen e Franc Nopçës. Sjell të dhëna mjaft interesante e të rëndësishme edhe për ritet e lindjes së fëmijëve, të martesës dhe të vdekjes.Ky studim sjell ndihmesë të madhe historike për krahinën e Karshiakës si dhe për studime etnografike të shqiptarëve të Maqedonisë dhe për studimet mbarëkombëtare.

-Kumtesa e Jolanda Trumzës-Vështrim krahasues mbi festën e Pashkëve dhe Ujit të Bekuar :Rasti i Rekës së Epërme dhe Shkodrës. Në abstraktin e saj zgjon interes studimi për shtrirjen gjeografike të festave. Festa e Pashkëve dhe e Ujit të Bekuar janë festa mbarë botërore.

(Vijon në faqen 20)

120 vjet shkollë shqipe

Nga **ZABIT LLESHI**

Homeshi është fshati më i madh i Grykës së Vogël me një histori të pasur atdhetarie. Haki Stërmilli, në veprën e tij "Dibra në prag të historisë", na bën me dije se në Homesh më 14 mars 1894, nën kujdesin e Mersim Demës, u hap shkolla shqipe me mësues Shaqir Dacin shok i Said Najdenit dhe një njeri me kulturë të madhe në Dibër 1. Si një dallëndyshe e shkollave shqipe, pas asaj të Dibrës së Madhe (1888), shkolla e Homeshit do të plotësonte ëndërrat e kahershme të malësorëve dibranë pas kaq shumë kërkesash ndaj perandorisë Osmane për hapjen e shkollave shqipe. Naum Veqilharxhi e Kostandin Kristoforidhi në vitet 40 – 70 të shekullit të XIX u shquan për veprimtari në ndihmë të shkollës shqipe me abetaret e tyre. "Është dokumentuar se abetarja e Kostandin Kristoforidhit e botuar në Stamboll më 1867 në dialektin Gegë dhe alfabetin latin, u përhap dhe mirëprit në Dibër." 2 Pas viteve 1850 gjejmë përpjekje për mësimin e shqipes në fshehtësi e me shumë kujdes nga autoritetet osmane.

Lidhja shqiptare e Prizrenit hapi rrugë e mundësi të reja për mësimin shqip. Për këtë Abdyl Frashëri gjeti në Dibër një terren të favorshëm dhe opinion të guximshëm. Tush Lleshi e Mane Dema bashkë me shumë patriot të tjerë mbështetën Abdyl Frashërin për hapjen e shkollave shqipe kundër mendimeve konservatore që u shfaqën në takimet e tij me banorët e Grykës së Vogël. Botimi i Abetares së Sami Frashërit dhe gazetës Drita (1884) afruan hapjen e shkollës së parë shqipe në Korçë (mars 1887).

Shkolla shqipe në Dibër (1888) përbënte një fitore të madhe për patriotët Dibranë. Ishte kurorëzimi me sukses i një lufte e përpjekjesh shumëvjeçare të rilindasve dibranë në ballë të të cilëve qëndronte Said Najdeni. Ata nxitën pasionin e dëshirën për mësimin e gjuhës jo vetëm në qytet por edhe në malësi. Atje siguronhej konspiracioni, ruajtja, strehimi dhe lëvizja e atdhetarëve, librave e gazetave shqipe nga ndjekjet, ndëshkimet, persekutimet e burgosjet që organizonte qeveria Osmane për mësuesit patriotë si Said Najdeni, Shaqir Daci, Shyqyri Qoku, Dervish Hima etj.

Nga ëndërra për shkollë tani shtrohej kërkesa për leje, bisedime, nuk mungonin edhe ultimatumet nga mitingjet e mëdha popullore për shkolla në gjuhën shqipe. Rilindasit Dibranë u hodhën në sulm për të fituar kohën e humbur. Krahas veprimtarive për mësimin e shqipes në vënde të fshehta, dyqane, bodrume e deri në qelitë e burgjeve u gjetën rrugë e shtigje te reja për pajisjen me Abetare e gazeta shqip që vinin nga Manastiri, Stambolli, Selaniku, Sofja e Bukureshti. Dibra e Madhe ishte stacioni tjetër i shpërndarjes në malësi, Homesh, Zogje, Bllacë, Zerqan, Luzni, Selishtë, Mat e deri në Tiranë. Me gjithë pengesat e mëdha që haseshin herë pas here, në shumë mbledhjë të patriotëve dibranë, më 1902 në Peshkopi e Dibër të Madhe u morën vendime për hapjen e shkollave në Homesh, Zogje, Luzni, Çidhën, Muhurr e Zerqan.3 Asnjëherë qeveria Osmane nuk lejoi hapjen e tyre. Nëpërmjet të dërguarve të saj në sanxhakun e Dibrës burgosi e internoi Said Najdenin, Dervish Himën, Sherif Lëngun, Shaqir Dacin, Shaqir Jegenin etj. Pushkë, Abetare e flamur do t'i kërkonte Mersim Dema Aqif Pashë Elbasanit në vigjilje të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë. Pavarësi nëpërmjet pushkës, liri për mësimin e gjuhës shqipe, flamur për mbrojtjen e fitoreve.

Luftrat e herë pas hershme ishin arsyet e justifikuara për mbylljen e shkollave. Problemet që dolën për zgjidhjen e çështjes Maqedonase 1902 – 1905, Revolucioni Xhonturk (1908), kryengritjet 1910 – 1912, Lufta Ballkanike, pushtimi Serb 1912 – 1913 ku në rend të ditës shtrohej problemi i egzistencës së trojeve shqiptare, për shkolla as që bëhej fjalë.

Pushtimi Austro-Hungarez i Dibrës, krijoi disa lehtësi dhe u dha leje për hapjen e shkollave shqipe. Pengesat ishin të mëdha, mungonin lokalet, mësuesit, programet mësimore etj. Prefekti i Dibrës, Ali Fehmiu, i kërkonte Drejtorisë së Arsimit Shkodër, në Janar 1917, që të hapen shkolla shqipe në Çidhën, Luzni, Muhërr, Zogje, Homesh, Gjoricë e Zerqan por u rihap vetëm ajo e Homeshit (maj 1917) me mësues Qemal Turkeshin (Drita).4 Për hapjen e shkollave të tjera u zgjodh Komisioni Krahinor i Arsimit me kryetar Loke Demën.5

Hapja e internatit më 1929 gjallëroi jetën në Homesh e në fshatrat përreth, shumë nxënës mund të vazhdonin shkollën pas fillores, pati edhe te tjerë me bursë. Posaçërisht u ngrit nje konvikt (3 Tetor 1929 u bë inagurimi) me personel shërbimi. Mësuesit e internatit kishin mbaruar Normalen e Elbasanit që nga Drejtori i parë Ramazan Sefedini, Abdurahim Ostreni (Ostren), Ismet Haxhimusai (Elbasan), Kov Bibaj, Isa Cavolli (Shkodër), Adem Sharofi, Remzi Pustina, Sami Gonxhe (Dibër e Madhe). Vështirësitë ekonomike që kalonte vendi ynë u reflektuan në ritmet e ngadalta për hapjen e shkollave në fshatrat e tjera, pamundësia e ndërtimit të shkollave të reja dhe në mbyllja e Internatit 1933. Ishte një kthim mbrapa që do të duheshin vite për ta riparuar. Pas mbylljes së Internatit u hap një klasë femërorë me mësues Julia Radi, Nazmie Pasholli, Aqif Pasholli e Telat Jakupi (1932 – 1939), duke kaluar në shkollat e përziera (djem – vajza).

Në vitet e Luftës Nacional Çlirimtare, Qemal Agolli (1941) dhe Hidër Manjani (1943) dolën partizanë ndonëse si mësues punuan Adem Shehu e Hamit Manjani. Nga bangat e kësaj shkolle dolën nxënës që vazhduan shkollat në Austri Hysni Dema, në Itali Isuf Dema, Hamdi Dema, Rifat Manjani, në Rusi Skënder Manjani, në Bullgari Riza Manjani; Në Golem të Kavajës shkollën Harri Fultz e mbaruan Bilal Manjani e Demir Leka ndërsa Pedagogjiken e Peshkopisë Skënder Sharku, Shemsi, Xhelal, Riza, Xhetan Manjani, Mendu, Latif, Luan, Irfan, Remzi, Avni Dema, Bajram Hoxha etj. Mundesi të reja u krijuan edhe vajzave për vazhdimin e shkollës si Shirete Sharku, Kadrie Xhehluli, Antoneta Nikës (Shkodër), Setkie Strazimiri të cilat patën fatin të punonin në shkollën e Homeshit. Deri në vitet 1960 ndihmë dhanë mësuesit edhe në luftën kundër analfabetizmit si Hysni Kania, Konstandin Fereçka, Kadri Dumani, Hamit Sinani, Osman Sinani, Selim Hoxha, Aleksandër Nika (Shkodër) etj.

Në vitet 1960 – 1990 në shkollë u realizuan reformat ë mëdha si masivizimi i shkollës, zgjerimi i arsimit 7 – 8 vjeçar dhe ai i mesëm, arsimi i detyrueshëm 8 vjeçar bashkë me rritjen e pregatitjen e kuadrit e të infrastrukturës që padyshim pati arritje. Nxënësit e Homeshit vazhdojnë në shkollën 8 vjeçare e të mesme në Shupenzë. Universitarë të rinj si Ahmet Tomja,



Në foto: Mësuesit e shkollës fillore, Homesh 2014 (Foto R.Manjani)

Esat Manjani, Fatmir Beqiri, Shefqet Rusi, Petrit Turja, Medi Dema, Xhevat Jella, Vladimir Dema, Mustafa Manjani, Luan Manjani, Bafjar Rusi e të tjerë punuan nga Lura në Gollobordë, nga Viçishti në Gjuras e Bulqizë.

Në Homesh mbyllën karrierën si mësuese të ardhura Flutura Dema, Reme Hoxha, Lule Manjani bashkë me Imer Manjanin duke i lënë stafetën Lavdie, Latif, Zemrije, Kujtime Manjanit, Dallëndyshe Demës etj.

Në vitet 1990 – 2014 për shakak të mërgimit (largimit të shumë familjeve nga zonat rurale në zonat urbane) u ul ndjeshëm numri i nxënësve por jo vrulli dhe dinamizmi i mësuesve të rinj që zëvendësuan gardën e vjetër si Adriatik Dema, Fatma Rexhepi, Lafturie Lleshi e Oljana Qoku.

Shkolla e Homeshit mbushi 120 vjet, katër breza. 60 mësues kanë punuar në 92 vjet të funksionimit të saj, 28 vjet ndërprerje. Ata janë pjesë e asaj plejade arsimtarësh që hodhën themelet e pedagogjisë shqiptare duke krijuar një përvojë të madhe në fushën e mësimit dhe edukimit. Mësues si Hidër, Hamit, Riza, Shemsi, Lutfi, Lavdie, Zemrije Manjani, Mendu, Latif, Avni, Flutura, Medi Dema, Kadrie Xheleshi, Reme Hoxha etj janë pjesë e elitës së arsimit tonë kombëtar. Nga kjo shkollë kanë dalë 82 mësues, 32 oficerë karriere, 8 inxhinierë, 9 agronomë, 4 juristë, 7 mjekë, 2 gazetarë. Senator në Qeverinë e Lushnjes Dine Dema, deputet Shaqir Dema; Oficerë Hysni Dema, Isuf Dema, Hamdi Dema, Latif e Skënder Manjani; Drejtor të Minierave e Gjeologjisë Jashar Dema, Fatmir Beqiri, Esat Manjani; Drejtues të pushtetit dhe ekonomisë Demir Leka (Kryetar i Komitetit Ekzekutiv të Rrethit), Hamdie Beqiri (Prefekte), Xhevat Jella, Xhevat Manjani, Vladimir Dema, Bardhyl Manjani, Arshi Beqiri, Bilal Halili, Bilat Manjani; Drejtues të Arsimit Shemsi Manjani, Osman Turja, Bedrije Manjani, Naim Turja, Bajram Hoxha, Mendu e Avni Dema, Xhelal e Riza Manjani etj; Drejtues Kulture Petrit Turja, Shefqet Rusi, Demir Rusi; Drejtues të partive politike në rrethet Peshkopi e Bulqizë si Baftjar Rusi (PS), Latif Dema (PD), Vladimir Dema (PS) e Mustafa Manjani (PK). Dhjetra kuadro të mesme mbaruan shkollat në Bulqizë e në të gjithë Republikën. Shumë të rinj vazhdojnë në degë të ndryshme të universiteteve të vendit tonë. Nxënës i Homeshit ka qënë edhe piktori i popullit Nexhmedin Zajmi. Me origjinë nga Homeshi janë edhe Ylli Manjani nënkryetar (LSI), Mirela Manjani kampione e Shqipërisë në hedhjen e shtizës dhe Teuta Manjani kampione kombëtare e shahut për femra.

120 vjetori i shkollës së Homeshit është festë për popullin, mësuesit e nxënësit e kësaj shkolle, por jo vetëm për ata. Populli i Grykës së Vogël ka të drejtë të krenohet sepse kjo shkollë ka një kontribut jo vetëm lokal por edhe kombëtar. Ajo ka rrezatuar jo vetëm në fshatrat e shkollat përreth por nxënësit e saj kanë dhënë eksperiencë e kulturë në të gjithë Shqipërinë kudo ku ato kanë punuar e jetuar. Mirënjohje e respekt për të gjithë mësuesit që kanë punuar e punojnë në Homesh. Le të shërbejë kjo ngjarje si një nxitje për fitore të tjera edhe më të mëdha.

1. *Haki Stërmilli "Dibra në prag të histories", fq 41*
2. *Hysni Myzyri "Dibra dhe etnokultura", fq 81, V II*
3. *Kristo Frashëri "Historia e Dibrës", fq 318*
4. *AQSH, Kutia 4, Dosja 2, 1918*
5. *Posta e Shqipërisë 1918 9 Fruer (Shkurt) Nr. 18, fq 4.*

Reka dhe shqiptarët e Rekës së Epërme

(Vijon nga faqja 19)

Megjithëse Shkodra dhe Reka e Epërme janë dy vende me një shtrirje gjeografike jo kufitare, por për të dy besimet si katolike ashtu edhe ortodokse, qendra e këtyre dy festave përmban të njëjtin motiv.Aspekti kohor i këtyre dy festave shpalos qartë të përbashkëtat se si Pashkët dhe Dita e Ujit të Bekuar kremtohen në Rekën e Epërme dhe në Shkodër.

-Rreth një motivi ornamental me prapavijë solare dhe antropomorfe në veshjen popullore të Patiçka Rekës-dr.prof. Izaim Murtezani, i cili tha se motivet e kësaj veshjeje popullore veçohen mes tjerash edhe me një strukturë të pasur përmbajtësore në të cilat janë shtresuar motive mitike një ndër to zgjoi kureshtje motivi i diellit, si i tillë dielli sipas botëkuptimit arkaik është në lëvizje.Në të vërtet bartësja e këtij ornamenti-nusja e re – mëton .

-Edibe Selimi-Osmani dhe kumtesa Tipi i veshjes me dy mbështjellak edhe në Rekën e Epërme, si ilustrim u prezantuan edhe me 28 fotografi që ishin pjesë të veshjes dhe foto të bëra në teren.

Femrat rëndom në veshjen e tyre përdorin mbështjellak që vendasit e kësaj krahine e quajnë peshtelkë-a.Sot ky kostum kombëtar si veshje e përditshme bartet rallëherë nga brezi i moshuar.Por, secila nënë bën çmos që nusja apo vajza e saj të ketë një komplet të veshjes së Rekës. Sepse është nata e peshtelkave kur ata do ta veshin, një natë para se ta marrin nusen ose një natë para dasmës synetit. Është traditë që femra pa dallim moshe të vishen me këtë veshje prandaj kjo natë e dasmës quhet nata e peshtelkave ose veshja me peshtelka. Duke parë analogjinë e kësaj pjese të veshjes me atë të viseve tjera shqiptare dhe ballkanike; si në formën poashtu edhe në motivin dhe koloritin e saj duke mos lënë anësh edhe elementet arkaike vëmë në dukje që kjo veshje është nga më të vjetrat e këtyre viseve. Është më se e domosdoshme që kjo zonë të përfshihet në grupin e veshjeve të grave me dy futa si veshja e lashtë ballkanike, pasi deri sot është anashkaluar nga etnologët.

Gjithashtu është më se e domosdoshme që nga kjo Konferencë Shkencore që i dedikohet Rekës së Epërme, të mbështetet kërkesa për hapja e Muzeut Etnografik në Gostivar dhe Tetovë, ku do të bëhet grumbullimi i eksponateve të kulturës materiale të trevave shqiptare në Maqedoni.

PËRFUNDIM

Sa herë që jam në kontakt me brezin e moshuar të kësaj krahine, ata shpalosin kujtimet e hidhura ngjarje të kohës së kaluar, histori tw vërteta që ngjasojnë me kumtesat e këtyre studiuesve. Jam e detyruar me keqardhje të them se nuk shkruaj histori, por e vjeli kulturën shpirtërore folklorin dhe atë materiale të popullit në fjalë. Më duket sikur ua ndaloj shprehjen e mendimit, i lëndoj, nuk i përfilli dhe pikërisht ky ishte Simpoziumi që të kaluarën e këtij populli e ndriçoi.

arsim

Me rastin e 100 vjetorit të Shkollës së Parë shqipe në Peshkopi

Shkolla që hapi rrugët e mëdha të jetës

Nga **ABDURAHIM ASHIKU***

Unë kam lindur në katundin Zdojan (Brezhdan) në maj të vitit 1941. Shkollën fillore e fillova në Brezhdan në vitin 1948 dhe e mbarova katër vjet më vonë, në verë të vitit 1952.

Mësuesi im i klasës së parë ka qenë Bajram Çipuri nga lagjja Çipure e Tominit.

Në klasë të dytë dhe të tretë kam pas mësues Mikel Garulin nga Përmeti dhe Nigjare Velçanin nga Berati me të cilët, shumë vite më vonë, në vitin 1993, pata një letërkëmbim shumë emocionues.

Në klasën e katërt kam pas mësues Mark Kalajn nga Shkodra...

Brezhdani në atë kohë ishte një katund i madh, me treqind shtëpi, me njerëz që ishin të lidhur shumë pas tokës dhe pas blegtorisë. Kjo lidhje trashëgohej nga brezi në brez. Ishte e vetmja lidhje që i mbante në jetë, në këmbë. Shkollimi i fëmijëve fillonte e mbaronte në ciklin katërvjeçar të shkollës fillore, në të mësuarit shkrim, këndim e aritmetikë. Shkolla unike e më vonë shtatëvjeçare, ndonëse vetëm një orë rrugë në këmbë ishte "larg". Bujqësisë dhe blegtorisë i duheshin krah pune...

Megjithëse katund i madh, Oxhak i njerës prej familjeve më në zë të kohës, Karasanëve, shkolla e parë shqipe në Brezhdan do të hapej vetëm në dekadën e tretë të shekullit XX, në vitin 1930... "me 14 nxënës...në një dhomë në shtëpinë e Ferik Karasanit..." për të ardhur "në vitin 1935 u ndërtua një lokal me një dhomë për mësim dhe një për mësuesin...(Jashar Kaci, "Arsimi në Brezhdan dje dhe sot" gazeta "Ushtima e maleve nëntor 1969"

Në vitin 1934 Brezhdani kishte dy klasa me 41 nxënës në mes të cilëve 4 vajza. Mësues ishte Hysen Dylgjeri (AQSH F 428, v.1934, D 214 f. 4,5)

Fillimi i viteve pesëdhjetë do të shënonte "largimet" e para nga fshati, udhëtimin e djemve (e theksoj djemve) brezhdanas drejt dijeve.

Babai im trashëgoi pak tokë, aq sa të siguronim bukën, groshën e bulmetin, ushqimin tradicional të kohës, dhe veshmbathje modeste.

Arsyeja që një ditë shtatori 1952 të përmbysja me këmbë, si të përmbysja një botë të tërë, safën prej llamarine të mbushur me ujë me urimin e Defes, nënës sime, "Rruga pambuk e gjurët kuleç" lidhej mbi të gjitha me dashurinë e hershme të babait për shkollën.

Babai, Hajredin Ashiku, nuk ishte ulur asnjë minutë në bankën e shkollës. Ai dinte të shkruante dhe lexonte. Shkrimi i tij ishte i bukur dhe me një korrektësi gjuhësore për kohën për tu pasur zili. Babai shkrim e këndim kishte mësuar, siç thoshte, "vjedhurazi", në fund të viteve '30, kur ishte ushtar.

Një shtatori i vitit 1952 do të thurte për mua zinxhirin e shkollimit nga njeri vit në tjetrin, shkollim që zyrtarisht do të mbaronte në shkurt të vitit 1966 me mbarimin e shkollës së lartë. Më ngjan se jam i pari djalë me arsim të lartë të plotë në Brezhdan-Zdojan...

Në vitin 1952 nga Brezhdani nisëm mësimet në shkollën shtatëvjeçare të Peshkopisë unë dhe Islam Sefullai. Para nesh vazhdonte klasën e gjashtë Abdulla Hakorja të cilin, pasi e mbaroi në vitin 1953 klasën e gjashtë, e morën mësues. E çuditshme për kohën e sotshme por në kushtet kur parullë kombëtare ishte "Bukë dhe kulturë për popullin" kjo ishte zgjidhja më e mundshme...



SHËNIME HISTORIKE

Këtu më duhet ta pres pak "sfratin" e rrjedhës së kujtimeve në shkollën shtatëvjeçare të Peshkopisë për tu bërë vend disa shënimeve në "Bllokun e gazetarit" dhe kërkimeve të mia ku kërshëria për të kaluarën e shkollës dhe kulturës në Dibër rritet e vazhdon të rritet...

Dibra nga koha e Paraluftës së Dytë Botërore trashëgoi 32 shkolla fillore me 1280 nxënës e 62 mësues. Në vitin shkollor 1958-1959 Dibra kishte 162 shkolla (143 fillore dhe 19 shtatëvjeçare me 9.491 nxënës dhe 279 mësues). Në vitin 1980 kishte 178 shkolla (106 fillore dhe 72 tetëvjeçare me 28.706 nxënës dhe 1244 mësues).

Viti 1947 shënoi hapjen e shkollës së parë të mesme në Dibër, Shkollën Pedagogjike.

Viti 1959 shënoi hapjen e shkollës së parë të mesme profesionale, Teknikumit Bujqësor.

Viti 1962 shënoi hapjen e të parës shkollë të mesme të përgjithshme, Gjimnazi-Peshkopi.

Në vitin 1980 Dibra kishte 14 shkolla të mesme me shkëputje nga puna me 1961 nxënës dhe 139 mësues dhe 19 shkolla të mesme pa shkëputje nga puna me gjithsej 2419 nxënës. I përcolla këto të dhëna të pjesshme për të treguar se shkolla shqipe në Dibër, ashtu si shkolla shqipe në Shqipëri, u ngrit dhe eci përpara mbi bazën e vullnetit të shkallës sipërore të mësuesve që në jetë mësuan nxënësit duke mësuar vetë.

Shkolla shqipe në Peshkopi, sipas të shënimeve të mia në "Bllokun e gazetarit", qershor 1974, është hapur në të njëjtën kohë me shkollën shqipe në Trebisht. Ajo kishte një mësues dhe 18 nxënës. Mësuesi i parë ishte Haki Sharofi. Tre vjet më vonë (1917) ajo kishte 30 nxënës. Në vitin 1925 kishte 85 nxënës, në vitin 1935 kishte 115 nxënës, në vitin 1943 kishte 137 nxënës dhe në vitin 1943-1944 kishte 103 nxënës. (nga "Blloku i gazetarit")

Në vitin 1934 Peshkopia kishte shkollë fillore veçmas për djem e veçmas për vajza.

Sipas studimeve të mia në shkollën fillore mashkullore kishte 3 mësues me 109 nxënës të ndarë në pesë klasa me përkatësisht 30 nxënës në klasën e parë, 33 në klasën e dytë, 21 në klasën e tretë, 13 në klasën e katërt dhe 12 në klasën e pestë.

Shkolla femërore e Peshkopisë kishte dy mësuese me 66 nxënëse përkatësisht 30 nxënës në klasën e parë, 17 në klasën e dytë, 11 në klasën e tretë, 5 në klasën e katërt dhe 3 në klasën e pestë. (AQSH, F 428, V. 1934 D 215 f. 2,3,4,5,6,7,8,9,10,11,12,13,14,17 studiuar nga A. Ashiku)

Në këtë dokument përcillen emra të cilët bënë epokë në zhvillimin e arsimit në Dibër si Selim Alliu si kryemësues në Trebisht, Vahid Kormaku në Steblevë, Hysejn Dylgjeri në Brezhdan, Fetah Ajdini drejtor në shkollën fillore Zerqan, dhe Adem Shehu mësues në Grevë .(AQSH-po aty)

Në vitin 1925 shkolla mashkullore e qytetit të Peshkopisë kishte 140 nxënës me mësues Sami Gonxhe.

Në një pasqyrë prej një faqe me titull "Lista e arsimtarëve të qarkut Dibrës" me firmë të zëvendësdrejtorit të Internatit "Dibra" Ferid Jegeni dhe vulë të Internatit ku shkruhet: "Drejtorija e Internatit "Dibra" Peshkopi" jepen të dhëna për Internatin "Dibra" si dhe shkollat e katundeve Maqellarë, Trojak, Luzni, Zerqan, Homesh, Ostren i Madh, Borovë, Trebisht, Ostren i Vogël, dhe Okshtun. Në këtë dokument jepen edhe emrat e mësuesve: Sami Gonxhe në Peshkopi, Abas Fetahu në Maqellarë, Abdulla Çanka në Trojak, Shaban Ostreni në Luzni, Qamil Shehi në Zerqan, Qemal Drita në Homesh, Hamid Muça në Ostrenin e Madh, Vahid Kormaku në Borovë, Ibrahim Tërshana në Trebisht, Shaban Jusufi në Ostrenin e Vogël dhe Osman Muglica në Okshtun.

Një hapësirë e gjerë për arsimimin e vajzave dhe djemve dibranë u krijua pas Luftës Antifashiste Nacional Çlirimtare.

"Në ditën e parë shkollore pas çlirimit të Shqipërisë, shkruan gazeta "Bashkimi" më 5 nëntor 1946, në qarkun e Peshkopisë kanë funksionuar 56 shkolla fillore me 62 mësues dhe me 2783 nxënës , nga të cilët 2000 ishin djem dhe 783 vajza"

"Në vitin shkollor 1945-1946 në qarkun e Peshkopisë kishte 67 shkolla me 84 mësues dhe 3993 nxënës nga të cilët 2993 ishin djem dhe 1000 ishin vajza" (Po aty)

"Sivjet në këtë qark hapen 107 shkolla, nga të cilat 77 janë dimërore dhe 30 verore. Këto shkolla frekuentohen nga 7000 nxënës prej të cilëve 4000 meshkuj e 3000 femra dhe do të kenë 158 arsimtar" (Po aty)

Krahas me arsimin fillor në këtë qark po merr një hov edhe zhvillimi i arsimit të mesëm. Shkolla unike që u hap për të parën herë vjet në qytetin e Peshkopisë me një klasë, sivjet bëhet me dy klasa. Një shkollë unike tjetër hapet së shpejti në Nënprefekturën e Zerqanit..." (Po aty)

Pranë shkollës unike të Peshkopisë hapet për të parën herë këto ditë një konvikt me 60 vende... (Po aty)

Në gazetën "Bashkimi" 2 qershor 1946 krahas njoftimit se "Në nënprefekturën e qendrës hapen 16 shkolla fillore dhe 1 shkollë unike" shkruhet edhe që "Ngrihen 58 kurse kundër analfabetizmit me 875 nxënës dhe tre stacione shkollore. Japin mësim 37 mësues" Shkruhet se "I gjithë populli ka bërë 19.288 orë punë vullnetare në sektorin e arsimit, duke i kursyer pushtetit 90.400 franga shqiptare"

Për të zhvilluar arsimin dhe kulturën në këtë kohë gratë dhuruan edhe kujtime të çmuara të jetës së tyre. Në gazetën "Bashkimi" shkruhet se Safije Baholli dhuroi një palë vathë floriri kurse Mereme Shehu një myhyr floriri. "

"Bashkimi" shkruan më 12 korrik 1946 se "Populli i Peshkopisë u shpall garë gjithë prefekturave të Shqipërisë" me pikë të parë "Ngritja e 37 shkollave fillore".

Gazeta "Rinia" të 10 prillit 1946 (Nr 151) shkruan për " 210 orë punë vullnetare" nga ana e të rinjve "për grumbullimin e gurëve për ngritjen e kinemasë". Shkruan gjithashtu edhe për "formimin e njësitit të punës...për ngritjen e shkollës...nga të rinjtë e Katundit të Ri"

SHKOLLA TETVJEÇARE "DEMIR GASHI"

Shkolla 7-vjeçare e Peshkopisë që u pagëzua me emrin e dëshmorit Demir Gashi u ngrit dhe vazhdon të qëndrojë në të njëjtat themele ku është edhe sot. Ndërtesa është ngritur në vitin 1949. Ajo kishte drejtim veri-jug, të njëjtin drejtim që ka edhe sot trupi kryesor i saj. Ishte me dy kate me portë hyrjeje në qendër, me një sallon poshtë e një sallon lart të lidhur me shkallë me kthesë. Në fund të korridorit, nga ana e jugut, ishte një klasë e madhe e cila përdorej edhe si sallë për mbledhje të përgjithshme si dhe për festimet e kohës. Aty kam filluar dhe mbaruar klasën e pestë. Ngjitur me të ishte një klasë tjetër, klasa V-B. Më tej vazhdonin klasat e gjashta dhe të shtata. Drejtoria dhe këshilli pedagogjik i shkollës ishin në krahë të djathtë në një mjedis me dritare të ngushta, ndryshe nga dritaret e tjera të klasave.

Më vonë, me rritjen e qytetit dhe të numrit të nxënësve shkollës iu shtuan mjedise të reja në të dy krahët me drejtim lindjen.

Rritja e mëtejshme e numrit të nxënësve shtroi nevojën e ngritjes së një shkolle të re tashmë 8-vjeçare. Shkolla u ndërtua në Dobrovë, atje ku është edhe sot.

Shkolla, në të gjitha klasat dhe në korridore kishte instalime elektrike. Peshkopia asokohe merrte dritë elektrike nga një termocentral me dy motorë ndërtuar në vitin 1947 i vendosur aty ku së fundi ka qenë drejtoria e ndërmarrjes elektrike të rrethit. Merrte dritë edhe nga hidrocentrali i Kallaveres ndërtuar në vitin 1951.

Shkolla nga ana veriore ndahej me një mur pas të cilit ishte një bahçe shumë e bukur, Bahçja e Faikut, siç e quanin me emrin e pronarit, njëkohësisht projektues e zbatues i asaj që do ta quaja pa mëdyshje një mrekulli prej ku sythat e mollëve, dardhave, kumbullave, qershive etj. ishin për shumë vite baza kryesore për shartimet dhe krijimet e blloqeve frutore të njohura të Dibrës.

Shkolla nga ana jugore ndahej me ara të mbjella me misër, grurë, perime, jonxhë e bimë të tjera bujqësore. Peshkopia në ato vite ishte një qytet jeta e të cilit bazohej mbi bujqësinë dhe blegtorinë. Ajo pak tregti dhe ato pak dyqane të vegjël artizanati ishin përqendruar poshtë, në krahun e djathtë të rrjedhës së përroit në rrethin e gjerë ku të enjtet zhvillohej pazari fshatar i prodhimeve bujqësore dhe blegtorale. Pazari i bagëtive ishte në anën tjetër të urës, në krahun e majtë, në hapësirën nga përroi tek rruga automobilistike e deri tek bulkallarët. Poshtë, në anën tjetër të urës, pak para këmbësores së rrëpirët për në Dobrovë ishte një barakë e vogël ku shitej vajguri. Shitës ishte një njeri i urtë, një njeri që të priste dhe të përcillte me fjalë të ngrohtë, një njeri që nuk të hante kurrë në "kandar". Njerëzit e njihnin dhe e thërrisnin Gazi njeriun e mirë Shaqir Shehu. E solla në kujtesë sepse vajguri asokohe ishte i vetmi burim drite mbi flaka kandilësh e llambash, duke mënjanuar pishën shekullore në tërë Dibrën e kohës.

Nga Brezhdani vija në këmbë në shoqëri të Islamit dhe të nëpunësve e punëtorëve që çdo mëngjes vinin në Peshkopi. Rruga në ditë vjeshte me shi e dimër ishte e vështirë. Baltat e rrugës kryesore ishin të pakalueshme për këmbët tona mbathur me opinga lope. Shpesh i largoheshim rrugës duke ecur nëpër mejet, në rrugën që e quanim "Pas Rashnapoje" ose nëpër përroin e Pilafe.

(Vijon numrin e ardhshëm)

** Gazetar, ish nxënës i Shkollës Shtatëvjeçare të Peshkopisë në vitet 1952-1954*

Shënime për librin me poezi të Lindita Dodës: "Jeta krejtësisht si e pafaj / Na ka gëlltitur me zgjedhjen e saj"

Engjëjt lënë gjurmë

Nga **ILMI DERVISHI**

Pas botimit të vëllimeve poetike "Engjëjt lënë gjurmë" dhe "Përtej retinës" të poetes nga qyteti i Burrelit, Lindita Doda prezantohet para lexuesve me prozë dhe veçanërisht me tregime. Në konkursin letrar të organizuar nga Ars-Klub "Beqir Musliu" Gjilan "Flaka e Janarit" për vitin 2014 mes shumë krijuesve u vlerësua me çmimin e dytë për tregimin "Pesha e Jetës". Pak ditë më vonë pikërisht më 17 shkurt 2014 në virgjile të 6-vjetorit të shpalljes së Pavarësisë së Republikës së Kosovës, poetja Lindita Doda shkoi në shtëpinë e heroit Nuhi Berisha shoqëruar nga deputeti i Kuvendit të Kosovës, zoti Ahmet Isufi njëri nga organizatorët e këtij manifestimi shkrimtarin, Sabit Rustemi dhe krijues nga Kosova Shuki Bajrami dhe i dhuroi familjes Rexhep Berisha në shenjë simbolike këtë çmim.

"Çmimet i takojnë heronjve" tha poetja Lindita Doda – Bacës Rexhë gjatë pritjes së ngrohtë vëllazërore që u bë në këtë familje.

Botë e çuditshme, bota e poetve, dhe një nga këto është dhe poetja Lindita Doda me poezinë "Bota ime" me "Ëndrrën, dhimbjen e përditshmërinë" te dashuria krijimi, ideja. Poetja që: "Ura malli... çdo natë ngrej" të poezia "Mall". Që kthehet nga prushi i një zjarri të dikurshëm, që di të kërkojë falje dhe të rikthehet "Kështu do të dua prapë duke i thënë lamtumirë trishtimit".

Art, jetë, bukuri, i tillë është libri "Engjëjt lënë gjurmë" në të gjitha poezitë, lexuesi "gëzon" shijet e tij artistike duke lexuar poezi të një niveli të lartë artistik. Një poezi që buron së brendshmi me një lëndë të parë, jetën, gëzimet dhe hidhërimet e saj. Në faqet e këtij libri gjen poezi "vullkan" siç gjen poezi si "Pushi i lehtë në krahët e fluturave" me lirika të bukura dhe me drithërimat në shpirt, me dëshira e vizione fisnike.

Filozofia dhe ngritja në art e fabulës përmes poezisë "Zgjedhjet e jetës" është dhënë bukur me dy vargje:

"Jeta krejtësisht si e pafaj
Na ka gëlltitur me zgjedhjen e saj", - por edhe në poezitë "Mbrëmje", "Ti ike", apo "Një këngë pa zë", mbajnë brenda tyre jo vetëm shijen e mirë të leximit, por edhe mesazhin dhe emocione të shumta të shkruara me përgjegjësinë e të shkruarit bukur e me frymëzim.

Mes poezive shpesh ke vështirë të zgjedhësh më të bukurën ku tek secile do të gjesh fabulën, gjetje filozofike dhe poetike. Me fjalë pak e shumë mendim si te poezia "Pagjumësia"

"Dhe në errësirë
Tavanit ja zbulova të gjithë vijat..."

Te poezia "Zemrës" që siç thotë poetja, përpara se të dëgjosh fjalët më parë mund t'i ndalësh valët, ndërsa në poezinë "Puthja pezull" autorja jep mesazhin e dhimbjes nga ndarja e një dashurie, atëherë kur "Loti puthjen do ma marrë". Poezia "Gjethe vjeshte", "Horizont|, "Loti", "Udha e shpirtit" janë poezi të realizuara artistikisht me një këndvështrim origjinal ku herë herë uni poetik shkrihet me unin artistik në një unifikim me mendimin filozofik për dashurinë e ndarjet, dhimbjen që nga fundi zemërimit nxjerr lotë deri te Engjëjt fëmijët e saj si drita nga merr forcë dhe kënaqësi për të jetuar dhe për të shkruar bukur.

Kështu erdhi Lindita në poezinë e bukur shqipe, dhe sot me vëllimin e saj "Ëngjëjt lënë gjurmë", ajo duket një poete e sprovuar dhe e vërtetë.



Në foto: Lindita Doda me bacën Rexhë



Lindita Doda është një nga ato poeteshat e reja që të surprizon me melodinë e vargut, me thellësinë e mendimit, me dashurinë që buron e rrjedh në gjithë faqet e këtij vëllimi - shkruan redaktori i librit Sevim Arbana. Dhe vërtet është një prurje e re për lexuesin dhe poezinë e sotme, por ka dhe poezi që duhej të tregohej më e kujdesshme me metrikën e vargut, muzikalitetin e poezisë si te poezia "Ndjesi në ditlindje" apo "Edhe sot".

"Zgjas dorën
ty të prek".
Fillon poezia "Pamundësi" dhe
"Zgjas dorën drejt saj
Ta prek.

Të pakapshmen natë". Mbaron poezia "Mbrëmje". Për mendimin tim nëse këto dy poezi do ishin bashkë, do ulnin numrin e faqeve por jo vlerat e librit.

I uroj suksese poetes në krijimtarinë e saj.

(vijon nga faqja 12)

Martesat dibrane **më të famshme**

të shekullit të XV . Këto lidhje i përmend edhe kushëriri i parë i Donika Kastriotit dhe bashkëkohësi i Skënderbeut princi Gjon Muzaka në librin "Memoranda" që shkroi në Napoli më 1510, ku ndodhej i mërguar. "... Gjon Kastrioti i ati i Zot Skënderbeut, pati për grua Zonjën Vojsava Tribalda, me të cilën bëri 4 djem e 5 vajza. I pari u quajt Reposh, i dyti Stanish, i treti Kostandin dhe i katërti Gjergj. Reposhi i lartpërmenduri ishte njeri fetar dhe shkoi në Malin e Sinait, u bë murg e ashtu vdiq. Bija e parë, Zonja Maria u bë grua e Zot Cernojeviçit, e dyta Zonja Jella u bë grua e Gjon Muzakës, Zonja Angjelina qe martuar me Zot Vladan Arianit Komnenin, e katërta Zonja Vlajka qe martuar me Zot Balshën, e pesta Zonja Mamica qe martuar me Zot Muzak Topinë. Prej Zonjës Angjelinë dhe prej të përmendurit Zot Vladan Komnenit, u lind Muzak Komneni, i thirrur nga populli, që ishte nip i Skënderbeut. Prej tjetrës, motrës së katërt, Zonjës Vlajka të martuar me Zot Balshën, u lindën Gjon e Gojko Balsha. E pesta Zonja Mamica u bë grua e Muzak Topisë, por që Zot Skënderbeu e ndau nga gruaja e parë që quhej Zanfina ose ndryshe Suina Muzaka dhe i dha zonjën Mamicë, të motrën . Në martesat e përfaqësuesve të fisnikëve feudalë nuk kishin rëndësi mosha, intelekti, formimi kulturor, paraqitja e jashmtme, ose gjëndja shëndetësore e bashkëshortëve të ardhshëm. Funksioni i parë i lidhjeve të tilla martesore ishte ai politik, i cili do të forconte pozitat e familjeve që lidheshin në këto krushqi . Kjo duket qartë tek martesa e Skënderbeut me Donika Komnenin e cila ishte 23vjet më e vogël se i shoqi. Kur u martuan më 23 prill 1451, Donika ishte 23 vjeç, ndërsa Skënderbeu 46. Por, ndërkohë,"martesa e të bijës me Gjergj Kastriotin (nga Dibra M.H) ishte një nga sukseset e politikës së Gjegj Arianitit, i cili pas kësaj ngjarje shpejtoi të nënshkruante në qershor 1451: Traktatin e aleancës me Alfonsin e V-të të Napolit ku të dy palët kanë rënë në ujdi që qysh nga Berati duke përfshirë Greqi e Myzeqe deri tek një lumë që quhet Devoll (Seman), t'i jepen madhërisë së tij (Alfonsit) dhe vendi përtej Devollit t'i jepet Arianitit", të cilin e kishte poseduar edhe herë të tjera .

Këto krushqi lehtësuan veprimtarinë politike të Skënderbeut për integrimin sa më të plotë të viseve shqiptare nën pushtetin qendror të tij, por shkaktuan edhe pakënaqësi në radhët e këtyre familjeve kishte individë të pakënaqur nga forcimi i Skënderbeut. Kështu p.sh. në vitin 1455 Muzak Topia ankohej për mosmarrëveshjet që kishte me kunatin e vet, Skënderbeun . Të tilla raste ishin ato të Mosi Golemit dhe të nipërit e Skënderbeut si: Gjergj Stres Balsha, Hamza Kastriotit, Gjon dhe Gojko Balshës etj. Pra, përveç fuqizimit në formë aleance sillnin edhe konflikte interesash, për shkak të pretendimeve mbi zotërimet Brenda krushqive. Praktika e dhënies së feudeve në formë paje gjatë martesave që vazhdoi në shekujt XVI-XV, u shoqërua edhe me konflikte, të cilat kunati i Skënderbeut Gjon Muzaka, i përshkruan kështu: "...Zoti Skënderbeu qe i mençur dhe trim, i prirur për të bërë mirë dhe qe një Zot i madh ndër të gjithë pararendësit e tij, por pasi u bë kapiten i përgjithshëm i zotërve të Shqipërisë, e që në pak kohë synoi të zotëronte gjithë vendin, vuri në pranga Zot Gjonin dhe Zot Gojkon e Balshajve, mbajti në burg dhe u mori principatën e tyre, që shtrihej midis Krujës dhe Lezhës e që thirrej vendi i Misisë. I mori Moisi Komnenit (Moisiut të Dibrës) Principatën e tij, e cila ishte në Dibër. Ky Moisi ishte njeri me zemër e trim dhe duke mos mundur ta durojë një dhunë të tillë u arratis tek Sulltani. Dhe mbasi vdiq im atë na mori edhe neve Tomonishten domethënë Myzeqenë e Vogël dhe kështu bëri edhe me zotërit e tjerë të krahinave të Komit dhe të Randisës .

Ambicia për pushtet, për poste dhe grada vuri përballë njëri-tjetrit për jetë a vdekje edhe tri nga familjet më të fuqishme të periudhës midis dy luftërave botërore; Ndreu (Sllovë), Kaloshi (Çidhën) dhe Hoxha (Muhurr). Nga kjo luftë për pushtet,Elez Isufi, udhëheqësi legjendar i dibranëve në kryengritjet antiturke të 1912-ës dhe ato 9-vjeçare serbe, u plagos për vdekje më 16 dhjetor 1924 në betejën e Peshkopisë, teksa mbronte Qeverinë e Fan Nolit. Nga plagët e marra ai vdiq më 29 dhjetor, duke luftuar me nipin e tij, Suf Xhelilin, i cili u vra në këtë betejë. Të dy luftonin përkrah forcave qeveritare për të mos lejuar futjen e Ahmet Zogut në Shqipëri nga ana e Dibrës. Përkrah Ahmet Zogut, luftuan edhe dy dhëndurët e Elez Isufit, Dine Hoxha dhe Murat Kaloshi. Pasi u vranë me pabesi Elez Isufi, Sufë Xhelili e 5 të tjerë, Zogu e fitoi luftën dhe i shoqëruar nga paria dibrane hyri triumfalisht në Tiranë, duke marrë pushtetin dhe duke u kurorëzuar më pas Mbreti i shqiptarëve. Dhëndurët e Elezit u shpërblyen me grada e poste, ndërsa Elezi mbeti në përjetësi të historisë dibrane dhe asaj mbarë shqiptare .

Krushqitë martesore midis familjeve të feudale dibrane, vazhduan edhe pas vdekjes së Skënderbeut.Turqia pasi pushtoi Dibrën, disa prej familjeve që i shërbyen i shpërbleu me poste të larta drejtuese që në atë kohë quheshin"oxhaqe".Oxhaqet u pajisën edhe me një ushtri kundër kryengritësve, ndërkohë 9-Malet e Dibrës u riorganizuan si njësi administrative qeverisëse dhe si formacione luftarake kundër ekspeditave e reformave të ashpra që ndërmori Perandoria Osmane. Në Dibër u krijuan 4 oxhaqe: Hoxholli në Dibër të Madhe dhe Xhilaga (Deshat-Sohodoll), Hysen Agolli (Dohoshisht) dhe Karahasani (Brezhdan) në Dibër të Poshtme. Çidhna dhe të gjithë fshatrat në jug të Peshkopisë deri në Qenok bënin pjesë në semtin e oxhakut të Agollit. Xhilaga kishte semt Ujë e m'Ujën (Sllovën), Reçin dhe Dradhën, kurse Karahasani kishte Luzninë, Muhurrin, Katër-Grykët dhe fshatrat nga Përroi i Peshkopisë deri në Koben. Hoxholli kishte gjithë Dibrën e Madhe (Dibra e Epër). Krahas oxhaqeve, vepronin në Shqipëri edhe dy pashallëqe të mëdha: i Bushatllinjve në Shkodër dhe i Ali Pashë Tepelenës me qendër Janinën. Edhe këto pashallarë dhe sundues lokalëe qendror, ashtu si princat dhe fisnikët shqiptarë në mesjetë, pozitat e tyre, ishin përpjekur t'i forconin përmes përmes krushqive. Hoxholli i Dibrës së Madhe e kishte marrë gruan te Kryeziu i Kosovës, familja më e fuqishme në atë kohë. "Hoxholli, si oxhaku i parë i Dibrës së Madhe nuk ka qëndruar i vetëm, por ka krijuar lidhje si me shqiptarët në trojet e tyre amtare në Maqedoni, ashtu edhe me ata të Dibrës së Vogël (të Poshtme)-shkruan prof. dr. Arian Kadiu."Zakonisht, këto lidhje bëheshin nëpërmjet martesave që ishin të preferuara nga secila palë, se i thoshte populli "merr eshi-eshin e vet"- Pra dera e mirë merrte e jepte në derë të mirë, sipas qytetit e fshatit ku ata banonin. Kështu Sadik Pashë Hoxholli kishte marrë për grua vajzën e Reshit Bej Toptanit të Ohrit. Reshit beu ishte i biri i Abdullah Bej Toptanit, që vetë ishte martuar me vajzën e Xheladin Beut të Ohrit nga familja fisnike e Gropajve, ndërkohë që djali i tij i madh, Haxhiu, ishte martuar me vajzën e Karamahmut Pashës, vezirit të Shkodrës Lidhjen me Dibrën e Poshtme e kishte vendosur përmes Isuf Bej Hysenagollit të Dohoshishtit, të cilit i kishte dhënë për grua vajzën e vet, kurse tjetrër e kishte martuar tek bejlerët e Podës së Kolonjës për të cilët ka këngë. Kur vdiq Sadik Pasha, atëherë Isuf Hysenagolli duke marrë gruan e dytë e Krahasanët, u forcuan edhe më tepër dhe mbeti si një forcë e konsiderueshme . Lidhje të tilla, vazhduan edhe gjatë periudhës feudo-borgjeze nga shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë më 1912 deri më 29 Nëntor 1944, kur Shqipëria u çlirua nga nazifashistët. Tre familjet më të mëdha dhe më me zë në Dibër në të Poshtme; Kaloshët në Çidhën, Ndretë në Sllovë dhe Hoxhët në Muhurr, ishin në krushqi midis tyre. Agai i Sllovës Elez Isufi, ishte dhëndërr tek Dine Hoxha e Murat Kaloshi, që ishin figurat më me influencë në Dibër dhe në Shqipëri në atë kohë. Martesa të tilla, janë bërë edhe gjatë regjimit komunist, ku Enver Hoxha zgjodhi për grua, Nexhmije Xhuglinin, një nga familjet më më me influencë në Dibër të Madhe, ndërkohë pasardhësi i tij Ramiz Alia, u martua me mbesën e Hoxhës. Gjatë periudhës së tranzicionit shqiptar (1990-1914), sikur u shuan paksa lidhjet brendallojit, megjithatë ka një tendencë krushqie ndërmjet familjeve me pushtet dhe para.

PRISHJA E MARTESAVE, TRAGJEDI PËR PARINË DIBRANE

Martesa nuk kanë shërbyer vetëm si element forcimi midis familjeve të mëdha feudo-borgjeze shqiptare, por në mjaft raste ka shkaktuar, urrejtje, luftëra

(Vijon në faqen 23)

homazh

Nëna e dhjetë dashurive



Nga **LUTFI HANKU**

Dielli zbriti kreshtave të Korabit dhe pushoi krahëve të Mustafajt. Sakaq zëri i trembur i qarjes së një fëmije u dëgjua tek Gjonët.

- Cucë bre, cucë qenka! – u dëgjua zëri dëshpërues i nënës së Destanit.

- Pastë jetë të gjatë, oj nuse! Kjo do t'ua kalojë çunave. I ndjefshi lezetin! – uroi gjyshi i gjonëve.

Kishte lindur gruaja e fortë dibrane, që do të bënte emër të mirë si nënë, Reme Gjoni në Dibrën e Poshtme. Ajo hodhi shtat si tajgë e njomë, me bukuri, me zgjuarsinë e mençurinë dibrane. Asaj nuk i mungoi përkëdhelja e interesimi prindëror për edukimin me moralin kanunor, me edukatën e punës, por dhe vështrimin qortues, të egër dhe kërcënimin me fjalë që cuca mos harbohej e të njolloste vlerat fisnore, të ruante pastërtinë e moralit, se një ditë do të shkonte në "derë të huaj".

Adoleshenca i dhuroi cucës së Gjonëve shkëlqimin e bukurisë dhe urtësinë e gjykimit për pyetjet që i kërkonte jeta duke tundur djepin e vëllait dhe rrekur me këngët magjike të dëgjuara nga e ëma.

Gjonët e vuanin tokën e pakët. Cuca e ndjente peshën e varfërisë. Familja mblidhte pak misër. As koshar nuk kishin. Motet shtyheshin dhe rridhte jeta në mjerim, e egër e dimërore. Por, sido Remja hidhte shtat. Edhe pse në motet kockë e lëkurë dhe në lëngatë, mosha ngacmonte ëndrrat dhe ajo mundohej ta tirrte me fjalë të gëzuara botën ideale të rinisë, që po piqej në ndjenjat e saj të pafajshme.

Atë kohë Destan Gjoni u kthye në Mustafej i veshur xhandar i Mbretit Zog. Egërsia e varfërisë u zbut. Gjonët filluan t'u qeshë fytyra e të ecin më serbes. Mëngjeset dritëronin luginën e Drinit, sa dukej sikur harbohej nga bukuria e gjelbërimit.

Fisi i Gjonëve që në kohën e sundimit osman dhe në luftë kundër serbëve, kanë rrezatuar burrëri, trimëri, ndershmëri, patriotizëm, karakter dibranësh, fisnikëri të trashëguar nga stërgjyshërit. Këto veçori të kulturës së fisit i pati mësuar Remja dhe krenohej me fragmentet historike të treguara në familje.

Në verë të vitit 1933 shkuesi trokiti në portën e Gjonëve. Cuca 15-vjeçare, e njomë, e papjekur mirë, por e zgjuar dhe e ndriçme si hëna pesëmbëdhjetëshe, e fejuan në Grykë-Nokë me Milazim Ndrekën.

Ato ditë ndodhi një rastësi "mëkatare". Cuca e Gjonëve u nis me të ëmën në Fushë-Alie.

- Oj e mira e nënës, a shiko atë njeri?

- Atë buzë Drinit thua?

- Sak po. Ai që zbath çorapët.

- Ç'na duhen ne, sa burra kalojnë Drinin?

- Heu! A s'e merr vesht kush asht?

Remja fluturoi nga sytë këmbët që të mos e shikonte i fejuari "mollën e ndaluar mëkatare".

***

Moti u thye. Te Gjonët u mblodh bota e poshtme e Dibrës. Mërzija e dëshpërimi u mbyt në Dri. Sido, Destan Gjoni bëri dasëm cuce... konaku u përlot me gëzim e dhimbje. Ndërsa Ndrekët e Grykë-nokës përcillnin luginës së Drinit gjëmimet e dum-dumeve të lodrave dhe këngët e dasmës. Do të bashkoheshin dy shpirtra përjetësisht.

***

Remja – nuse! Gurë e shkrepa në gjinjtë e maleve të Grykë-Nokës. Sa pak tokë! Sa pak bukë gjeti edhe tek Ndrekët! Remja aty e lidhi jetën. Aty do ta hante varfëria, por Milazim Ndrekën e deshi si ujin e pakët. Aty gjeti ngrohtësinë njerëzore që i shtonte dashurinë dhe kënaqësinë e nusërisë. Sido, malli e digjte për Gjonët dhe luginën përkëdhelëse të Drinit. Atëherë e përcillnin nusen të çlodhte shpirtin e përmallur tek prindërit në Mustafej.

Remja ndjente se diçka mistike e ëmbël në brendësi të vetësisë i rritej. Kjo "diçka" e tërhiqte kah Grykë-Noka malore. Atje e tërhiqte dora e padukshme e ambientit të ngrohtë të dashurisë, edhe pse me natyrë të ashpër malore. Asaj iu fshi mendimi se ishte në konak të Ndrekëve "njeri i huaj".

Gëzimi i parë: çun! U bëftë mal me lule ky konak! – uruan grykënokasit. Kishte lindur Ramadani. Ai krijoi vetëdijen e pjekur të nënës, pushtetin familjar dhe botën optimiste të Ndrekëve. Ndër vite erdhën edhe të tjerë, pas Ramadanit: Dilja, Aliu, Halili, Selmani, Karafili, Qamili, Qemali, Faliu, Zeneli.

Sa bukur! Bardhësia e shpirtit të madh të nënë Remes impononte dashuri e respekt. Vlerën e saj e shpërbleu Perëndia dhe urimet e Grykë-Nokës.

Sa peshë të madhe pati ajo dashuri me ndjenja aq të forta njerëzore! Nëna Reme pati gjak Perëndije!

Zgjuarsinë ajo bukuri e Dibrës e përdorte për të pirë shpirtin e dashurisë së malësorëve të Grykë-Nokës. Këtë veti mençurie Perëndia nuk ia pati dhënë çdo kujt. Prandaj kush e njohu dhe dijti ta lexojë këtë nënë, e adhuroi për vlerat e fisnikërisë.

Me kërkesa ndaj vetvetes, e cfilitur dhe e djersitur, të kthehej tek dashuritë që kërkonin ngrohtësinë e fjalës, kënaqësinë e prehërit, përkëdheljen e dorës së nënës, siç kërkonin copën e misërnikes me gjizë. Merjemja e shatit dhe e sokorres nuk e kursente trupin e shpirtin për dhjetë dashuritë. Fuqia e nënës derdhej djersë në shuarjen e etjes së arës, pikonte e ndritur me barin e copave të livadheve, në grranat malore në kopshtin e perimeve të faqeve të përrenjve dhe në misterin e thyer malor. Brenda Reme Gjonit jetonte bota e njeriut të munduar.

- Ma ke ngrënë shpirtin dhe brerë kocin, oj grue – u "ankue" Milazimi duke dashur të "luajë" me Remen që po gatuante bukën të mbasdite.

- Heu! A përse i kullot sytë mbi mua, o burrë? – iu përgjigj gruaja e çuditur.

- Më tha mendja me të pyet: Sa zemra ke ti, bre grue?

- Ç'hall i madh t'paska munduar, bre njeri? Gjithë gratë kanë nga një zemër për burrin e vet, or ti. Në dash me e dijtë, unë kam dy zemra! Njërën për Gjonët e mi, tjetrën zemër për fëmijët dhe burrin tim. E more vesht? Shtëpi kush të bëri ty?

- Heu bre, sa xhirs i fortë ju Gjonët!

Në tetor 1944 në kullë të Gjonëve plasi morekujeja. Gjëmë e përgjakur. Pa xhenaze. Ishte vrarë Halim Gjoni, xhaxhai i Remes, në moshën 17 vjeç. Vrarë si nacionalist i Halil Alisë, në ndeshje luftarake kundër komunistëve. Këtë plagë të dhimbshme që morën Gjonët i këndoi me lot tragjikë Remja, që lëndoi grykën e Drinit.

Gjaku i heshtur vazhdoi si një pushkatim edhe moral e hakmarrës për 45 vite të natës së gjatë komuniste. Remja u qëndroi si shqipe ngacmimeve klasore. Ajo e lodhur, por me dinjitet, shfaqej e gëzuar e me shpirt të qeshur duke krijuar në familje mjedis të këndshëm, të pastër e kënaqësi jete. Edhe pse në varfëri me të ardhura të pakta kooperativiste, ajo dinte ta hijeshonte sofrën me pak e shije për miqtë e njerëzit e konakut.

Grykënokasit e ruajnë në sytë e kujtesës nënën Reme që i ushqente me shpirt e i lumturonte me optimizëm dhe bukurinë e fjalëve të dashurisë. E kujtojnë tek ngjitej si zanë e zbriste në rrugë e pa rrugë malit e përrenjve duke thurur çorape e triko leshi për dhjetë dashuritë. Emri i Grykë-Nokës nuk varej sa njerëz ka, por sa vlera njerëzore me emër si Reme Ndreka.

Ktheheshin dashuritë nga shkolla të uritur. Me vrap hapnin magjen. Ndodhte që gjenin thërrime misri. Heshtnin. Vështronin pa zë vllaun më të madh. Prisnin te porta dashurinë e nënës, t'i ushqente. Vinte Remja vrap me shatin e arës së bukës në krah. I ngjiteshin dashuritë për trupi duke cicëruar si zogjtë e duke thithur armën e djersës së shishtë dhe ngrohtësinë e frymës së nënës.

- U ka marrë uja? – i pyeste si gjynahqare.

Ata kuptonin botën e saj. Koshari i msirit ishte mbaruar. Kooperativa i linte të uritur.

- Ishalla, nënë, do zoti e nuk mbetemi të varfër! – i thoshte Aliu si ta ngushëllonte.

Nëna e dhjetë dashurive i rriti, i edukoi, i bëri burra me frymën, me bukën e duarve të saj dhe me ujin e Grykë-Nokës. Ata u bënë mjekë, mësues, elektriçistë, traktoristë dhe punëtorë.

Kur sistemi demokratik pluralist hapi portat e izolimit, dhjetë dashuritë u shpërngulën nga Grykë-Noka duke marrë me vete simbolin e jetës së tyre, nënën e madhe Reme Ndreka (Gjoni).

- U lumtë, bijtë e nënës! Nuk ma çuat mundin dhe dashurinë kot...

Të dhjetët kanë bërë secili shtëpinë e vet në Durrës dhe në Tiranë.

Njeriu vjen në jetë me dhimbje dhe largohet me dhimbje, por të kobshme. Një ditë në Paskuqan të Tiranës, në shtëpinë e Aliut u dëgjuan vaje të hidhura. Dhjetë dashuritë kërkojnë mistikisht:

Oj nanë Remja, zgjou bre,
Pse na ike e na le?
Dyqindë shpirtna nga gjaku jot,
Me mall t'kujtojmë e t'qajmë me lot.

Nën dheun e amëshuar gjelbëron e pulson shpirti i fisnikes dibrane. Koha ecën. Ajo jeton mistikisht me dhjetë dashuritë...

Martesat dibrane **më të famshme**

(vijon nga faqja 22)

e viktima, sidomos kur ka pasur prishje të martesës apo të fejesës. Tashmë dihen "pasojat që pati Gjergj Kastrioti nga prishja e fejesës midis Muzakë Topisë e Zanfina Muzakës për ta martuar Muzakën në vitin 1445 me të motrën, Mamicën. "Ky precedent solli pakënaqësi tek Muzakaj, pasi Zanfina (Suina) ishte bija e Despotit Gjin Muzaka dhe e motra e Gjon Muzakës, autorit të kronikës së famshme të Beratit, ndërkohë Gjin Muzaka ishte vëlla i Marie Muzakës, grua e parë e Gjergj Arianitit dhe nënë e Donika Kastriotit, gruas së ardhshme të Heroit. Gjin Muzaka ishte dhe një ndër pjesëmarrësit e Lidhjes së Lezhës dhe një prej bashkëluftëtarëve të Skënderbuet. Atëherë ky veprim i Skënderbeut mund të shpjegohet edhe me synimin e tij, për të zgjeruar Principatën e tij duke përfshirë në të edhe Principata e tjera. Në këtë kontekst mund të ketë ndodhur edhe kjo ngjarje, e cila si shumë të tjera të ngjashme me të, sollën rebelimin ndaj Skënderbeut, të cilat historia jonë i quan me termin "Tradhëtia Feudale". Prishja e kësaj martese hamendësohet se i kushtoi rëndë Skënderbeut. Zanfina Muzaka u martua me Moisi Golemin (Moisi Komnen Arianitin), të cilin e shtyti kundër Skënderbeut. Veprimet dhe sjellja e Zanfinës e shtynë Moisiun për shkaqe të tjera drejt tradhëtisë në vitin 1455 pasojat e së cilës sollën disfatën në betejën e Beratit, ku gjeti vdekjen midis të tjerëve edhe Muzakë Topia (bashkëshorti Mamicës, motrës së Skënderbeut M.H). Në këtë rast, Barleti mban krahun e Mamicës, të cilën e quan një grua fisnike dhe bashkëshorte të denjë e besnike, e cila "pasi thirri sipas zakonit shumë zonja, e nderoi varrimin e burrit për një kohë të gjatë me zi e lotë, që s'pushonin as ditë, as natë . Edhe pas vdekjes së Muzakës në kërdinë e Beratit puna i mbetet në dorë Mamicës, e cila tregoi një zotësi të rrallë .

Prishja e fejesës, i kushtoi rëndë edhe Ahmet Zogut, pinjoll i oxhakut të Zogollit, familjes më të madhe në Mat, i cili më 1928, nga kryetar i Republikës Shqiptare, u shpall nga parlamenti Zog I, Mbret i Shqiptareve, Skënderbeu III. Për t'i forcuar pozitat në arenën ndërkombëtare, Zogu prishi fejesën me vajzën e Shefqet Verlacit, një familje e pasur dhe me influencë dhe u martua me konteshën "Geraldinë Apponyi, bijën e shquar të familjes fisnike dhe të famshme të Konteve Apponyi e përshtatshme me interesat e dinastisë Kombëtare .Kjo bëri që Vërlaci të bëhej armik i Zogut. Duke qenë se ishte nën shënjestër të vazhdueshme Zogu i rralloi daljet në publik . Viktima midis parisë dibrane për shkak të prishjes së fejesave e martesave ka pasur edhe midis dy luftërave botërore. Për një fejesë të prishur midis tre familjeve më të fuqishme në Dibër dhe më gjerë; Ndreve në Sllovë dhe Alive Kaloshe në Çidhën paria dibrane u nda në dy kampe të përbetuara armike, e cila u shoqërua me viktima. Kanuni duhej respektuar, përndryshe kriste arma.

Në nyjen 1171 të kanunit të Dibrës thuhet: Kur prindit martojnë' vashën pa i dhanë lekun shpia ku ajo qe fejue, kanë gjakun në derë. Në këtë rast, sipas nenit 1172, shpia e djalit gjakun e merr ku t'u vijë për mbarë: ke shpia ku ajo qe vashë, ja ke shpia ku u ban nuse . Për ngjarjen e mësipërme, studiuesi i njohur dibran, Xhafer Martini shkruan: "Elez Isufi pat dhanë nji vashë ke Tahir Alia në Fushë Alie. Po Aliet ranë nga vakti, nuk ishin ma si në kohën e Salë Demirit e të Selman Alisë. Elez Isufi u luajti nga fjala e at' vash' ia dha Haziz Kaloshit në Kandërr. U erdhi randë Alive, po nuk kishin çfarë të banin as me Ndreun e as me Kaloshin. Po u rrit nji pinjpll i ri i ktij fisi, Halil Alia, që populli e quante "Gjërpën shullani", se ishte i helmët si gjarpni. Halili vendosi me vra nji prej tyne . Ai vrau me pistoletë në mes të Tiranës, Mehmet Kaloshin, djalin e vetëm të Murat Kaloshit. Në këtë vrasje u ndihmua nga nipi i tij, Mane Kacani, i cili mbeti i vrarë nga xhandarët, ndërsa Halili shpëtoi.

Kjo armiqësi vazhdoi edhe gjatë Luftës Nacionalçlirimtare, ku tashmë me Ndretë nuk ishin vetëm armiq por edhe kundërshtarë politik. Dali Ndreu ishte komunist dhe ushtarak i lartë, kurse Halili komandant i forcave nacionaliste. Në kanun thuhet qartë se çdo familje duhet të lidh krushqi brenda "eshit" lojit të vet, pëndryshe ka pasoja të rënda, siç ndodhi me familjen feudale të Karahasanit në Brezhdan të Dibrës. Për një dashuri jashtë "eshit"t të vet, pinjolli i Oxhakut të Karahasanit, Hasan begu, apo "Hasan pasha", vrau Gjip Pirën, djalin e agait të Muhurrit, Abaz Pira. Vajza e tij Fetija (Tija), kishte rënë në dashuri me Gjipën dhe i kërkon të atit dorën e saj, ndërkohë që vajza i thotë s'ëmës se kishte dëshirë të martohej me Gjipën. Kjo nuk kishte ndodhur asnjëherë. Oxhaqet bëjnë krushqi me oxhaqet. Hasani e kishte harruar origjinën e vet jo të largët nga Shoshaj i Matit. Ai mbylli vajzën në një dhomë të haremit, ndërsa Gjipën e vrau duke paguar njerëz të panjohur. Kështu Has begu humbi edhe miqësinë me Abaz Pirën.

Mentor Hoxha



Të gjitha informatat me rëndësi, si shkrime, intervista, lajme, video dhe audio, lidhur me mbrojtjen e lumit Radika mund t'i gjeni në:

http://saveriverradika.com

Aty ka mjaft materiale për t'u informuar si dhe për të siguruar fakte për debatet tuaja. Të gjithë ata që kanë dokumente të tjera ose informacione të panjohura, të na i dërgojnë, që t'i arkivojmë bashkë me të tjerat.

LINKU I PETICIONIT KUNDER DEVIJIMIT TE LUMENJVE

https://secure.avaaz.org/en/petition/Qeveria_e_Shqiperise_Government_of_Albania_Te_mos_lejohet_te_ndalohet_devijimi_i_lumenjve_VJOSA_dhe_RADIKA/?cYIvdgb

---

Pajtohu në gazetën

RRUGA E ARBËRIT

Merr versionin PDF ose kopjen print

Për informacion shkruaj: rrugaearberit@gmail.com



Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 12 (92). DHJETOR 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

RRETH E RROTULL-A
Ç'kemi asaj Dibre!
Nga **BUJAR KAROSHI** - FAQE 2

ESE
Punëtori i thjeshtë i shkrimtarisë..
Nga **RAMIZ GJINI** - FAQE 11

BOTIME
Në një odë dibrane me Haziz Ndreun
Nga **VIRON KONA** - FAQE 15

REPORTAZH
Ismail Keta, tre herë Kampion Bote
Nga **DEFRIM METHASANI** - FAQE 12-13

Çfarë do të ndodhë me **ujërat e Radikës?**

Një panoramë e çështjes dhe skenat dhe prapaskenat mes qeverisë së Maqedonisë dhe Shqipërisë? A do t'i merret ujërat Radikës dhe nëse ndodh, sa ujë do ti merret dhe cilat janë ndikimet në mjedis? Një vështrim "Pro" dhe "Kundër" që nga nisja e kësaj historie deri më sot.

kryesore
RRUGA E ARBRIT
A ka **dritë** në fund të tunelit?
Viti që po lëmë pas ka shënuar një histori të rëndësishme të shoqërisë civile, pëmsa i përket përgjegjësve për sensibilizim të opinionit dhe qeverisë në mugën e Arbrit. Që nga nisja e peticionit online më 18 mars 2013, iniciuar nga Dr. Gëzim Alpion, profesor në Universitetin e Birmingamit, mbi 5 mijë qytetarë e kanë firmosur atë online dhe në letër, duke treguar domosdoshmërinë e ndërtimit të saj sa më shpejt dhe sa më mirë.
FAQE 3

reflektime
Maqellarë, festë dhe firma ditën e Krishtlindjes
Nga **IDA NURÇE** - FAQE 2

Për shumë vjet Vitin e Ri!
Ardhtë me Rrugën e Arbërit dhe mos shteroftë Radikën!

Kontribuo për vendlindjen duke u pajtuar në gazetën *RRUGA E ARBËRIT*
Merr versionin PDF ose kopjen print.
Për informacion shkruaj: rrugaearberit@gmail.com

Çështja e ujërave të Radikës po gjen një vend të gjerë në mjedisin mediatik dhe politik në Maqedoni dhe Shqipëri. Gazeta "Rruga e Arbërit" i ka kushtuar një vend të rëndësishëm kësaj çështje që në Mars 2012, me një shkrim të Prof. dr. ing. Abdyl Kolecit, por për më shumë se një vit, asnjë institucion apo organizëm popullor nuk u interesua. Vetëm gjatë verës disa qytetarë filluan të kërkonin reagime publike lidhur me çështjen dhe në gushtë 2013, institucionet vendore në Komunën e Dibrës së Madhe reagjuan kundër projektit, për të ardhur sot në fund të vitit, si çështje themelore dhe e pasojgjithur mes Maqedonisë dhe Shqipërisë.
Po si kanë rrjedhur ngjarjet rreth devijimit të ujërave të Radikës?
(Lexoni në faqet 4-5)

opinion
Radika është pjesë e **historisë** dhe **kulturës** shqiptare
Nuk është me rëndësi se cila do të jetë sasia e ujit që do t'i mbetbehet Radikës: një pjesë e tij, gjysma apo edhe më të ktrës (informatat lidhur me këtë janë kontradiktore); shpetimues është fakti që po proket një pasuri natyrore, një lumë, ndër më të pastrit në Evropë, që i të cilit, qofte edhe pjesërisht, nuk do të dierdhet më në detin Adriatik, si gjithmonë, pesjse mbahet mend, por në detin Egje!
Nga **AGIM VINCA** - FAQE 6

opoonence mjedisore
Rrezikohet Rrëqebulli i Ballkanit në Maqedoni
Në mënyrë ironike, kur kërkuam leje për të vizituar zonën e "Fusha e Llukovës" jo vetëm që na u mohua leja por autoritetet kërkuan që të ishte e nevojshme që disa javë shtë të fyre të mbikqyrnim pranimë tyre. Në hesiprnë që disa javë zonave duhet të jenë dukshëm zona të ndaluara, por kjo duhet të aplikohet si për bulizuesitë ashtu edhe për ambientalistët...
Nga **PETR HLOBIL** - FAQE 7



Rruga e Arbërit

www.rrugaearberit.com GAZETË E PAVARUR. NR. 11 (91). NËNTOR 2013. ÇMIMI: 50 LEKË. 20 DENARË. 1.5 EURO.

PROTESTA: PROJEKTI I HIDROCENTRALIT TË LUKOVËS ËSHTË ME PASOJA SHKATËRRUESE PËR DIBRËN

Ndal devijimit të rrjedhjes së lumit **Radika**!

Ndryshimi i rrjedhjes natyrore të lumit të Radikës do të shkaktojë një katastrofë ekologjike për Grykën e Radikës. Ndërmarrja publike e Maqedonisë është e angazhuar për ndërtimin e hidrocentralit të Llukovës, ndërkohë që protestuesit presin edhe reagimin zyrtar të qeverisë së Shqipërisë. Qytetarët dhe pushtetarët lokalë në Dibër të Madhe janë kundër: Mos na e thani ardhmërinë!

Retrospektivë e ngjarjeve dhe veprimtarive lidhur me problemin ekologjik të vjedhjes së ujërave të lumit Radika nga Qeveria e Maqedonisë përmes ndërmarjes publike për prodhim të energjisë elektrike "ELEM"
SPECIALE NË FAQET 6-7

rreth e rrotull-a
Ç'kemi asaj Dibre!
Nga **BUJAR KAROSHI**
Muaji filloi mbarë për Dibrën. Një Mbërban u takua me kryeministrin maqedonas dhe i kërkoi falje, sepse në Tiranë ia kishte bërë pis kostumin me vezë të prishur. Pas këtij takimi, vizita e kryeministrit shqiptar në Shkup shkoi fjollë. Thuaj pastaj se ne dibranët nuk ia thokim për diplomaci... Media e Tiranës njoftoi se dibrani ishte arrestuar nga policia, por një gjë nuk u kuptua, kur e takoi kryeministrin maqedonas, para apo pas arrestimit!!
Policia e Bulqizës nisi një aksion kundër kamionëve me krom. Njaaçë nuk mundet dot ta ndalojë krimin që ndodh në minierë, janë nën tokë të gjatë, policia ndalon kamionët, sepse nuk kanë fatura tatimore që të tregojë çmimin dhe peshën. Ndërkohë, ministri i energjetikës dhe minierave urdhëroi bllokimin lejeve për shoqëritë që shfrytëzojnë minierat e Bulqizës, sepse nuk kanë respektuar investimet dhe kushtet e sigurisë në punë. "Ky është shtet", dukej se thoshin fajmet e para nga terreni, por vetëm pak ditë më vonë, disa punëtorë deshën të vetëdigjenjohin. Po vuajmë për bukën e gojës, na lini të punojmë... si sklleve! Kur minatorët humbin jetën në galeri, e gjithë shoqëria klekon dorën e ngrohtë të qeverisë, kur shteti ofron dorën e ngrohtë, punëtorët kërkojnë dorën e ftohët të skllavërisë.
Për armët kimike, që desh helmuan Shqipërinë, u protestua edhe ne Peshkopi. Bulevardi i rrallëhërë në këto 20 vite u mbush me fëmijë me parulla në dorë: Mbrovi fëmijët tanë!... Vaç në Peshkopi gjen fëmijë me fëmijë! Të rritur i ndo-qën me sy nga trotuarë dhe kafet, duke bërë shaka dhe duke pirë raki...
(Vijon në faqen 10)

Roli dhe rëndësia ekonomike e Rrugës së Arbrit
Nga **ENVER HALILI - FAQE 3**

Prof.dr. Artan Fuga, mbështetje të fuqishme për Rrugën e Arbrit
Profesori i njohur, u bën thirrje miqve të tij në Facebook të firmosin peticionin për Rrugën e Arbrit.
"Unë jam një grimcë rëre përpara këtij projekti që zhvillon Dibrën, Veriun, gjithë Shqipërinë. Unë kam bindje se qeveria do ta vlerësojë maksimalisht", shkruan ai.
Iniciatorët e peticionit për Rrugën e Arbrit janë duke negociuar me institucionet qeveritare për të bërë të mundur dorëzimin formal të tij. Peticioni, i nisur që më 18 mars 2013, deri më tani ka mbledhur një numër të konsiderueshëm firmash. Atë e kanë firmosur personalitete të ndryshme të kulturës, shkencës e artit, të cilët janë janë bërë të njohura për publikun në numrat e kaluar. Kohët e fundit, atë e kanë firmosur edhe artistët e humorit Agron Llakaj e Behar Mera si dhe kënglitari Driton Jashari. Por ajo që ka spikatur këtë muaj, janë komentet në faqen personale të Facebook-at të Prof. Dr., Artan Fugës, Anëtar i Akademisë së Shkencave.
"Unë vetë jam me origjinë jugore, por si shqiptar, ndjek me shumë interes ecurinë e fatit të Rrugës së Arbrit, shkruan ai një status në faqen e tij personale. Falenderoj të gjithë ata miq të kësaj faqeje që po e nënshkruajnë me dhjetra peticionin dashamirës në mbështetje të saj.
Menjëherë në faqen e tij ka pasur reagime pozitive për mbështetjen, të cilën Fuga dëshiron të mbajë vonë edhe ta sqarojë. "Dibranët e meritojnë të afrohen me Tiranën, se familjet e tyre e kanë mbajtur gjallë kulturën tiranase duke qenë bancorë të hershëm të saj. Çfarë popullu, çfarë familjesh, çfarë miqsh. Pa zë, plot mençuri, të thjeshtë, besnikë, pashtërtoni, familjarë të mirë, solidarë, besimtarë në vlera. Nuk thoshin kot "Ke dibranët" Eh, histori e gjatë...
Dikush i shpreh falënderimet profesorit, dhe ai përgjigjet me modestë: "Unë jam një grimcë rëre përpara këtij projekti që zhvillon Dibrën, Veriun, gjithë Shqipërinë. Unë kam bindje se qeveria do ta vlerësojë maksimalisht". Më pas, dikush i kujton se "shtetë pa mbyllur akoma aksi i Jugut", dhe profesori ia kthen kaqt miqësisht dhe me humor. "Aleks i ndiesur, për të shkuar në Sarandë, bjeri shkurt nga Dibra or mik! Peticioni nuk thotë asëkënd se ndaloni punimet në aksin e Jugut. Pa merak. Firmose edhe ti, të lutem!" Këmbënguljes së Aleksit se edhe aksi Memaliaj - Tepelenës/shtë keq, Fuga nuk pëtton sërish t'i përgjigjet: "E di, ke shumë të drejtë, i ndiesur Aleks!Por zonra e njeriut nis kur nuk mendon vetëm për të kaqen e vet, por edhe për të kaqen e fqtrit. Bashkë do t' a bëjmë Shqipërinë."
(Vijon në faqen 18)

Firmos dhe **komento peticionit** në **change.org**

http://www.change.org/en-GB/petitions/complete-the-construction-of-the-arb%C3%ABri-road-nd%C3%ABrtoni-sa-m%C3%AB-shpejt-dhe-me-standarde-rrug%C3%ABn-e-arb%C3%ABrit?utm_campaign=petition_created&utm_medium=email&utm_source=guides

cyan magenta yellow black